monumentet


DO NOT COPY

57/2018

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Monumentet

DO NOT COPY

DO NOT COPY

MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
“GANI STRAZIMIRI”
TIRANË

DO NOT COPY

Monumentet

57/2018

REDAKSIA

Prof. Dr.	Pirro THOMO	*Kryeredaktor*
MSc.	Arta DOLLANI	*Anëtar*
Dr.	Edlira ÇAUSHI	*Anëtar*
MSc.	Marsela PLYKU	*Anëtar*
Dr.	Elio HOBDARI	*Anëtar*
Prof. Dr.	Florian NEPRAVISHTA	*Anëtar*
MSc.	Mimoza ZERECI	*Anëtar*
MSc.	Joli MITROJORGJI	*Anëtar*
MSc.	Anduela ARBANA	*Sekretare*

© Copyright: Instituti i Monumenteve të Kulturës

Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës Tiranë, 2018

ISSN 0253-1607

Në kopertinë: Kisha e Shën Marisë në Labovë të Kyqit.

DO NOT COPY

&PRINT
Shtypshkronjë & Shtëpi Botuese

Adresa: Rr. Gjon Kastrioti
(ndërtesa 53)
Laprakë, Tiranë
Cel: 0692066745
E-mail: contact@gnlprint.com
HHP: www.gnlprint.al

PASQYRA E LËNDËS
ARTIKUJ
Faqe

DO NOT COPY

Agron ISLAMI
Klejdi ZGURO
Mozaikë të rinj në Apoloni. Gjendja, analizimi dhe konservimi i mozaikut të sondazhit 4 dhe ndërhyrjet paraprake në mozaikun e sektorit S16-Agora.....11

Pirro THOMO
Alfred ÇOMA
Kisha e Lindjes së Shën Marisë në Labovë të Kryqit – Gjirokastër. Punimet e restaurimit.....19

Afroditi NEROLOGOU
The Byzantine Church of Saint Mary in upper Peshkëpi village, southern Albania, survey results and approaches for future interventions.....49

Shpresa PRIFTI
Restaurimi i ansamblit urbanistiko-arkitektonik i rrugës "Kardinal Mikel Koliqi" (Rruga Gjuhadol), Shkodër.....77

Genci TRESKA
Gentian VOKOPOLA
Restaurimi i tavolinës së punës së poetit Ndre Mjeda.....103

Elio HOBDARI
Propozim anastiloze për kangjellën e bazilikës mesjetare të Shën Janit (Blerimas, Delvi në).....115

Frederik STAMATI
Ariola PRIFTI
Flamuri me të cilin u mbulua arkivoli i Ismail Qemalit gjatë ceremonisë së varrimit. Procesi i konservimit për ruajtjen e jetëgjatësisë së tij.....129

Erilda SELAJ

Konservimi dhe konsiderata rreth një kutie lipsanesh të artit post-bizantin.....141
PUNIME RESTAURUESE, MIRËMBAJTJEJE DHE KONSERVIMI 2015 - 2017

Punime Restauruese, mirëmbajtjeje dhe konservimi DRKK Berat, Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Vlorë 2015 - 2017.....149

KRONIKË
Konferenca e 4-rt Ndërkombëtare: "Monumentet Bizantine dhe Trashëgimia Botërore", Karta për "Mbrojtjen e Monumenteve të Trashëgimisë Bizantine"
Selanik, 30.11.2018 - 02.12.2018.....168

DO NOT COPY

TABLE OF CONTENTS
ARTICLES
Page

DO NOT COPY

Agron ISLAMI
Klejdi ZGURO
New mosaics in Apolonia, condition, analysis and conservation of mosaic on the sondage 4 and preliminary interventions on the mosaic of the sector S16-Agora.....17

Pirro THOMO
Alfred ÇOMA
Church of the Nativity of Saint Mary Labovë e Kryqit village – Gjirokastra. Restoration Woks....46

Afroditi NEROLOGOU
Kisha Bizantine e Shën Marisë në fshatin Peshkëpi e Sipërme, në Shqipërinë e jugut. Rezultatet e dokumentimit dhe qasjet për ndërhyrjet e ardhshme.....74

Shpresa PRIFTI
Restoration of urbanistic-architectural ensemble in the street "Kardinal Mikel Koliqi" Shkodër.....100

Genci TRESKA
Gentian VOKOPOLA
Restoration of poet Ndre Mjeda's work table.....113

Elio HOBDARI
Proposal for anastylosis of the Templon in Medieval Basilica of St. John (Delvinë).....127

Frederik STAMATI
Ariola PRIFTI
The flag with which Ismail Qemali's coffin was covered during the burial ceremony. Conservation process to preserve its lifespan.....138

Erilda SELAJ
Conservation and considerations regarding a post byzantine box of relics.....149

DO NOT COPY

monumentet
57/2018

Agron ISLAMI
MSc. Klejdi ZGURO

DO NOT COPY

MOZAIKË TË RINJ NË APOLONI

GJENDJA, ANALIZIMI DHE KONSERVIMI I MOZAIKUT TË SONDAZHIT 4 DHE NDËRHYRJET PARAPRAKE NË MOZAIKUN E SEKTORIT S16-AGORA

Mozaikët në fjalë dolën në dritë gjatë zhvillimit të ekspeditës së përbashkët arkeologjike shqiptaro-franceze të vitit 2011, në qytetin antik të Apolonisë.

Mozaiku i parë u zbulua gjatë një sondazhi të realizuar nga ekspedita, në lindje të banesës romake, sektori G. Mendohet se mozaiku i përket ambienteve të një ndërtese, ndoshta me karakter publik. Nxjerrja në dritë e dyshemesë me mozaik, vijoi paralelisht me realizimin e ndërhyrjeve konservuese në të, bashkë me analizimin e tij.

Analizimi i gjendjes së mozaikut

Pas zbulimit u konstatua se gjendja e mozaikut ishte relativisht e mirë, duke paraqitur patologji kryesisht të natyrës fizike. Këto patologji lidhen me:

- *Ondolime dhe mosvazhdimësi e shtresave të përgatitjes*

Patologji kjo prezente pothuajse në të gjithë dyshemenë me mozaik, më e theksuar dhe evidente kjo në pjesën jugperëndimore.

- *Lakuna*

Lakunat e pjesshme manifestohen me shkëputje të teserave nga suporti i tyre. Këto lakuna janë më të pranishme në pjesët anësore pranë strukturave murale. Lakunat totale manifestohen me humbje të një apo disa shtresave përgatitore. Në përgjithësi lakunat janë të dimensioneve të vogla, të mesme e të mëdha, e pranishme kjo e fundit në pjesën jugperëndimore, me një diametër prej rreth 80 cm.

- *Prani e sipërfaqeve të djegura (?)*

Në disa pjesë të dyshemesë, pas zbulimit u konstatua prania e sipërfaqeve të djegura (?).

Kjo patologji mund të jetë rezultat i kontaktit të sipërfaqes së teserave me temperatura të larta, fenomen i cili çon në oksidimin e joneve të metaleve të rëndë prezentë në strukturën e materialit në rastin tonë të hekurit (Fe), duke krijuar në sipërfaqe patina të mundshme të oksideve, kryesisht të këtij metali[1].

[1] Limoniti, FeOOH.H2O, ngjyra e verdhë në kafe

Për sa i takon patologjive të tjera të natyrës biologjike apo kimike ato janë pak ose aspak të pranishme, duke u limituar në prezencë të mundshme elementësh patogjenë, kryesisht baktere autotrofë[2] apo eterotrofë[3] (Fig.1) (Skica 1).

Analiza e motiveve

Kemi të bëjmë me një mozaik polikrom, në opus tesselatum, i cili përbëhet nga motive gjeometrike ku dominon fusha e bardhë. Motivi kryesor përbëhet nga dy elipse të përbërë nga një rresht teserash të zeza me dimensione 33 x 33 cm nga njëri cep tek tjetri, të cilët presin njëri-tjetrin duke krijuar në qendër një katror me përmasa 7 x 7 cm. Këtij motivi i brendashkruhet një tjetër katror me dimensione më të vogla i realizuar me një rresht teserash që variojnë diku rozë, diku të kaltra të forta, etj.

Në qendër të katrorit të dytë vendosen në mënyrë jo gjithmonë të rregullt një grup prej rreth katër teserash, ku edhe këto variojnë në kolor. Parë në një tjetër këndvështrim, katër nga këto motive të përbëra janë vendosur në mënyrë të tillë, ku me cepat e tyre formojnë një rreth me diametër prej rreth 50 cm. Në pjesën e brendshme, në qendër të këtij motivi është vendosur një teser e zezë, pikërisht për të konceptuar qendrën e rrethit. (Fig. 2)

Të gjithë fushën ku është vendosur motivi kryesor e ndan nga pjesa e bordurës anësore një rresht prej dy teserash të zeza. Mbi të është vendosur një fushë e ngushtë, e përbërë nga tesera të bardha më një spesor prej 9 cm (pesë teserash). E gjithë kjo fushë qarkohet nga motivi i gërshetit dysh të stilizuar, i realizuar me përdorimin e teserave me ngjyrë të bardhë, të zezë, të verdhë, rozë, ku në qendër të çdo nyjeje është vendosur një teser e bardhë. Ky motiv ka një ritëm të rregullt, duke i dhënë të gjithë strukturës një aspekt dinamik konstant. Fusha e bardhë përsëritet edhe mbi gërshetin, bashkë me kordonin e përbërë nga dy radhë teserash të zeza.

Mbi këtë kordon prej dy radhë teserash të zeza është vendosur një fushë me tesera të bardha me një spesor prej 44 cm, e cila shkon deri në kontakt me strukturat murale të ambienteve. Në të gjithë sipërfaqen bie në sy edhe një simetri e motiveve duke i dhënë vizatimit një dinamikë të dukshme. Për sa i takon teserave ato kryesisht kanë dimensione 1 x 1 cm, për sa i takon atyre të përdorura në pjesën e sipërfaqeve monokrome dhe me dimensione disi më të vogla në pjesën e motiveve.

Ndërtimi i mozaikut-shtresat përgatitore, dokumentimi

Plini, shkrimtar romak, shek. I m. Kr, në veprën e tij enciklopedike *"La naturalis historia"* (Nat. Hist. XXXVI 186,187) dhe Vitruvi, arkitekt romak po i shek. I pas Kr., në veprën e tij "De Architectura" (De Arch. VII,I,I-7), na japin një përshkrim deri diku të detajuar të teknikave të realizimit të mozaikëve në periudhën romake dhe mënyrës së ndërtimit të tyre, duke dhënë një skemë të detajuar, gati klasike të realizimit të shtresave përgatitore. Të dy autorët i rendisin këto shtresa duke filluar nga poshtë lart sipas rendit; *Statumen, Rudus, Nucleus, Pasta, Teserat.*

Duke u nisur nga ky fakt, në pjesën veriore të dyshemesë u realizua një mini sondazh pikërisht me qëllim evidentimin e mënyrës së realizimit të mozaikut dhe analizimin e shtresave të tij përgatitore.

Pas realizimit të prerjes u vu re se edhe mozaiku ynë ishte i ndërtuar nga pothuajse po të njëjtat shtresa përgatitore, duke respektuar në këtë mënyrë teknologjinë "klasike" të realizimit të mozaikëve në periudhën romake.

Shtresat përgatitore të mozaikut të Sondazhit 4 dhe përbërja e tyre materiale të përcaktuara nga analiza autoptike in situ, duke filluar nga poshtë lart janë:

[2] janë në gjendje të sintetizojnë molekula të përbërjeve organike vitale për ekzistencën e tyre.

[3] autosuficentë për ekzistencën e tyre. Kanë nevojë për organizma të tjerë për të mbijetuar, duke qenë të privuar nga klorofila, nuk mund të kryejnë fotosintezën.

DO NOT COPY

1- Dhéu natyror
2- Statumen, shtresë niveluese e përbërë nga pjesë tjegullash me gjatësi 8-10 cm dhe me një spesor prej 2 cm.
3- Rudus, shtresë e përbërë nga copa gurësh të thyer, copa tjegullash, të përmasave mesatare dhe llaç gëlqereje, me një spesor prej 4 cm.
4- Nucleus, shtresë e përbërë nga copa gurësh të thyer, copa tullash, të përmasave të vogla dhe llaç gëlqereje, me një spesor prej 3 cm.
5- Pasta, shtresë e hollë llaç gëlqereje, më një spesor prej rreth 1 cm
6- Teserat, të përbëra kryesisht nga material gëlqeror (Skica 2) (Fig. 3).



Fig. 3. Evidentimi in situ i shtresave përgatitore

Me qëllim përcaktimin e uniformitetit dhe vërtetimin e faktit që teknika e realizimit ishte respektuar në të gjithë dyshemenë, u shfrytëzua rasti i gërmimit të një grope rrethore në pjesën juglindore, ku u realizua një tjetër prerje. Në këtë pjesë u vu re se *rudusi* dhe shtresat e tjera mbi të ishin vendosur direkt mbi nivelin e dheut natyror apo argjilës. Për sa i takon pastës, ajo këtu llogaritet në disa milimetra. Ky fakt na jep një indicie, e cila na shtyn të mendojmë se mjeshtrit nuk kanë respektuar kudo modelin "klasik", por kanë shfrytëzuar në shumë vende terrenin natyror.

Çështja e datimit të një dyshemeje me mozaik është mjaft komplekse dhe paraqet vështirësi të ndryshme. Prezenca e motiveve gjeometrike në dyshemetë me mozaik përbën një konstante që nga kohët më antike. Bikromia (e zezë në sfond të bardhë apo e bardhë në sfond të zi), manifestohet me përdorimin e motiveve të thjeshta si trekëndësha, kuadrate, svastika, rombe etj, të cilët prodhojnë një ritëm linear e uniform. Me reduktimin e dimensioneve të teserave, linja e thyer e motiveve shndërrohet në të lakuar dhe shfaqen motivet e valëzuara dhe rrethore, si dhe fillojnë të përdoren rrathë, gërsheta dysh apo tresh etj.

Në rastin e mozaikut tonë, i cili nuk është zbuluar plotësisht pasi doli në dritë këtë vit, nisur nga analiza dhe faktet e lartpërmendura, por edhe nga konteksti arkeologjik dhe gjetjet e ndryshme, mund të japim një datim relativ duke e vendosur atë midis shekujve I-III m. Kr.

Në vazhdën e këtij procesi u realizua edhe dokumentacioni grafik i motiveve kryesore të dyshemesë me mozaik. Rilevimi u realizua në shkallën 1:1, duke vizatuar mbi polietilen, në kontakt me sipërfaqen e mozaikut, shoqëruar në fund me legjendën dhe shpjegimet përkatëse (Fig. 4).

Ndërhyrjet Konservuese

Realizimi i bordurimeve; Fillimisht u pa e domosdoshme dhe u vendos si ndërhyrje e parë realizimi i bordurimeve, me qëllim mbajtjen e teserave brenda kontekstit të tyre. Për këtë arsye u realizuan një seri bordurimesh duke përdorur llaç të përshtatshëm, si në raportin lidhës-inerte, ashtu dhe në aspektin kromatik. (Fig. 5-6)

Trajtimi i lakunave; Gjatë fazave të para të studimit dhe dokumentimit të gjendjes së konservimit të mozaikut, është thelbësore verifikimi i materialeve dhe metoda e teknikës së përdorur. Fillimisht u procedua me pastrimin

DO NOT COPY

me durim dhe kujdes të lakunave, proces i cili u përsërit në vazhdimësi gjatë gjithë procesit të trajtimit të tyre. (Fig. 7-8)



Fig. 7. Trajtimi i lakunave

Për trajtimin e tyre dhe realizimin e bordurimeve u përdor llaç gëlqere në raportet e mëposhtme lidhës-inerte dhe në aspektin kromatik:

2- gëlqere e stazhionuar
3- rërë gri e imët e larë
2- pluhur tulle
1- pluhur mermeri
- sasi e vogël pozzolana
- sasi e rekomandueshme rezine akrilike në tretësirë ujore

- **Rivendosje e teserave të gjetura in-situ;** të shkëputura nga suporti i tyre u realizuan me përdorimin e llaçit të përshtatshëm hidraulik si në raportin lidhës-inerte ashtu dhe në aspektin kromatik. Në të njëjtën kohë, me tesera u plotësuan disa nga lakunat me sipërfaqe të vogël. (Fig. 9-10)
- **Konsolidime;** konsolidim i shtresave përgatitore, të cilat evidentoheshin në sipërfaqe, me qëllim lënien e tyre të ekspozueshme, duke realizuar



Fig. 9. Konsolidimi dhe rivendosja e teserave

vetëm një bordurim të buzëve të lakunave, ku këto shtresa u evidentuan. Konsolidimi i tyre u realizua me përdorimin e konsolidantëve me bazë 80% tetraetilsilikati në whitespirit, aplikuar me penel. (Fig. 9-10)

- **Larje me solucione;** duke përdorur detergjent jo jonik[4] në përqëndrim 2% dhe biocid me spektër të gjërë veprimi[5] në përqëndrim 2%, të gjitha këto në tretësirë ujore. (Fig. 5-6, 7-8, 9-10)

Në përfundim të ndërhyrjeve konservuese të sipërpërmendura, u arrit stabilizimi i gjëndjes fizike

[4] *Tween 20*, detergjentët jo jonik janë në përgjithësi derivate të oksidit të etilenit. Vepron mbi tensionin sipërfaqësor të lëngut (H2O) ku hidhet, duke patur veprim pastrues kundrejt papastërtive të natyrave të ndryshme.

[5] *Benzalkon kloruri*, me pH 7.0-8.0 (përmbajn 50% alkildimetilbenzil amoni), ushtron veprim dezinfektues ndaj elementëve të mundshëm patogjenë, veprim i cili i detyrohet ngarkesës elektrike pozitive të pranishme në molekulën e substancës aktive; një ngarkesë e tillë bën të mundur kontaktin elektrostatik të alkildimetilbenzil amonit me membranën qelizore të mikrorganizmave, me shkarkim të ngarkesës elektrike mbi të. Ky fenomen provokon pamundshmërinë e mikrorganizmave për të kontrolluar shkëmbimet osmotike vitale, të cilat realizohen nëpërmjet membranës, dhe në këtë mënyrë çon në vdekjen e mikrorganizmit.

DO NOT COPY

të mozaikut, çka përbënte një përparësi absolute për mirëkonservimin dhe jetëgjatësinë e mozaikut të sapozbuluar.

Mbulimi i dyshemesë me mozaik

Pas dokumentimit grafik, analizës vizive të motiveve dhe ndërhyrjeve konservuese të lartpërmendura, u realizua mbulimi i saj. Mbi dysheme dhe strukturat pranë u vendos një shtresë polietileni dhe mbi të u hodh një sasi rërë e larë, me një spesor prej rreth 20 cm a më shumë. Mbi të u vendos një tjetër shtresë polietileni dhe në gjithë perimetrin e sondazhit përfshirë dhe dyshemenë me mozaik u realizua një rimbulim me dhé (backfilling), duke arritur nivelin e para gërmimit.

Mozaiku i fragmentuar në sektorin S16

Gjurmët e mozaikut të dytë u zbuluan gjatë gërmimeve në sektorin S16 në zonën e agorasë së qytetit antik. Dyshemeja e zbuluar, edhe pse e fragmentuar, përbën një risi në fondin e zbulimeve, por në të njëjtën kohë edhe një risi në korpusin e mozaikëve të Shqipërisë, për vetë faktin se këto lloje dyshemesh deri tani janë pak të dëshmuara. Mozaiku është realizuar jo me tesera por me zaje të dimensioneve relativisht të vogla, me ngjyrë të bardhë, të kaltër, të zezë dhe disa në ngjyrë rozë në të kuqërremtë. Po të hedhim vështrimin pas në histori, përgjithësisht gjurmët më të hershme të kësaj teknike, dëshmohen në qytetet e Greqisë dhe datohen në shek. V-IV p.Kr. Kjo teknikë arrin kulmin në Pela të Maqedonisë antike, ku pavarësisht tonalitetit të ngjyrave, janë realizuar imazhe kafshësh, skena gjuetie, episode nga mitologjia etj. Përsa i takon kronologjisë, ajo mbetet ende për tu përcaktuar në vazhdimësi.

Teknika e realizimit

Mozaiku është realizuar në teknikën *opus lapilli*, e cila është teknika më antike e njohur në realizimin e mozaikëve, apo e njohur edhe ndryshe si *lithostrota (nga greq.dysheme me gurë, zaje)*, teknikë e shtrimit të dyshemeve e lindur dhe përdorur më shumë për arsye praktike sesa estetike, me qëllim bërjen rezistente ndaj ujit dhe përdorimit të përditshëm dyshemetë me dhe të ngjeshur.

Gjurmët e kësaj dyshemeje i hasim të pakta dhe fragmentuara. Sikundër e përmendëm, ndërtimi i tij është i thjeshtë, ku dallohet pjesa niveluese e kalldrëmit *(statumen),* e cila përbëhet nga gurë lumi rrumbullakë, me madhësi mesatare, të vendosur direkt mbi dheun e ngjeshur.

Mbi ta u evidentua një shtresë llaçi gëlqeror, e cila luan funksionin e pastës dhe mbi të janë vendosur teserat, të cilat në rastin tonë janë zaje lumi të vogla, me formë të rregullt në përgjithësi, kryesisht me ngjyrë të bardhë, të kaltër në blu të errët, e cila ngjason edhe si e zezë dhe në një vend rozë në të kuqërremtë. Dyshemeja në përgjithësi ka dimensione diku tek 1.60 x 1.74 m, ndërsa vetë pjesa me zaje polikrome ruhet në përmasa 78 x 45 cm.

Gjurmët e tjera ku ruhen vetëm kalldrëmi dhe shtresa e pastës (llaçit) kanë dimensione rreth 2.50 x 1.50 m.

Dokumentimi dhe ndërhyrjet konservuese preliminare

Menjëherë pas daljes në dritë të dyshemesë u realizua dokumentacioni fotografik i përgjithshëm dhe ai i detajuar, si dhe dokumentacioni grafik, duke realizuar një prerje me qëllim evidentimin aq sa ishte e mundshme të shtresave të përgatitjes (Fig. 11) (Skica 3).



Fig. 11. Shtresat e evidentuara dhe dyshemeja me llaç gëlqereje në krah

DO NOT COPY

Për sa i takon motiveve për shkak se mozaiku ruhet në mënyrë të fragmentuar, u dallua vetëm pjesa e mundshme e bordurës e krijuar nga një radhë prej dy teserash (zaje) të bardha, si dhe në brendësi motive të realizuara me zaje të bardhë në sfond të kaltër.

Ndërhyrjet paraprake konservuese u përqendruan kryesisht në pastrimin nga dheu, në mënyrë mekanike, të shtresës së kalldrëmit dhe pastës bashkë me negativët e zajeve.

Me qëllim stabilizimin e gjendjes fizike të mozaikut dhe shtresave përgatitore dhe evitimin e mëtejshëm të shkëputjes së zajeve nga suporti, u mendua e arsyeshme konsolidimi i shtresës së pastës dhe dyshemesë prej llaçi gëlqeror në krah, duke përdorur konsolidantë me bazë 80% tetraetilsilikati në whitespirit, aplikuar me penel.

Gjithashtu, u realizua edhe pastrimi në të thatë i sipërfaqes me përdorimin e furçave dhe penelave me qime të buta (Fig. 12-13).

Pas ndërhyrjeve preliminare të lartpërmendura dhe për arsye të përfundimit të kohës së ekspeditës, u procedua me mbulimin e të gjithë sipërfaqes së dyshemesë me qëllim mbrojtjen e saj gjatë muajve të dimrit.

Në këtë kontekst, mbulimi i dyshemesë u realizua duke vendosur mbi dysheme një shtresë polietileni dhe mbi të u hodh një sasi rërë e larë, me një spesor prej rreth 20 cm.

Me qëllim shmangien e derdhjes së rërës nga pjesët anësore rreth e përqark ambientit u ndërtua një mur tulle në të thatë.

DO NOT COPY

monumentet
57/2018

Agron ISLAMI
MSc. Klejdi ZGURO

DO NOT COPY

NEW MOSAICS IN APOLONIA CONDITION, ANALYSIS AND CONSERVATION OF MOSAIC OF THE SONDAGE 4 AND PRELIMINARY INTERVENTIONS ON THE MOSAIC OF THE SECTOR S16-AGORA

These mosaics were found during the joint Albanian-French archeological expedition of the year 2011, in the ancient city of Apolonia. The first mosaic was discovered during a sondage conducted by expeditions at the east part of the roman house sector G. The mosaic is perhaps part of a building with a public character. The excavation of the floor mosaic continued in the same time with its conservation and analysis. After the excavation it was found that the state of conservation of the mosaic was relatively good, presenting mainly pathologies of physical nature. These pathologies are related with: Subsidence and detachments, lacunas, presence of burned surfaces(?). Regarding the other pathologies of biological or chemical nature they are less or not present, being limited to the possible presence of pathogenic elements mainly eterotrophic or autotrophic bacteria. The conservation consisted in: Making of edges, lacunas treatment, replace of the tesserae found in-situ, consolidation, washing of the surface with non ionic solutions. At the end of the above-mentioned conservative interventions was achieved the stabilization of the physical condition of the mosaic, which constituted an absolute priority for conservation and good newfound longevity mosaic. The mosaic is a polychrome one, realized in *opus tesselatum*, which consists in geometric motifs dominated by white areas. The main motif consists in two ellipses consisting of a row of black tesserae with dimensions 33 x 33 cm from one end to the other, which cuts each other in the middle, creating a square measuring 7 x 7 cm.

The traces of the second mosaic were discovered during the excavations in the sector S16 in the agora area of the ancient city. The discovered floor although fragmented, is novelty in the corpus of mosaics in Albania, due to the fact that these types of floor mosaics are less testimoned. The mosaic is realized not with tesserae but in pebbles relatively in small dimensions, white, blue, black and some pink to reddish. If we look back in history, the earliest traces of such mosaics are testimoned in the cities of Greece and dated to the 5th-4th centuries BC. This technique culminates in Pela, ancient Macedonia, where despite the tonal colors were carried images of animals, hunting scenes, episodes from mythology etc. Shortly after the discovery, was realized the general photographic documentation and graphic documentation by making an incision in order to identify the extent it was possible preparation layers of the mosaic. The preliminary conservation was focused mainly on cleaning of dust the lower layer, of the lime bed with the pebbles negatives. To stabilize

the condition of the mosaic and the preparation layers and to avoid further detachment of the pebbles from their support, it was thought necessary the consolidation of the lime bed layer and the mortar layer, using solutions based on 80% of tetraethyl silicate in white spirit, applied by brush. Also was made the cleaning of the surface using brushes and soft paintbrush.

The mosaic is realized in *opus lapilli* technique, or pebble mosaic, which is the most ancient technique known in the realization of mosaics, or otherwise known as *lithostrota* (from Greek. stone floor), technique born and used more for practical reasons than aesthetic, in order to make water resistant everyday use and compressed floors.

DO NOT COPY

Prof. Dr. Pirro THOMO
Ing. Rest. Alfred ÇOMA

DO NOT COPY

KISHA E LINDJES SË SHËN MARISË NË LABOVË TË KRYQIT – GJIROKASTËR

Punimet e restaurimit[1]

Kisha e Lindjes së Shën Marisë në Labovë të Kryqit – Gjirokastër është një nga kishat më me vlerë të Periudhës Bizantine, që ruhen në vendin tonë. Për vlerat e saj, ajo ka tërhequr interesin e shumë studiuesve vendas e të huaj, por dhe të një publiku të gjerë artdashës. Por, vështirësia e vizitave për shkak të rrugëve të papërshtatshme, bënte që numri i vizitorëve të binte, pavarësisht dëshirave dhe interesit të tyre.

1.Vështrim i shkurtër arkitektonik i monumentit

Kisha e Labovës së Kryqit ndodhet në mes të fshatit dhe me siluetën dhe ngjyrën e kuqërremtë të saj, ajo mbizotëron fshatin, sidomos kur e sodisim për së largu (Fig. 1). Sot kisha përmban shumë meremetime e shtesa të ndryshme, që i janë bërë në anën veriore, jugore dhe atë perëndimore, të cilat kanë fshehur shumë pjesë origjinale të saj. Gjithashtu, në gjendjen e sotme kisha përmban dhe shumë meremetime, përforcime dhe rindërtime



Fig. 1. Pamja e kishës para restaurimit

[1] Projekti i rehabilitimit të kishës së Shën Marisë në Labovën e Kryqit u hartua nga një grup autorësh të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Ing. Mirela Meçollari, Ark. Arben Spaho, Ark. Ronela Çuku, Ark. Olsi Bulku, Ing. Isida Hondro, Ing. Arben Dervishi dhe me konsulencën e Prof. Dr. Aleksandër Meksi. Projekti është miratuar nga KKR me Vendimin 126, dt. 25.05.2016. Punimet e restaurimit dhe konsolidimit u ndërmorën nga Shoqëria "AD-STAR" me Administrator Ing. Rest. Alfred Çoma dhe Drejtues teknik Prof. Dr. Pirro Thomo.

të një kohe më të mëvonshme. Studimet mbi këtë monument kanë evidentuar me saktësi fazat ndërtimore[2].

Në bazë të evidentimit të fazës së parë dhe të pamjes së pjesës së sipërme që ka mundur t'i shpëtojë fshehjes nga shtesat dhe rikonstruksionet e mëvonshme, bëhet e mundur të krijohet një përfytyrim mbi kompozimin planimetrik e vëllimor të kishës së fazës fillestare (Fig. 2).



Fig. 2. Planimetria me fazat e ndërtimit (sipas A. Meksit)

Nga hajati i vonë në anën perëndimore kalohet në narteksin shtesë dhe prej andej, me tri këmbë shkallë, hyhet në kishë. Naosi përbëhet nga hapësira qendrore nën kupolën, nga mjedisi i altarit dhe nga pjesët veriore, jugore dhe ajo perëndimore dykatëshe, e cila luan rolin e narteksit. Katër pilastra të fuqishme kufizojnë hapësirën qendrore, të cilat lidhen ndërmjet tyre me harqe dhe mbi të cilat nëpërmjet velave sferike trekëndëshe, *pandativat*, ngrihet tamburi rrethor që mban kupolën. Mjedisi i altarit veçohet nga pjesa qendrore me anë të një ikonostasi prej druri të gdhendur dhe i praruar i një vlere të lartë artistike, vepër e vitit 1805 (Fig. 3). Ambientet anësore veriore, jugore dhe perëndimore luajnë rolin e krahëve të kryqit d`he janë të mbuluara me qemere cilindrike, që hapen ndaj hapësirës qendrore. Ato ndahen nga hapësira qendrore me harkada të larta dekorative dyfishe me tri hapësira, të ndara nga kolonat rrethore me kapitele korinthike të stilizuara (Fig. 4).

Një kufizim i tillë i ambientit qendror, nga njëra anë nga ikonostasi dhe nga tri anët e tjera nga harkadat dekorative, si dhe e fuqizuar me elemente të tjera artistike, si froni peshkopal dhe amvoni, e thekson akoma më tepër rolin e tij si qendër e rëndësishme kompozicionale dhe funksionale, duke i nxjerrë në plan të dytë pjesët anësore. Me këtë kompozim kisha shëmbëllen me ndërtimet me mjedisin qendror me kupolë mbi pilastra dhe harkada, të njohura nga arkitektura bizantine, duke filluar nga shek. VII me Shën Sofinë e Selanikut dhe duke vazhduar deri në shek. XII-XIII me kishat e Konstandinopojës apo Artës[3].

Për sa i përket trajtimit të pamjeve të jashtme ai i përgjigjet kompozimit vëllimor të kishave në formë kryqi me kupolë, ku kemi një shkallëzim piramidal të vëllimeve (Fig. 5).

Edhe këtu mbizotëron vëllimi i pjesës qendrore me kubin bazë, mbi të cilin ngrihet tamburi i lartë rrethor, i kurorëzuar me kupolë, ku vijnë dhe i bashkëngjiten çatitë e katër krahëve të kryqit dhe, më poshtë, çatitë e katër ambienteve këndore. Në ndryshim me kompozimin e brendshëm, ku përmasat e krahëve të kryqit janë të kufizuara në raport me ato të hapësirës qendrore, në pamjet e jashtme ato marrin pjesë në kompozim dhe theksohen nëpërmjet çative dyujëse dhe frontoneve trekëndëshe.

[2] MEKSI, A., "Dy kisha bizantine në rreth të Gjirokastrës", *Monumentet*, Tiranë, 1975, 9.

[3] MEKSI, A., *Vep. Cit.*

DO NOT COPY



Fig. 5. Kompozimi vëllimor i jashtëm (sipas A. Meksit)

2. Dëmtimet e monumentit dhe ndërhyrjet përforcuese në kohë

Që në analizën e parë bie në sy se monumenti përmban shumë ndërhyrje, të cilat janë realizuar si rezultat i dëmtimeve serioze të shkaktuara gjatë kohës. Së pari, inklinimi i tamburit të kupolës në drejtimin juglindor ka shumë gjasë të jetë shkaktuar nga ndonjë cedim i menjëhershëm i mbështetjes juglindore të sistemit konstruktiv qendror, cedim, i cili do të ketë ndaluar deri sa ka arritur në terren të fortë. Dy studimet gjeologjike për kushtet gjeologjike të terrenit të kishës[4], si dhe shpimet në brendësi të kishës faktuan se terreni mbi të cilin mbështetet kisha është i qëndrueshëm dhe i fortë[5]. Inklinimi i tamburit të kishës është vënë re shumë kohë më parë, që para rreth mbi 150 vjetëve, nga udhëtarë të huaj.... Përderisa tamburi i rezistoi shembjes gjatë këtij intervali kaq të gjatë kohor, dëshmon, ndërmjet të tjerave, se cedimi i tij nuk ka avancuar.

Përveç inklinimit të kupolës, elemente shtesë dhe gjurmë meremetimesh e rindërtimesh vërehen me shumicë në monument.

Në brendësi mbështetjet masive të bërthamës qendrore janë mbathur me muraturë shtesë (Fig. 6), po kështu dhe kolonat e harkadës perëndimore (Fig. 7).



Fig. 6, 7. Ndërhyrjet përforcuese në brendësi të kishës

[4] *Raport mbi kushtet gjeologo-inxhinierike të vendit ku është ndërtuar kisha e Kryqit të Mirë në Labovën e Sipërme, Libohovë,* nga Ing. Gjeolog Skënder ALLKJA, Ing. Besian Xhagolli, Ing. Gjeoteknik Ardita MALAJ, Tiranë, maj 2017, Arkivi i IMK

[5] *Raport mbi kushtet gjeologo-inxhinierike të vendit ku është ndërtuar kisha e Kryqit të Mirë në Labovën e Sipërme, Libohovë, Raport shtesë* nga Ing. Gjeolog Skënder ALLKJA, Ing. Gjeoteknik Ardita MALAJ, Tiranë, tetor, 2017, Arkivi i IMK

DO NOT COPY

Me muraturë shtesë janë përforcuar dhe harqet e sipërme të harkadës veriore dhe perëndimore (Fig.8). Në pamjet e jashtme frontoni jugor (Fig. 9) dhe e gjithë faqja lindore së bashku me tri apsidat (Fig.10),



Fig. 8. Ndërhyrjet përforcuese në brendësi të kishës



Fig. 9. Rindërtimi i krahut jugor të kishës

janë të rindërtuara në një kohë të dytë. Në se do t'i referohemi mbishkrimit të murosur në murin e apsidës qendrore (Fig.11), ky rindërtim duhet të jetë bërë në datën 1776 nga Papa Zoto. Këto rindërtime dhe përforcime do të jenë provokuar nga një dëmtim shumë serioz i



Fig. 10. Rindërtimi i murit lindor të kishës



Fig. 11. Mbishkrimi me datën dhe autorin e rindërtimit

monumentit, që ka shpënë madje edhe shkatërrimin e pjesshëm të tij.

Dëmtimet e mësipërme, por dhe shkaqe të tjera në kohë, si dhe mungesa e mirëmbajtjeve sistematike kishin shkaktuar çarje të shumta në gjithë sistemin konstruktiv të kishës.

DO NOT COPY

3. Gjendja statike e monumentit dhe ndërhyrjet konsoliduese dhe restauruese

a) Zbulimi i çatisë

Ndonëse në vështrimin e parë kisha nuk paraqiste shenja të ndonjë dëmtimi të dukshëm, zbulimi i çatisë nga mbulesa me plloça guri i gjendjes aktuale do të ishte një nga proceset e para gjatë ndërhyrjeve restauruese dhe konsoliduese. Kryerja e këtij procesi do të na zbulonte gjendjen e strukturës konstruktive nën mbulesë dhe, nga ana tjetër, do t'i jepte zgjidhje njësupozimi mbi mbulesën origjinale të kishës: ishte kjo me rrasa guri, apo me tjegulla dhe mbulesa aktuale me rrasa guri ishte si rezultat i një meremetimi të mëvonshëm? Ky supozim kishte bazë sepse, të paktën deri më sot nuk kemi asnjë kishë të periudhës bizantine të mbuluar me rrasa guri, por me tjegulla. Edhe në ato monumente të së njëjtës gjini e periudhë që ishin të mbuluara me rrasa guri, si në kishën e Shën Marisë në Kosinë të Përmetit, Shën Triadhën në kalanë e Beratit[6], Shën Marisë në Zervat të Gjirokastrës[7] u zbuluan tjegulla nën mbulesën me rrasa guri. Por, mbulesë origjinale me tjegulla u zbuluan edhe në monumentet, ku kisha ishte mbuluar me tjegulla të reja dhe të ndryshme nga ato origjinalet, si në kishën e manastirit të Zvërnecit (Fig. 12), të manastirit të Apolonisë (Fig. 13) etj.

Konstatimi i përdorimit të tjegullave të tipit bizantin në mbulesën e kishës, si në një kulmar, ose të vendosura në rrëzë të tamburit (Fig. 14.1,2), nuk do të ishte i mjaftueshëm për të konkluduar për mbulesën origjinale, sepse tjegullat e rivendosura mund të mos ishin të monumentit tonë. Duheshin gjetur prova më të



Fig. 12. Kisha e manastirit të Shën Marisë, Zvërnec. Zbulimi i tjegullave origjinale



Fig. 13. Kisha e manastirit të Shën Marisë, Apoloni. Zbulimi i tjegullave origjinale

pakontestueshme për vërtetimin e hipotezës së ngritur. Zbulimi i kujdesshëm i mbulesës së kupolës nxori në dritë tjegulla të fiksuara me llaç mbi konstruksionin e kupolës dhe me të njëjtat përmasa me tjegullat e ripërdorura (Fig. 15). Është pikërisht ky fakt, gjetja e tjegullave *in situ*, d.m.th. të fiksuara me llaç në

[6] THOMO, P., "Mbi dy monumente të arkitekturës sonë mesjetare në shek. XI-XIV", *Studime Historike*, Tiranë, 1972, 4; MEKSI, A., "Tri kisha bizantine të Beratit", *Monumentet*, Tiranë, 1972, 4; MEKSI, A., "Restaurimi i kishës së Kosinës në Përmet", *Restaurimi*, 1985, 2, f. 11-14

[7] THOMO, P., "Konsolidimi dhe restaurimi i kishës "Fjetja e Shën Marisë" në Zervat të Gjirokastrës", *Monumentet*, f. 17-65, Tiranë, 51/2009-2010

DO NOT COPY



Fig. 14.1,2. Tjegulla të tipit bizantin të ripërdorura në mbulesën e kishës



Fig. 15. Tjegulla origjinale të zbuluara në konstruksionin e kupolës

strukturë, që përbën një provë mjaft bindëse se mbulesa origjinale ka qenë me tjegulla. Përmasat e tjegullave janë: ullukët 50x32x2 cm dhe kanë një kurbëzim të lehtë, ndërsa kapakët kanë përmasa 50x23x2 cm me kurbëzim normal.

Mbas këtij zbulimi u propozua që të rikthehej mbulesa origjinale me tjegulla. Ky propozim mbështetet së pari në Kartën e Venecies, e cila në nenin 11 thekson *"... **nxjerrja në shesh e një faze para ardhëse nuk justifikohet veçse jashtëzakonisht dhe me kusht ...që kompozimi i nxjerrë në dritë të përbëjë një dëshmi të një vlere të lartë historike, arkeologjike ose estetike dhe që gjendja***

DO NOT COPY

e konservimit të saj të konsiderohet e mjaftueshme...".

Pra këtu kemi një rast tipik ku mund të aplikohet ky parim bazë:

a) Mbulesa me rrasa guri nuk është si rezultat i nevojës për përmirësim funksioni ose i ndonjë arsye tjetër që do ta pasuronte monumentin nga pikëpamja funksionale, arkitektonike apo konstruktive, por për nevojë meremetimi dhe mungesë të materialit origjinal.

b) Mbulesa origjinale me tjegulla ka një interes të lartë arkeologjik dhe estetik, që e kompleton arkitekturën e këtij monumenti tepër të rëndësishëm të arkitekturës bizantine në vendin tonë.

c) Mbushja mbi konstruksionin e kurbëzuar e kupolës dhe krahëve të kryqit me mbeturina gurësh, së bashku me mbulesën e rrasave të gurëve, kanë një peshë shumë të konsiderueshme, e cila ka një impakt negativ mbi aftësinë mbajtëse të monumentit edhe kështu shumë e dëmtuar. Mbështetur në këtë argumentim, Këshilli Kombëtar i Restaurimit miratoi propozimin për mbulimin e kishës me tjegulla me të njëjtat përmasa, forma e karakteristika tekniko-mekanike, si ato të zbuluarat[8].

Nga zbulimi i çatisë nga rrasat e gurit u pa se mbi strukturën e kupolës kishte një mbushje të konsiderueshme mbeturinash, që shkonte deri në 30 cm. Zbulimi i çatisë nxori në dukje gjithashtu dhe mënyrën e ndërtimit të kupolës. Ajo është ndërtuar me tulla të vendosura këlliç në rrathë koncentrikë dhe me fugatura të gjera llaçi. Gjendja e konstruksionit të kupolës linte për të dëshiruar: vëreheshin mungesa tullash, dekompozim të llaçit lidhës dhe, vende-vende, zëvendësim të tyre me plloça guri (Fig. 16).

Më e papritur ishte gjendja e konstruksionit të krahëve të kryqit, të zbuluar mbas heqjes së plloçave të gurit. Krahët verior dhe perëndimor ishin ndërtuar me tulla (Fig. 17). Ndryshe nga dy qemerët e mësipërm, qemeri i krahut jugor ishte ndërtuar tërësisht me gurë, ndërsa nuk ishte ruajtur asnjë gjurmë nga qemeri origjinal me tulla, dëshmi kjo e një rindërtimi tërësor të kësaj pjese (Fig. 18).



Fig. 16. Gjendja e kupolës mbas zhveshjes së mbulesës me rrasa guri



Fig. 17. Konstruksioni i qemerëve të krahëve të kryqit

Gjendja statike e qemerëve të krahëve të kryqit mund të konsiderohej me gjithë kuptimin e fjalës katastrofike. Ato kishin çarje të shumta, deformacione dhe shkëputje të tilla që i kishin shpënë ato në një gjendje tërësisht

[8] Vendimi nr. 43, datë 08.03.2017 i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve

DO NOT COPY



Fig. 18. Konstruksioni i qemerit të krahut jugor të kryqit

jashtë funksionit, sa që ishte e habitshme se si mund të mos shembeshin nga ngarkesa e mbulesës me pllloça guri (Fig. 19.1,2,3).

Kërkimet e mëtejshme zbuluan se gjatë rindërtimeve, meremetimeve dhe punimeve përforcuese të kryera për shmangien e rrezikshmërisë së shembjes, nën harqet



Fig. 19.1. Gjendja e konstruksionit të qemerëve të krahëve të kryqit





Fig. 19.2,3. Gjendja e konstruksionit të qemerëve të krahëve të kryqit

DO NOT COPY

origjinale ishin ndërtuar harqe të reja, të cilat morën tashmë rolin mbajtës të sistemit konstruktiv, duke lënë harqet origjinale krejtësisht pa funksion (Fig. 20.1,2).



Fig. 20.1,2. Gjurmë të dublimit të qemerëve të krahëve të kryqit

Një e dhënë me interes që u përfitua nga zhveshja e mbulesës së çative ishte zbulimi i elementeve mbajtëse të sistemit konstruktiv, sidomos të bërthamës qendrore. Gjatë këtij procesi dolën në dritë katër harqe të fuqishme mbajtëse të bërthamës qendrore, që lidhin pilastrat mbi të cilat ngrihet tamburi i kurorëzuar nga kupola (Fig.21.1,2,3,4). Një skemë e tillë konstruktive dallon nga skema e zakonshme e kishave të vogla të tipit në formë kryqi me kupolë, ku tamburi i kupolës mbështetet mbi qemerët e krahëve të kryqit. Kemi të bëjmë pra me një skemë të re, ku bërthama qendrore



Fig. 21.1,2. Harqet mbajtesë të kupolës

DO NOT COPY



Fig. 21.3,4. Harqet mbajtesë të kupolës



Fig. 22. Skema konstruktive e bërthamës qendrore

DO NOT COPY

e përbërë nga mbështetjet masive, harqet mbajtëse që mbështesin tamburin me kupolën nëpërmjet velave trekëndëshe sferike, kanë formuar një njësi më vete, të pavarur nga strukturat anësore të kishës (Fig. 22)[9]. Dhe ashtu si në brendësi, ambientet anësore, që luajnë rolin e krahëve të kryqit, figurativisht mbeten në plan të dytë, edhe konstruktivisht, në raport me pjesën qendrore, ndodh e njëjta gjë. Qemerët e mbulimit të krahëve të kryqit thjesht i bashkëngjiten bërthamës qendrore duke u futur nën qemerët mbajtëse të tamburit dhe, në këtë mënyrë, ato nuk marrin pjesë në sistemin mbajtës të bërthamës qendrore (Fig. 23).

Cedimi eventual i pilastrit juglindor, që mund të ketë shkaktuar inklinimin e tamburit, apo rrënimi i murit lindor dhe krahut jugor të kryqit, nuk shkaktuan ndonjë dëmtim serioz të bërthamës qendrore, si në

[9] MEKSI, A., THOMO, P., "Sistemi konstruktiv i kishës së Shën Marisë në Labovë të Kryqit – Gjirokastër", *Monumentet*, 56



DO NOT COPY

Fig. 23. Skema konstruktive e kishës

muraturën e tamburit, ashtu dhe në konstruksionin e kupolës, në një kohë kur në strukturat e krahëve të kryqit u vërejtën dëmtime shkatërruese. Ishte pikërisht kjo pavarësi statike e bërthamës qendrore që i ka dhënë asaj një kompaktësi dhe soliditet të tillë, që ka mundur të përballojë tronditjet e mësipërme të ndërtesës.

Harqet mbajtëse në tri anët e bërthamës qendrore, në ato veriore, perëndimore dhe jugore ruheshin në një gjendje relativisht të mirë dhe me konfiguracion të plotë. Përkundrazi, harku mbajtës lindor u gjet tepër i dëmtuar, me çarje të thella që shkëpusnin pjesë nga njëra-tjetra, prishje e konfiguracionit, si dhe cedime. Në krahasim me harqet e tri faqeve të tjera, me matjet në kulmet e harqeve, harku lindor ka një cedim prej rreth 12 cm. Çarje të shumta dalloheshin dhe në muraturën e vëllimit kubik nën tambur. Të gjitha këto dëmtime mund të kenë rrjedhur gjatë rrënimit të anës lindore të kishës (Fig. 24).

b) Ndërhyrjet konsoliduese

Gjendja kritike e konstruksionit të kurbëzuar e zbuluar mbas zhveshjes së mbulesës kërkonte ndërmarrjen e masave të menjëhershme konsoliduese.

Ndërhyrjet në konstruksionin e kupolës konsistuan në:



Fig. 24. Gjendja e harkut mbajtës lindor

- largimin e mbushjeve dhe mbeturinave nën mbulesën e çatisë;
- pastrimin e mirë të sipërfaqes dhe fugave nga mbeturinat dhe llaçit të dekompozuar;
- fugatimit me llaç të freskët dhe plotësimit me tullat e munguara dhe të zëvendësuara;
- përforcimin e konstruksionit të kurbëzuar me fibra karboni;
- shtrimit me një shtresë termoizoluese dhe respiruese të kupolës me llaç horasan.

Përforcimi i kupolës u realizua me katër fibra karboni 5 cm të vendosura sipas meridianëve, duke e ndarë sipërfaqen e kupolës në tetë segmente sferike dhe duke u fiksuar në një fibër të vendosur në bazën e gjysmësferës së kupolës (Fig. 25). Fibrat e karbonit u shtruan mbi një shtresë shumë të fortë llaçi, në mënyrë që të mos ishin në kontakt të drejtpërdrejtë me konstruksionin e kupolës, meqenëse gjatë punës



Fig. 25. Konsolidimi i kupolës

së tyre krijohen tensione të tilla që mund të dëmtonin strukturën me tulla të kupolës.

Në varësi të gjendjes tepër të degraduar të qemerëve të krahëve të kryqit ndërhyrjet në to u bënë më të thella se në mbulesën e kupolës. Ato konsistuan në plotësimin dhe zëvendësimin e tullave të thyera apo të munguara të qemerëve verior dhe perëndimor, ashtu dhe të gurëve të qemerit jugor, qepjen e të çarave si me metodën shqep-qep, ashtu dhe qepjen e tyre me shufra hekuri inoksidabël, si dhe me fugatimin e thellë me llaç të freskët. Ishin pikërisht ndërhyrjet e pastrimit dhe konsolidimit të qemerëve ato që zbuluan dhe përforcimin ose dublimin e tyre më harqe shtesë. Megjithëatë u pa e arsyeshme që të ndërhyhej për t'i rikthyer në punë dhe harqet origjinale, të cilat kishin humbur funksionin e tyre mbajtës dhe për të krijuar kështu një shtresë kompakte, ndonëse të dubluar. Përforcimi i mëtejshëm me fibra karboni do të kishte efekt jo vetëm për qemerët e riaftësuar origjinalë, por edhe për gjithë qemerin tashmë të dubluar të krahëve të kryqit (Fig. 26). Mbas konsolidimit mbi qemer u hodh shtresa e horasanit dhe kupola u bë e gatshme për mbulesën me tjegulla.

Gjendja statike e harqeve të bërthamës qendrore, me përjashtim të harkut lindor, ishte përgjithësisht e mirë, kështu që konsolidimi i tyre u kufizua me fugatimin dhe

DO NOT COPY



Fig. 26. Konsolidimi i qemerëve të krahëve të kryqit

plotësimin e elementeve të dëmtuar apo të munguar.

Problem serioz paraqiste harku lindor, i cili kishte pësuar dëmtime të tilla, si çarje, që i kishin ndarë pjesët nga njëra-tjetra dhe shkëputje fragmentesh nga tërësia e harkut, të cilat e bënin atë të dilte krejtësisht jashtë funksionit. Këto dëmtime, duke i lidhur dhe me dëmtimet e të njëjtës shkallë të ambientit këndor juglindor, mund të jenë shkaktuar nga presioni i ushtruar gjatë cedimit të tamburit. Por ato mund të jenë shkaktuar dhe gjatë rrëzimit të pjesës lindore dhe e një pjese jugore të kishës. Synimi i ndërhyrjes në këtë rast ishte riaftësimi i harkut, për t'ia rikthyer funksionin e tij si pjesë e sistemit konstruktiv të bërthamës qendrore. Kjo u arrit me rindërtimin e pjesshëm të strukturës munguese dhe të shkëputjeve të pjesëve nga njëra-tjetra (Fig. 27).



Fig. 27. Harku mbajtës lindor mbas konsolidimit

Gjatë procesit të konsolidimit të konstruksionit mbajtës, harqeve dhe qemerëve, u ndërhy edhe për eliminimin e dëmtimeve që u shfaqën në pjesë të ndryshme të muraturës, kryesisht çarjeve, me metodat tashmë të njohura, plotësimet dhe zëvendësimet e elementeve munguese dhe të dëmtuara, qepjet me shufra metalike inoksidabël, injektimeve pjesore etj.

Ndërhyrjeve të këtij karakteri iu nënshtruan dhe muraturat e timpaneve të frontoneve, të cilat ishin dëmtuar rëndë edhe nga dekompozimi i qemerëve të krahëve të kryqit (Fig. 28.1, 2). Gjatë këtyre ndërhyrjeve nuk mund të shmangej dhe ndërhyrja për ripërtëritjen e dekoracionit që ato përmbanin.

c) Ripërtëritja e dekoracionit

Siç e kemi vënë në dukje, kisha e Labovës së Kryqit shquhet për dekoracionin e pasur keramoplastik, e cila i ka dhënë asaj dhe vlera të spikatura estetike. Kompozimi i dekoracionit në tamburin e kupolës dhe në frontonet e krahëve të kryqit karakterizohet nga një rregullsi gjeometrike. Dekoracioni është i formuar nga breza horizontalë të mbushura me motive gjeometrike, katrorë, rombe, trekëndësha, tulla të vendosura këlliç (vertikalisht), alternime motivesh në formë

DO NOT COPY





Fig. 28.1,2. Punime për konsolidimin e qemerëve të krahëve të kryqit

kurrizpeshku me katrorë etj. Elemente karakteristike të dekoracionit janë kornizimet në formë dhëmbë sharrë që mbyllin muraturat nën çatitë, brezat me përmbajtje të plotë apo të pasuruara me elemente të tjera, si dritare e nike të verbëta, që qarkojnë këto të fundit. Dallojmë dy lloje kornizash: korniza me një radhë në formë dhëmbësharre, ndërmjet dy radhëve me tulla të drejta dhe korniza me dy radhë në formë dhëmbësharre ndërmjet radhëve me tulla të drejta (Fig. 29.1,2). Llojin e parë, kornizat me një radhë në formë dhëmbësharre,



Fig. 29.1 Tipet e kornizave dekorative në formë dhëmbë share

DO NOT COPY



Fig. 29.2 Tipet e kornizave dekorative në formë dhëmbësharre

e gjejmë te qarkimi i dritareve e nikeve, kornizimin nën çati të muraturës të kubit të tamburit dhe në ndarjen e brezave me përmbajtje të ndryshme dekorative. Lloji i dytë i kornizave është i pranishëm në kornizimin nën çati të tamburit dhe të frontoneve të krahëve të kryqit.

Me kalimin e viteve edhe dekoracioni kishte pësuar dëmtime. Ato kishin rrjedhur si pasojë e dëmtimeve dhe rindërtimeve të konstruksionit të pjesëve të ndryshme të kishës, por dhe për arsye të mosmirëmbajtjes që shfaqen në pjesë munguese apo të dëmtuara, si dhe me riparime e plotësime të pakujdesshme. Ripërtëritja e dekoracionit të dëmtuar do t'i rikthente monumentit atë vlerë estetike për të cilën është dalluar.

Nga njëra anë, ndërhyrja në dekoracion ishte e detyrueshme kur do të kryheshin ndërhyrjet konsoliduese të strukturës së monumentit, siç ishte rasti i timpaneve të frontoneve perëndimor, verior dhe lindor (Fig. 30, 31). Po kështu, rimbulimi i kishës me plloça guri nuk kishte respektuar kudo kuotën e mbulesës origjinale me tjegulla (Fig. 32). Nga ana tjetër, duke pasur parasysh karakterin strikt gjeometrik dhe shpërndarjen tepër të njëtrajtshme të motiveve në çdo rrip apo brez, plotësimi i ndonjë fragmenti mungues apo zëvendësimi i pjesëve të dëmtuara do të ishte një kriter i pranueshëm në këtë rast, për t'i rikthyer atë unitet stilistik që monumenti e ka si vlerë estetike[10].

Në këtë rivlerësim kontribuoi dhe pastrimi i pjesës veriperëndimore të tamburit, i cili ishte veshur me një shtresë algash gri në të gjelbër, të rrjedhur sigurisht nga prezenca e lagështisë. Jashtë këtij përpunimi mbeti frontoni jugor, i cili, si një rindërtim i një faze të dytë, do të ishte si një dëshmi i këtij rindërtimi (Fig. 33).

Mbas konsolidimit të strukturave konstruktive dhe përpunimit të sipërfaqeve të tyre, si dhe plotësimit të kornizave në kuotat e duhura, u vendosën tjegullat mbi një shtresë llaçi. Tjegullat u prodhuan në mënyrë artizanale, me përmasat origjinale dhe me cilësi tekniko-mekanike të përafërta me origjinalet.

[10] Feilden, B.M., Jokilehto, J., *Udhëzues për menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore Botërore*, botim i CHWB, 2010, fq. 89

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 30,31. Ripërtërirja e dekoracionit në frontorin verior e perëndimor

d) Elemente të reja të zbuluara gjatë ndërhyrjeve

Interpretimi i duhur i monumentit dhe historiku i ndërtimit të tij formojnë kornizën e qasjes sonë nëpërmjet hartimit të një vlerësimi të vlerave të tij. Zgjidhjet për punimet konsoliduese, janë hartuar duke patur parasysh, në rradhë të parë, ekuilibrin midis elementëve të dukshëm dhe të padukshëm të ndërtesës (dëmtimet e muraturës, afresket si dhe fragmentet me vlera të integruara në ndërtim). Në vijim të hartimit të një analize grafike të dëmtimeve, ne propozojmë që ndërhyrjet për ruajtjen e monumentit të kenë ndikim sa më të vogël të mundshëm në vlerat e tij. Në të njëjtën kohë, ne paraqesim një numër rekomandimesh për restaurimin e monumentit, duke përdorur metodën e skenareve, kryesisht të bazuar në punime konsoliduese të zbatuara.

Duke patur parasysh faktin se ekspertiza jonë mbulon kryesisht spektrin e njohurive të një arkitekt-inxhinieri, propozimet tona u përqëndruan në përzgjedhjen dhe organizimin e punimeve që duhet të kryhen si dhe përcaktimin e fushave të ekspertizës. Gjendja dhe rëndësia e këtij monumenti të kategorisë së parë,

DO NOT COPY

kërkojnë urgjentisht një grup ekspertësh që do të bashkëpunojnë për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të mëdha të tij. Ne shpresojmë që ky studim të kontribuojë në promovimin e rëndësisë të monumentit dhe zonës përreth, drejt këtij qëllimi. Eshtë gjithashtu tepër e rëndësishme që ky monument të vazhdojë të jetë pjesë e pandarë e historisë dhe pejzazhit të luginës së Drinosit në Rajonin e Gjirokastrës.

DO NOT COPY

monumentet
57/2018

Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

RESTAURIMI I ANSAMBLIT URBANISTIKO-ARKITEKTONIK I RRUGËS "KARDINAL MIKEL KOLIQI" (RRUGA GJUHADOL), SHKODËR

Shkodra, kryeqendra e Shqipërisë së Veriut, gjatë shekullit VIII, ishte një nga qytetet më të zhvilluara të kësaj treve edhe në rang vendi. Si çdo qytet edhe Shkodra kishte pazarin e saj[1], i cili shtrihej në jugperëndim të qytetit të sotëm, rrëzë kalasë Rozafat dhe përfshinte një zonë të rrafshtë që arrinte deri në brigjet e liqenit. Prej tij sot nuk ruhen gjurmë. Së pari, Pazari përmendet nga fundi i shekullit XV[2]. Në vazhdim të shekujve ai u rrit, duke arritur në shek. XIX, sipas të dhënave të shumta, në një nga qendrat më të zhvilluara zejtaro-tregtare të vendit.

Krijimi i Drinasit dhe zgjerimi i Bunës në drejtim të fushës më 1860, që rrënoi pjesën më piktoreske dhe më të rëndësishme të pazarit, u bënë shkak për shpejtimin e shpërnguljes së qytetit nga periferia e ulët rreth kalasë, në drejtim të rrafshit verior dhe krijimit këtu të zonave të reja të banimit[3].

Shtrirja e plotë e qytetit në zonën e re, në fundvitet e shek. XIX dhe fillimvitet e shek. XX, përkon me zvogëlimin e aktivitetit zejtaro-tregtar të pazarit dhe krijimin e një qendre të re tregtare ekonomike me një arkitekturë të re[4], udhëhequr nga kritere të tjera më të përparuara për kohën, e cila zëvendësoi gradualisht qendrën tradicionale, Pazarin e vjetër të Shkodrës. Kështu, gjatë një periudhe kohe prej rreth gjysëm shekulli, në Shkodër kemi bashkekzistencën e funksionimit të dy qendrave, qendrës tradicionale, Pazarit të Vjetër dhe qendrës së re tregtare, e cila përbën një dukuri të re në qytetet e vendit tonë.

Qendra e re tregtare e qytetit të sotëm përbëhet pjesërisht nga ansamblet urbanistiko-arkitektonike të tre rrugëve karakteristike, rruga "Kol Idromeno", rruga "13 Dhjetori", si dhe rruga "Kardinal Mikel Koliqi" të cilat, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 249, datë 01.07.1980 janë vënë në mbrojtje si Qendra Historike e qytetit. Këto ansamble ruajnë vlera të rëndësishme të veprimtarisë ndërtimore të fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX dhe përbëjnë njëherazi dëshmi të zhvillimit ekonomiko-tregtar të qytetit për atë periudhë (Fig. 1).

Ky artikull, do të trajtojë kriteret dhe problematikat e ndërhyrjes restauruese në ansamblin urbanistiko-arkitektonik të rrugës "Kardinal Mikel Koliqi", me vlera historike, urbanistike, arkitektonike dhe artistike

[1] Dizdari, R. Pazari i vjetër i Shkodrës, *Monumentet* 5-6/1973
[2] Shkodra, Z. *Esnafët shqiptarë.* Tiranë 1973, f. 37.
[3] Riza, E. Ansamblet ndërtimore të pazareve dhe restaurimi i tyre, *Monumentet* 15-16 /1978
[4] Prifti, SH. Restaurimi i rrugës "Enver Hoxha" në zonën muze të qytetit të Shkodrës, *Monumentet* 1/1983

të periudhës së fundshek. XIX dhe fillimshek. XX.

Rruga "Kardinal Mikel Koliqi" në vite ka marrë emërtime të ndryshme, të ndikuara dhe nga sistemet shoqërore. Në fillimet e saj, siç del dhe nga një hartë (Fig. 2), ajo ka pasur emërtimin "Rruga e Godartit", në vite është quajtur "Rruga Franc Ferdinand", më vonë mori emërtimin tradicional "Rruga Gjuhadol", më pas, gjatë sistemit socialist, ajo u emërtua "Rruga Branko Kadia" dhe mbas vitit 1990 ajo u quajt "Rruga Kardinal Mikel Koliqi". Që nga viti 2012 me vendim të Bashkisë Shkodër, rimori emrin e vjetër tradicional "Rruga Gjuhadol", emërtim që e mban edhe sot.



Fig. 2 Fragment i hartës së vjetër të Shkodrës

Meqënëse Projekti i Restaurimit përmban emërtimin e rrugës "Kardinal Mikel Koliqi", artikulli do t'i referohet këtij emërtimi.

Karakteristikat e përgjithshme urbanistiko-arkitektonike të ansamblit

Rruga "Kardinal M. Koliqi" është një fragment rrugor me gjatësi rreth 450 m dhe zhvillohet në formë gjarpërushe (Fig. 3). Rruga, në të dy krahët e saj ka të vendosura rradhazi ndërtesa përgjithësisht dykatëshe dhe dyqane përdhese, "dugajet", të cilat ndërpriten shpesh nga porta karakteristike, muret e avllive apo rrugicat tërthore shpesh pa krye. Në tërësinë e saj, ajo përbën një ansambël urbanistiko-arkitektonik karakteristik të periudhës së fundshekullit XIX dhe fillimshekullit XX. Në dy rrugët e para të Qendrës Historike, rrugën "Kol Idromeno"dhe rrugën "13 Dhjetori", si arterie kryesore të qytetit, marrëdhëniet e reja ekonomiko-shoqërore u pasqyruan ndjeshëm në karakterin urbanistiko-arkitektonik të këtyre ansambleve, me rrugë të drejta e të gjera, ndërtesa dy e trekatëshe e hapësira të bollshme për tregtim e banim, ndërkohë, që në rrugën "Kardinal M. Koliqi", si një rrugë dytësore e qytetit, u ruajtën me konservatorizëm ndërtimet e vjetra, përgjithësisht ato përdhese të trashëguara nga qendra tradicionale e qytetit.

Dokumentacioni fotografik (Fig. 4, 5) jep mjaft të dhëna mbi zhvillimin në kohë të rrugës "Kardinal M. Koliqi"[5]. Ndërtimet në të dy krahët e saj kanë pësuar transformime në vëllim, lartësi, në shtrirje, si dhe në trajtimin arkitektonik të pamjeve të jashtme.

Ndërtimet e dhjetëvjeçarëve të fundit të shek. XIX, fillimit të shek. XX në kryqëzimin në hyrje të rrugës "Kardinal M. Koliqi" njihen me emërtimin tradicional "Dugajt e Reja". Në rrugë dhe "Dugajt e Reja" gjejmë mjaft paralelizma me ndërtimet e pazarit të vjetër (Fig. 6, 7), siç janë dyqanet përdhese, diku dhe dykatëshe, strehët e gjera prej druri dhe muratura të gurta, trajtimi i dyerve, dritareve e tarabave, muret e larta rrethuese prej guri të avllive dhe portat e mëdha të drurit, mbërthyer me gozhdë kovaçi e çati me lëndë druri. Kjo shpjegohet me bashkekzistencën që kanë pasur për një farë kohe pazari tradicional me qendrën

[5] Materiali fotografik është gjetur në Fototekën Marubi të qytetit të Shkodrës.

DO NOT COPY









Fig. 4, 5. Foto të vjetra të rrugës “Kardinal M. Koliqi”

Fig. 6, 7. Foto të Pazarit të Vjetër të Shkodrës

DO NOT COPY

e re të qytetit, me tendencë përshtatjeje me zhvillimet e kohës.

Në ndërtimet e trashëguara nga qendra e vjetër, strehët përgjithësisht janë tavanore druri apo suvaje të dala rreth 30-40 cm nga muratura e ndërtesës, të ruajtura deri në ditët e sotme. Strehët pajisen me ullukët horizontal dhe vertikal prej llamarine, ku ruhen ende në shumë raste shkarkuesit karakteristik prej llamarine, mjaft të veçanta për stilizimin e formave dhe të përmbajtjes së tyre, si kokë kuçedre etj. (Fig.8). Ndryshime kemi në trajtimin e mbulesës së çatisë me tjegulla vendi, ku të bie në sy vendosja e shpeshtë e baxhave për ndriçimin e hapësirave të nënçative, element, i cili, me kalimin e kohës dhe si rezultat i rikonstruksioneve të mundshme bërë çative, është eliminuar pothuaj plotësisht (shih Fig. 5). Hapësira e nën çative përdorej kryesisht për magazinimin e mallrave, mbasi pjerrësia relativisht e ulët e çative, që nuk i kalonte përgjithësisht 25 gradë, nuk jepte mundësinë e krijimit të mjediseve të banimit.

Nga vrojtimi i kujdesshëm bërë dokumentacionit fotografik të periudhës së viteve të para të transformimeve që pësoi kjo rrugë (shih Fig. 4, 5), vërejmë ndryshime esenciale në infrastrukturën e



Fig. 8. Pamje e shkarkuesit të ullukëve



Fig. 9. Pamje e trasesë së rrugës "Kol Idromeno", dikur "Fushë Celë"

rrugës gjatë zhvillimit të saj. Traseja e rrugës trajtohej me kalldrëm me gurë e dhé të ngjeshur me tokmak, për të krijuar fortësinë e shtresës së rrugës me një pjerrësi të lehtë ndër dy anët e saj. Anës trasesë ndërtoheshin kuneta me fund rrethor, të kornizuara me gurë më të mëdhenj, për të mbledhur ujërat e rrugës nga reshjet e shiut dhe në vazhdim vinte pjesa e kalimtarit, e trajtuar me të njëjtën teknikë si traseja e rrugës. Në rrugë lëviznin përgjithësisht qerret dhe karrocat me kuaj që bartnin mallrat si dhe kaloshinat për transportin e njerëzve. Këtë teknikë të trasesë së rrugës në periudhën në fjalë e takojmë dhe në rrugën me emërtimin e atëhershëm, rruga e "Fushë Çelës", sot rruga "Kol Idromeno", e cila po ashtu pati fazat e saj të zhvillimit (Fig. 9).

Përsa i përket ndriçimit rruga ndriçohej me ndriçues qendror të instaluar në ndërtesat e dy krahëve të rrugës. Kjo strukturë ka ardhur e ruajtur deri në ditët tona, po me teknika dhe flukse të ndryshme të ndriçuesave, në përshtatje me teknikat më të përparuara të kohës. Në krye të rrugicave të shumta si dhe pranë qosheve të ndërtesave, shpesh qëndronin ndriçuesit karakteristikë për atë periudhë, tip braçet, që me dritën e tyre plotësonin sadopak ndriçimin e pakët të rrugicave dhe të rrugës (Fig. 10).



Fig. 10. Pamje të ndriçuesave të rrugës në vite, tipi "braçet"

Fuqizimi ekonomik i qytetit, lindja e shtresës së re të borgjezisë tregtare, prirja për rindërtime në frymën e kohës dhe në përshtatje me mënyrën e re të jetesës, sollën shkëputjen përfundimtare nga varianti i vjetër mesjetar i dyqanit dhe banesës, duke sjellë ndryshime rrënjësore të pamjeve të këtij ansambli[6]. Ky ndryshim duhet parë në dy aspekte: së

[6] Prifti, SH. Restaurimi i rrugës "Enver Hoxha" në zonën muze të qytetit të Shkodrës, *Monumentet,* 1 /1983.

DO NOT COPY

pari në rikonstruksionin e mjaft ndërtimeve ekzistuese me tendencën e një ritrajtimi arkitektonik të pamjeve të tyre të jashtme, ku në rastet më të shumta kemi rritje të vëllimit të objektit nga njëkatësh në dykatësh dhe, së dyti, në ndërtime të reja me kërkesa mjaft të përparuara në aspektin arkitektoniko-estetik për kohën.

Ansambli urbanistiko-arkitektonik i rrugës “Kardinal M. Koliqi” në qytetin e Shkodrës, ndjek skemën klasike të kompleksëve të dy rrugëve, asaj “Kol Idromeno” dhe rrugës “13 Dhjetori”, duke krijuar ndër dy krahët e tij vargje të ndërtesave, me blloqe të ngjeshura ndërtimi dykatësh, si dhe njëkatësh, gjithmonë me ballin kryesor në rrugë. Duke mos qenë rruga e drejtë, por në for`mën e një trajektoreje gjarpëruese me gjërësi që luhatet nga 4 m–6 m deri 8 m, ndërtesat futen më brenda apo dalin më jashtë në trotuar. Kjo lëvizje gjarpëruese e rrugës dhe luhatja e gjerësisë, në mjaft raste krijon trotuare që mezi lejojnë lëvizjen e kalimtarit dhe në të kundërt, krijojnë sheshe të mirëfillta qëndrimi.

Ndërprerja e shumtë e rrugës nga rrugicat tërthore shpesh pa krye, (Fig. 11) muret e larta të gurta të avllive si dhe dyert e gjera prej druri bëjnë që, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme të ansamblit të mos jetë i njëtrajshëm në arkitekturë dhe në vëllim, megjithatë kjo nuk e cënon unitetin kompozicional të këtij ansambli.



Fig. 11. Pamje e një rrugice

Karakteristikat ndërtimore të ansamblit të fillimshekullit XX

Ansambli ndërtimor i rrugës “Kardinal M. Koliqi” shquhet për realizime arkitektonike të arritura. Mjaft e përpunuar është pamja e jashtme e shumë ndërtesave, (Fig. 12, 13) ku të bien në sy veçanërisht zbukurimet





Fig. 12, 13. Pamje e jashtme e dy ndërtesave

në suva. E gjithë plastika me të cilën zbukurohen këto pamje, është realizuar nëpërmjet kombinimit të përpunimit të suvasë, të modelimit të drurit, daltimit

DO NOT COPY

të gurit, përdorimit të tullës me funksion dekorativ, kompozimit të harqeve, si dhe të elegancës së aplikimit të hekurit dekorativ (Fig. 14, 15, 16). Karakteristike për këto ndërtime është ritmi i njëjtë i dritareve për të dy katet, të cilat qarkohen me korniza suvaje të zbukuruara në pjesën e sipërme, me korniza të dala në reliev në forma e profile të ndryshme. Katet ndahen





Fig. 14, 15. Pamje të punimit të hekurit dekorativ



Fig. 16. Pamje të punimit të hekurit dekorativ

gjithmonë me korniza të daltuara dhe friza të dala. Të bien në sy elementet skulpturale të punuara me mjaft mjeshtëri dhe plastikë, të cilat zbukurojnë ndjeshëm muraturën e ndërtesës. Harku është një element karakteristik i kësaj periudhe, i përdorur gjerësisht në mbulimin e hapësirave të dyerve dhe të dritareve, duke dhënë efekte të arrira arkitektonikisht.

Të gjitha dritaret e katit të sipërm janë të pajisura me grila druri, një element ky krejtësisht i ri, të cilin nuk e gjejmë të përdorur në dyqanet e pazarit të vjetër, ndërkohë që dritaret e katit përdhe janë të mbrojtura nga tarabat e drurit, element ky ende i ruajtur nga dyqanet e pazarit të vjetër, po tashmë i përpunuar. Larmia e pamjeve të ndërtesave plotësohet me futjen

DO NOT COPY

e elementit të ri metalik, të cilin e takojmë të realizuar në forma dhe përmasa të ndryshme, në hapësirat dhe harqet e dyerve e dritareve, në parapetet e ballkoneve, ku ai punohet me mjaft zhdërvjellësi dhe teknikë me motive të pasura gjeometrike dhe floreale.

Zgjidhja funksionale e ndërtesave dykatëshe në rrugën "Kardinal M. Koliqi", respekton përgjithësisht skemën tradicionale të këtyre ndërtimeve, ashtu siç i shohim edhe në ndërtesat në dy rrugët: "Kol Idromeno" dhe "13 Dhjetori", ku kati përdhe ka shërbyer si dyqan shitjeje dhe magazinim malli, ndërsa kati i sipërm për banim ose zyra. Por, takohen dhe mjaft raste kur ndërtesat kanë shërbyer tërësisht për banim (shih Fig.13). Rasti i këtyre ndërtesave në rrugën "Kardinal M. Koliqi" e ka shpjegimin se kjo rrugë si funksion parësor ka pasur banimin dhe jo tregtinë, në ndryshim nga dy rrugët e para, të konsideruara si rrugë të mirëfillta tregtare.

Kjo mënyrë ndërtimi, ndonëse solli një aspekt të ri arkitektoniko-dekorativ, nuk u shkëput prerazi nga tradita paraardhëse[7]. Një tregues i qartë i zhvillimit të traditës në këtë arkitekturë të re të sapolindur është konvertimi i mjaft elementeve tradicionale në përshtatje me teknikat e reja. Kështu, fashaturat e drurit që qarkojnë dritaret dhe dyert, vijnë dhe zëvendësohen me fashaturat me teknikën e suvasë, kapakët e drurit të dritareve zëvendësohen me grilat dhe tarabat, zbukurimorja e pasur e brendësisë së odave në banesën tradicionale me çardak, kalon në pamjen e jashtme të dekoruar etj. Materiali i drurit, aq i përdorur në banesën tradicionale, e humbet parësinë e tij në aspektin e strehëve, po çatia vazhdon të ndërtohet me dru e të mbulohet me tjegulla vendi, duke patur një konceptim të ri të strehëve, ku streha e shkurtuar vishet me tavanore.

Krijimet e reja arkitektoniko-dekorative janë edhe si produkt i aktivitetit të figurave të njohura për kohën, si Kolë Idromeno, Pjetër Marubi e ndonjë tjetër, që projektuan me fantazi dhe konceptim bashkëkohor, duke futur mënyrat dhe teknikat e reja të ndërtimit. Pa dyshim, meritë në këto arritje kanë dhe mjeshtrat e talentuar që me eksperiencën e tyre i dhanë jetë dhe shpirt kësaj arkitekture.

Etapat e zhvillimit në kohë të ansamblit.

Rruga "Kardinal M. Koliqi", për vetë planvendosjen dhe shtrirjen e saj urbanistike me një strukturë ndërtesash mjaft të ndryshme si në tipologji, në funksion, në volum dhe në trajtimin arkitektonik të pamjeve të jashtme, solli nevojën e një studimi të kujdesshëm për të nxjerrë në dukje zhvillimin në kohë të këtij ansambli urbanistiko-arkitektonik, duke vërejtur ekzistencën e disa etapave të ndërtimit, të cilat kanë bashkëjetuar në harmoni përgjatë viteve.

Së pari: Si pasojë e shpërnguljes së qytetit të vjetër nga rrëza e kalasë në zonën ku shtrihet sot qyteti, kemi mjaft shembuj ndërtimesh, të cilat hedhin gjurmë mbi bashkekzistencën që kanë pasur për një farë kohe pazari tradicional me qendrën e re të qytetit. Kështu, kemi dyqane (dugaj) përdhese që kanë trashëguar në një masë të konsiderueshme karakteristikat e dyqan-punishteve të pazarit të vjetër, mbuluar me çati dhe strehë të gjera dhe vetrata e taraba druri, që shërbenin për tregtimin e mallit, njëkohësisht dhe për sigurinë e dyqanit (Fig. 17, 18).

Po ashtu, kemi blloqe ndërtesash dykatëshe, ku trajtimi i jashtëm i pamjeve të tyre ka trashëguar elementet e ndërtesave të pazarit tradicional, me strehë të gjera e trarë të latuar druri, me fashatura druri qarkuese të dritareve, me vetrata e taraba druri në katin përdhe (Fig. 19). Kemi ende të ruajtur mirë tipin e ndërtesës me muraturë të plotë guri, të daltuar me qemer e shpatulla guri (Fig. 20). Gjithashtu, të kësaj periudhe janë muret e larta të avllive (Fig. 21),

[7] Prifti, SH. Restaurimi i rrugës "Enver Hoxha" në zonën muze të qytetit të Shkodrës, Monumentet 1/1983.

DO NOT COPY









DO NOT COPY

Fig. 17, 18. Pamje të dyqaneve përdhese

Fig. 19, 20. Pamje të dy ndërtesave të vjetra dykatëshe



Fig. 21. Pamje e një mur guri avllije

që shkojnë deri në 5-6 m lartësi, ndërprerë nga portat e mëdha prej druri dykapakëshe të mbuluara me çati me tjegulla e strehë të gjera (Fig. 22).



Fig. 22. Pamje e një mur guri avllije

Së dyti: Kushtet e reja social-ekonomike dhe kërkesat e reja bashkëkohore të fillimshekullit XX, sollën ndërtimin e tipit të ri të ndërtesës, përgjithësisht asaj dykatëshe dhe rrallë trekatëshe, të cilat ishin përfaqësuese të shtresës së re borgjezo-tregtare, që dispononte dhe mundësitë financiare për ta ndërtuar atë. Këto ndërtesa të konceptuara përgjithësisht dyqane, magazinë në katin përdhe dhe banim apo zyra në katin e sipërm (Fig. 23), si dhe varianti për banim në të dy katet (Fig. 24), duhen konsideruar si projekte të mirëfillta me funksione të qarta që në projektim, me një koncept të qartë bashkëkohor kompozicional, arkitektonik dhe estetik.





Fig. 23, 24. Pamje të dy ndërtesave para ndërhyrjes restauruese

DO NOT COPY

Së treti: Zhvillimi i qendrës së re të qytetit në përshtatje me kushtet e reja social-ekonomike, sollën kërkesën për shumë pronarë me fuqi ekonomike që të modifikonin ndërtesat e tyre ekzistuese në përshtatje me tipin e ri. Këto ndërtesa, të cilat me veçoritë e tyre të trashëguara nga qendra e vjetër, si lartësia e ulët e kateve, strehët e gjera prej druri, hapësirat e vogla të dritareve dhe të dyerve iu nënshtruan procesit të modifikimit, i cili preku kryesisht pamjet e jashtme dhe elementet përbërëse të saj. Të bie në sy varfëria estetike e përpunimit të suvasë, me trajtimin e fashaturave dhe kornizave të ndërkatit, përpjekja për të zmadhuar hapësirat e katit përdhe, ndërkohë që kemi vendosjen e elementit të ri, të grilave të drurit në dritaret e katit të sipërm (shih. Fig. 23).

Së katërti: Gjatë zhvillimit në kohë të ansamblit, kemi mjaft ndërtesa, të cilat për arsye nga më të ndryshmet nuk kanë patur mundësi të rriten dhe me katin e sipërm, duke mbetur vetëm në volumin e katit përdhe, konsideruar kjo si fazë ndërmjetëse. Kjo dokumentohet qartësisht në ndërtesën e (Fig. 25), ku volumi njëkatësh, i konsideruar si pjesë e një ndërtimi të plotë, trajtohet me të njëjtën arkitekturë si ndërtesa dykatëshe bashkëngjitur me çati kallkan, si një dëshmi e vazhdimësisë së ndërtimit. Ky rast, njëherazi, është një nga më të realizuarit arkitektonikisht dhe estetikisht në ansamblin e rrugës "Kardinal M. Koliqi". Po ashtu, kemi dhe raste të tjera ku muret kallkan, kornizat e ndërkateve, hapësirat e mëdha të vetratave etj., lënë gjurmë mbi mosvazhdimin e ndërtimeve. Për pasojë, këto mangësi ndërtimore në zhvillimin urbanistiko-arkitektonik të rrugës, kanë sjellë uljen e vlerave tradicionale, si dhe cenimin e unitetit stilistik të ansamblit.

Së pesti: Vërejmë se, në vitet 30-40 të shekullit XX, bie ndjeshëm dëshira e trajtimit dekorativ të pamjeve të jashtme të ndërtesave, duke e thjeshtësuar trajtimin dekorativ të pamjeve të jashtme, ku nuk kemi përdorimin e fashaturave qarkore të dritareve, të



Fig. 25. Pamje e pjesshme e rrugës, ndërtesë një e dykatëshe

kornizave të dekoruara të ndërkatit apo të elementeve dekorative në stukoreliev (Fig. 26). Hapësirat e vetratave të katit të poshtëm janë mjaft të gjera dhe të drejta, duke iu larguar tashmë elementit të harkut, karakteristik i periudhës së fundshekullit XIX dhe fillimshekullit XX. Po ashtu, dritaret trajtohen më të gjera, me tre kanata, duke iu larguar skemës klasike dykanatëshe, ku shpesh mungojnë grilat e drurit. Parapeteve të ballkoneve iu mungon transparenca e punimeve të hekurit dekorativ apo të elementeve dekorativ në stuko reliev. Ato trajtohen mjaft thjesht në formë të blloqeve të plota mur tulle. Gjithë pamja e ndërtesës dallon për një varfëri të trajtimit arkitektoniko-estetik të elementeve përbërëse.

DO NOT COPY



Fig. 26. Pamje e një ndërtese dykatëshe me ballkone



Fig. 28. Pamje e një ndërtese të përshtatur

Së gjashti: Gjatë gjithë zhvillimit kohor të ansamblit, kemi mjaft ndërtime të ndërtuara pa kriter dhe vlera, si në aspektin arkitektoniko-volumor ashtu dhe atë teknik, të cilët me pamjen dhe volumin e tyre dëmtojnë rëndë vlerat e ansamblit. Këto ndërhyrje pa leje në trupin e ndërtesës si: shtesa (Fig. 27), përshtatje (Fig.28), apo dhe ndërtime të reja në hapësirat e trojeve të rrugës “Kardinal M. Koliqi” (Fig. 29), janë ndërhyrje jashtë kritereve të rregullores përkatëse të Qendrës Historike, duke dëmtuar rëndë pamjen e ansamblit.



Fig. 27. Pamje e një varg dyqanesh përdhese



Fig. 29. Pamje e një ndërtese trekatëshe me ballkone

DO NOT COPY

Gjendja teknike e ansamblit

Në përgjithësi, gjendja teknike e këtij ansambli paraqitej jo e mirë. Pjesa e dëmtuar që kërkonte një trajtim thuajse tërësor ishte ajo e veshjes së jashtme me teknikën e suvasë. Ansambli kishte pësuar dhe transformime, të cilat i takojmë kryesisht në katet e poshtme tek elementet e drurit, si dritare, dyer, vitrina e taraba, të cilët me kohë, duke qenë ndërtuar me material jo të qëndrueshëm, janë amortizuar dhe zëvendësuar me materiale të tjera, si dhe trajtuar me forma e madhësi të ndryshme, duke tjetërsuar pamjen dhe elementet origjinale. Pasojë e transformimeve në vite dhe dobësimit teknik të ndërtimeve janë hapjet, mbylljet apo ndryshimet e shumta bërë hapësirave të dritareve, dyerve etj., pasojë e ndryshimit funksional të banesës, shtimit të familjes apo shkaqeve të tjera sociale (Fig. 30).



Fig. 30. Pamje e një shtese njëkatëshe në kryqëzi

Transformimet më të mëdha dhe serioze i përkasin grupit të parë të ndërtimeve, të cilët, për shkak të vjetërsisë së tyre kohore, ku elementi kryesor konstruktiv është druri, paraqiten mjaft të degraduara në gjithë përbërësit e tyre si dhe në çatitë me konstruksion druri dhe mbulesën me tjegulla vendi. Ndërtimet e grupit të pestë, për shkak të përdorimit të teknikave pa kriter, materialeve të dobëta konstruktivë dhe trajtimeve pa vlera të pamjeve të jashtme, paraqiten mjaft të dobësuara. Gjithashtu, kemi dhe banesa që janë braktisur në vite nga pronarët, me një amortizim të plotë, ardhur në ditët tona në formë rrënoje (Fig. 31).



Fig. 31. Pamje e një ndërtese përdhese në formë rrënoje.

Krahas rasteve të trajtuara më sipër, kemi dhe fenomenin e dëmtimit të plotë të ndërtesës ekzistuese, ku tashmë kemi një shesh të lirë, i cili me boshllëkun e krijuar dëmton rëndë unitetin urbanistiko-arkitektonik të ansamblit (shih Fig. 30).

Gjithë parashtrimet që u evidentuam më sipër, si dhe gjendja teknike e dobët e ansamblit, kërkonin domosdoshmërinë e ndërhyrjes restauruese. Karakteri i ndërtesave me materiale në përgjithësi të brishta, rindërtimet e shpeshta në përbërësit kompozicionalë, arkitektonik e teknikë, qenë faktorët që nuk mund të mos ndikonin në shkallën dhe mënyrën e ndërhyrjeve restauruese.

DO NOT COPY

Problematikat e ndërhyrjes restauruese

Duke pasur parasysh faktin se ansambli kishte kaluar në shumë etapa gjatë gjithë zhvillimit kohor të tij për të ardhur deri në ditët tona, projekti i restaurimit shtronte një sërë problemesh që kërkonin zgjidhje kompetente dhe profesionale.

Projekti kishte për qëllim rivlerësimin e vlerave historike, urbanistiko-arkitektonike të humbura në vite[8].

Konkretisht, problemet ishin këto:

- Si do veprohej me disa ndërtime, që në fazën fillestare të tyre trashëgonin karakteristikat e ndërtimeve të periudhës së Qendrës së Vjetër dhe sot paraqiteshin me transformime të dukshme në planin e jashtëm arkitektonik;
- A do ndërhyhej për plotësimin e vlerave të zbukurimores së pamjeve të jashtme apo të ndonjë elementi karakteristik te ato ndërtesa, që e patën zanafillën e tyre nga qendra e vjetër dhe tentuan të modifikonin pamjet e tyre ekzistuese në përshtatje me tipin e ri;
- Si do veprohej me ndërhyrjet pa ndonjë kriter të caktuar, por të udhëhequr thjesht nga synime utilitare, që kishin tjetërsuar pamjet e jashtme me hapje e përshtatje të reja, duke dëmtuar unitetin dhe harmoninë e ndërtesave në veçanti apo të ansamblit në përgjithësi;
- Çfarë qëndrimi do mbahej për ndërtimet, të cilat për arsye të ndryshme kishin mbetur pa përfunduar, për ndërtesat që paraqiteshin në formë rrënoje, apo për trojet bosh, që dëmtonin unitetin e ansamblit;
- Si duheshin trajtuar disa pamje ndërtesash si shtesa, përshtatje etj., të cilat ishin ndërtuar pa kriter në mosrespektim të kritereve të rregullores përkatëse dhe elementeve karakteristik të rrugës.

Problematika të tilla që shtroheshin para ndërhyrjes restauruese të ansamblit të rrugës "Kardinal Mikel Koliqi" janë evidentuar dhe trajtuar dhe në rastin e restaurimit të pjesshëm të pamjeve të jashtme të ansamblit të rrugës "Kol Idromeno", pjesë përbërëse e Qendrës Historike të qytetit të Shkodrës, me ndërhyrjet në vitin 1983, me rastin e zhvillimit në këtë rrugë të aktivitetit të "Ekspozitës Kombëtare të Kulturës Popullore" (rruga atëhere kishte emërtimin "Enver Hoxha")[9], si dhe ndërhyrja e plotë restauruese ajo në vitin 2008. Në ndryshim me strukturën dhe kompozimin volumoro-arkitektonik unik të ndërtesave të ansamblit të rrugës "Kol Idromeno", të cilat përfaqësojnë tipin e ri të ndërtesave me tipologji dhe arkitekturë të mirëformuar të ndërtesave të fillimshek. XX, ansambli i rrugës "Kardinal Mikel Koliqi" paraqitet jo kompakt në strukturë dhe mjaft i larmishëm në trajtimin volumoro-arkitektonik të ndërtesave.

Restaurimi i ansamblit të rrugës "Kardinal Mikel Koliqi"

Hartimi i projektit të restaurimit u shoqërua nga një studim i hollësishëm që iu bë evolucionit të karakterit ndërtimor në kohë të këtij ansambli, për të përcaktuar drejt në parim kriteret e ndërhyrjes së restaurimit. Për këtë u bë një punë e studiuar, me hartimin me përpikmëri të dokumentacionit grafik, atij përshkrimor e fotografik, duke u mbështetur fuqimisht te dokumentacioni i pasur fotografik i fototekës Marubi; po ashtu u bë grumbullimi i të dhënave gojore dhe veçanërisht u ndal te gjurmët origjinale të dala gjatë vrojtimit të kujdesshëm bërë ndërtesave. Ndihmesë të plotë që hodhi dritë dhe saktësoi në mjaft raste projektin e restaurimit ishin gjurmët e detajeve të ndryshme apo dhe të vetë elementeve të pamjeve

[8] Materiali grafik është hartuar nga restauratorët-skicograf Sotiraq Terezi, Agim Qyshka, Bashkim Penxha

[9] Prifti, SH. Restaurimi i rrugës "Enver Hoxha" në zonën muze të qytetit të Shkodrës, Monumentet 1 /1983.

DO NOT COPY

të jashtme të dala gjatë punimeve të zbatimit, të cilat ishin murosur në vite. Këto detaje dhe elemente u pasqyruan grafikisht[10] me qëllimin e rindërtimit me ekzaktësi të tyre si vlerë e një arkitekture dhe teknike zbatimi në zhdukje e sipër, duke kontribuar në pasurimin e projektin të restaurimit.

Vëmendja kryesore iu kushtua ndërtimeve, të cilat me kompozimin dhe formulimin e trashëguar, ruanin ende elemente si të Qendrës së Vjetër, Pazarit rrëzë Kalasë. Kështu, në dyqanet përdhese të ashtuquajtura "dugaj", dhe te ndërtesat dykatëshe, mbi bazën e gjurmëve origjinale, si dhe në analogji me tipologjinë e ndërtimeve të vjetra, u arrit te gjendja fillestare. U rivendos tipi i vjetër i hapësirës së vetratës në katin përdhe, që e takojmë dendur në Pazarin e Vjetër, i cili ka shërbyer njëherazi si për ekspozimin e mallit ashtu dhe shitjen e tij. Kjo hapësirë, që shkon 1.5x2.0 m, rrethohet me fashatura dërrase, ku në pjesën e poshtme e të sipërme sajohen kanale të thelluara dërrase, ku futen tarabat për të siguruar dyqanin. Tarabat janë dërrasa të thjeshta të afruara që sigurohen në fund me një lloz metalik. Kur hapet dyqani ato hiqen me kujdes dhe palosen njeri përmbi tjetrin duke shërbyer dhe si podium për ekspozimin e mallit. Dera trajtohet thjesht me dërrasa të afruara, ka dhe raste kur zbukurohet me fashatura dërrase me figura gjeometrike, si rombe dhe mbërthehet me gozhda kovaçi. Ka raste kur dhe dera sigurohet me taraba futur në kanale të thelluara dërrase në pjesën e xhamit.

Karakteristikë për këto tipe ball dyqanesh të zhvilluara në Pazarin e Vjetër, ardhur deri në ditët tona, është tipari i mbrojtjes që ato kanë siguruar për lokalet e tyre me përdorimin e tarabave. Ndërtimi i tyre i plotë me material druri si dhe krijimi i hapësirave sa më të plota e të lirshme për ekspozimin e mallit përbën një tipar me rëndësi për atë periudhë duke qenë aktual dhe për ditët e sotme. Këto tipe dyqan-punishte të qendrës tradicionale, janë elemente në zhdukje e sipër për qytetet, kështu që ruajtja dhe rindërtimi i tyre kanë një vlerë të veçantë për historinë e artit tonë të të ndërtuarit.

Po ashtu takohet rasti i restaurimit të tipit të vjetër të ndërtesës, (Fig. 32) me muraturë të plotë guri, qemer e shpatulla guri të daltuar si dhe strehë të gjerë druri, e rrallë në tipologjinë e saj, e cila kishte pësuar transformime në elementët e pamjes së saj të jashtme.



Fig. 32. Ndërtesë e restauruar dykatëshe me strehe e çati druri, gjatë rrugës

Siç del dhe nga dokumentacioni fotografik i fazës fillestare të këtij objekti, (shih Fig. 5), streha e çatisë ka qenë shumë pak e dalë nga muratura e ndërtesës dhe trajtohej si strehë e mbyllur me tavanore dërrase. Në një fazë të mëvonshme ajo është zgjatur dhe trajtuar me trarë të gdhendur e brez të dhëmbëzuar druri, një teknikë kjo mjaft e vjetër në zhdukje e sipër, e përdorur në variantet e banesave me çardak apo në çatitë e portave të avllive. Për restaurimin e tyre u vendos të ruhet dhe të restaurohet varianti i dytë, ai i gjendjes ekzistuese, për të hedhur dritë mbi tipologjinë e strehëve dhe çative. Në këtë rast, çatia

[10] Materiali grafik është hartuar nga restauratori–skicograf Bashkim Penxha.

DO NOT COPY

iu nënshtrua restaurimit të plotë të strehës me lëndë druri të latuar, ku pjesët e amortizuara u zëvendësuan me lëndë të shëndoshë, duke respektuar teknikat origjinale të gdhendjes. Për elementet e veçanta arkitertonike, si vetratoja në formë harku, restaurimi respektoi detajin origjinal të xhamllëkut, ndërsa taraba mbrojtëse u rivendos në konsolat ekzistuese metalike të fiksuara me plumb në shpatullat e gurit. Dyert, të cilat ishin modifikuar me qepena metalike, u trajtuan me teknikën gjysëm xham, ku pjesa e xhamit u sigurua me taraba druri, ndërkohë që dritaret u çliruan nga grilat plastike dhe u ritrajtuan me rrjetën mbrojtëse të zgarës së hekurit.

Një ndër elementet përbërëse të ansamblit, i cili kishte pësuar mjaft ndryshime në kohë, ishin portat e mëdha prej druri të hyrjeve në ndërtesat e ndodhura në brendësi të rrugës, vendosur pranë mureve të avllive, të cilat, për arsye të materialit jorezistent ndaj kushteve atmosferike, daljes së materialeve të reja dhe shkaqeve të ndryshme si hapje të reja etj., ishin transformuar në teknikë, formë dhe përmasa, duke dëmtuar rëndë unitetin stilistik të ansamblit. Kështu, u procedua me zëvendësimin e këtyre portave dhe çative të ndërtuara me materiale, si llamarinë, mbulesë me eternit ose soletë betonarme me dyer karakteristike druri të periudhave përkatëse, si ato me fashatura mbërthyer me gozhda kovaçi apo të trajtuara me fashatuara të dekoruara, mbuluar me çati druri e tjegulla vendi. Rëndësi iu vu dhe restaurimit të çative dhe strehëve të gjera si një element karakteristik i periudhave përkatëse gjithnjë në zhdukje e sipër (Fig. 33)

Për grupin e ndërtimeve me veçoritë e tyre të trashëguara nga qendra e vjetër, si lartësia e ulët e kateve, strehët tavanore prej druri, hapësirat e vogla të dyerve e të dritareve të mbrojtura me grila të thjeshta druri, si dhe shpesh varfëria estetike e zbukurimores së pamjeve të jashtme, të cilat tentuan t’i përshtaten tipit të ri, u tregua shumë kujdes në ruajtjen e elementeve origjinale. Kështu, në rastin e një ndërtese,



Fig. 33. Restaurimi i një porte druri me çati me gdhendje

u ruajtën dhe u restauruan elementet origjinale të pamjes së jashtme (Fig. 34). Ky veprim, konsideruar si dëshmi e një faze ndërmjetëse, me përpjekjen për t’iu përshtatur tipit të ri që sapo kishte filluar të formësohej në qendrën e re të qytetit, hedh dritë mbi zhvillimin në kohë të këtij ansambli ndërtimor.



Fig. 34. Detaje të vjetra të pjesëve të dritareve të ndërtesës

DO NOT COPY

Por, kemi dhe raste kur ndërtesa, megjithë tipologjinë e trashëguar nga qendra e vjetër, ka arritur t'i përshtatet më së miri zbukurimores së tipit të ri me realizime shumë të arritura. Kështu, te një ndërtesë e ulët, mbas zhveshjes së kujdesshme të suvasë së katit përdhe, ku elementet si dyer dhe dritare ishin murosur në kohë, u evidentua qartësisht funksioni i tyre. Mbi bazën e gjurmëve të pakta origjinale të ruajtura, mbasi lënda e drurit ishte amortizuar në kohë, u rindërtua tipi i vjetër i këtyre elementeve arkitektonike. Dritaret dhe dyert me hapje dykapakëshe, ku pjesa fundore e telajos së xhamit trajtohet fikse, u pajisën me tarabatë mbrojtëse. U respektua trajtimi i pamjes së jashtme me fashaturat qarkore të dritareve, streha, si dhe teknika e realizimit të grilave. Në tërësinë e trajtimit arkitektoniko-zbukurimor të pamjes së saj të jashtme, ndërtesa dallohet për aplikimin e një detaji të veçantë dhe unik mbi dritaret e katit të sipërm, si në vendosjen e tij kompozicionale ashtu dhe në trajtimin estetik (Fig. 35).



Fig. 35. Pamje te restauruar të dyerve e vetratës

Ngjitur me këtë ndërtesë të ulët, kemi rastin e restaurimit të plotë të ndërtesës dykatëshe (Fig. 36). Ndërtesa, duke qenë e braktisur dhe njëherazi e mbyllur në katin e poshtëm me rolé metalike, kishte



Fig. 36. Ndërtesë dykatëshe ku është vendosur tipi i vetratës.

të pamundur të evidentonte elementët vetrato-dyer, të cilat, mbas hapjes së objektit, rezultuan mjaft të ruajtura, me një teknikë dhe formë të veçantë në llojin e tyre. Këto elemente, vetrato-dritare si dhe dyer, u riprodhuan ekzaktësisht sipas elementeve origjinale. Në formatin dhe teknikën e tyre të bie në sy trajtimi i veçantë i sipërdritës prej druri si dhe kompozimi i hapësirës vetrato-dritare. E veçanta në këtë ndërtesë është përdorimi i roleve mbrojtëse metalikë, detaj që nuk e gjejmë në asnjë ndërtesë të ansamblit, ndërkohë që dyert janë të mbrojtura me taraba druri. Kemi bashkekzistencën në të njëjtën kohë të elementeve tradicionale dhe përdorimin e teknikave të reja bashkëkohore, vlerësuar kjo si një përpjekje e shtresës së sapoformuar borgjezo-tregtare, për t'iu përshtatur gjithnjë e më tepër kushteve të reja social-kulturore, të cilat i përqafoi me mjaft përparësi.

Një restaurimi të plotë iu nënshtrua kati përdhe i bllokut të tre ndërtesave në hyrje të rrugës "Kardinal Mikel Koliqi", ku gjatë punimeve, me zhveshjen e kujdesshme të suvasë dolën gjurmët e qemereve, të hapësirave të dritareve dhe të dyerve origjinale (Fig.29). Me kohë ato ishim mbyllur ose trajtuar krejtësisht

DO NOT COPY

ndryshe, duke transformuar pamjet e ndërtesave. Këto gjurmë të qemerëve si dhe përmasat e dritareve dhe dyerve, të ndryshëm për të tre ndërtesat e vendosura në bllok, si nga ndryshimi i formës, përmasave dhe teknikës së realizimit të tyre, u rilevuan me kujdes dhe u restauruan në respekt të gjurmëve origjinale, duke përftuar mbas restaurimit një pamje krejtësisht të re të këtij blloku ndërtesash, me vlera në aspektin arkitektoniko-tipologjik (Fig. 37).



Fig. 37. Pamje e një blloku ndërtesash dykatëshe me grila druri.

Padyshim, vendin kryesor në restaurimin e ansamblit e zënë ndërtesat dykatëshe të tipit të ri, si përfaqësuese të shtresës së re borgjezo-tregtare, e cila, krahas aktivitetit të zgjeruar tregtar kërkonte tashmë një banesë me një koncept të ri bashkëkohor, që t’i përshtatej kërkesave të saj gjithnjë e në rritje. Këto ndërtesa, përgjithësisht të ruajtura mirë në përbërësit e tyre kompozicionalo-arkitektonik të pamjeve të jashtme, iu nënshtruan restaurimit të elementeve arkitektonike me qëllimin e rikthimit të vlerave të dëmtuara apo të humbura në kohë.

Kështu, kemi rastin e restaurimit të plotë të dy ndërtesave me vlera të spikatura arkitektoniko-dekorative, ku ndërtesa e parë (Fig. 38) ka shërbyer



Fig. 38. Dy ndërtesa dykatëshe të restauruara me dekoracione

për tregti, dyqane apo magazinë në katin përdhe dhe banim në katin e sipërm, ndërsa ndërtesa e dytë (Fig.39) ka shërbyer për banim në të dy katet. Ndërtesat i kanë të ruajtura plotësisht elementet arkitektonike të pamjeve të jashtme, si dyer, dritare, grila e taraba, duke iu nënshtruar restaurimit të pjesshëm të tyre. Restaurim të plotë pësuan grilat e të dy ndërtesave për arsye të amortizimit. Teknika e realizimit të grilave të ndërtesës së dytë me rolé dërrase, rezultat i bashkimit të rrypave të drurit me pjastra çeliku, është një teknikë mjaft e përparuar për kohën, të cilën e gjejmë dhe të ndërtesa e Kafes së Madhe. Të bie në sy dekoracioni i mbingarkuar në stukoreliev i suvasë të ndërtesave, i parapetit të ballkonit si dhe trajtimi i vetratës së ballkonit, elemente këto të importuar nga Italia dhe të përshtatura nga arkitektët vendas sipas koncepteve dhe trajtimeve lokale (Fig. 40).

Përgjithësisht, strukturat e mureve të ndërtesave ishin mur tulle që shkonin 30-40 cm për të dy katet dhe ishin në gjendje të mirë, po nuk përjashtohen rrallëherë dhe muret me gur lumi, struktura e të cilëve ishte më e prirur për t’u amortizuar. Në rastet e dëmtimeve, kryesisht ato për efekt të lagështirës, si dhe në të gjitha rastet e tjera, u bë zhveshja e kujdesshme e suvasë, e cila shërbeu njëherazi dhe për shfaqjen e mundshme

DOKTORATURË



Fig. 40. Pamje një balkoni të restauruar me vetrata druri e dekoracione

të ndonjë gjurme të murosur, sipërfaqja e murit u la me ujë të bollshëm dhe përfundimisht u krye procesi i suvatimit, sipas teknikave origjinale. Në vendet e padëmtuara, sipërfaqet e muraturave u kruajtën me kujdes për t'i paraprirë bojatisjes. Kështu, vëmendje e veçantë iu kushtua sipërfaqeve të suvasë dekorative dhe elementeve arkitektonikë përbërës të saj, si: fashaturat prej suvaje të dritareve e dyerve, kornizat dekorative të strehës, kornizat e ndërkatit, kapitelet e pragjet e dritareve, si dhe dekoracionet në stuko-reliev, të cilët iu nënshtruan një procesi të kujdesshëm pune, që konsistonte në pastrimin, kruajtjen dhe evidentimin sa më të plotë të tyre.

Restaurimi i këtyre detajeve arkitektonike të zbukurimores së ndërtesave, respektoi teknikat, modelet dhe materialet origjinale, duke punuar në rastet e duhura me teknikën e kallëpeve të nxjerrë për çdo detaj që iu nënshtrua restaurimit. Për të përcaktuar ngjyrën origjinale të bojatisjes së ndërtesës, me qëllimin e kthimit të ansamblit sa më pranë periudhës kohore të ndërtimit të tij, suvaja e çdo ndërtese iu nënshtrua stratigrafisë të shtresave të bojatisjes të vëna në vite, ku dhe u fiksua ngjyra e kohës së ndërtimit.

Të gjitha çatitë e ndërtesave u hapën në pjesën e strehës për të realizuar restaurimin e strehëve sipas detajeve dhe teknikave origjinale paraqitur në projekt, si tavan dërrase apo tavan suvaje me mbulesë me tjegulla vendi. Strehët u pajisën me ullukë llamarine zingato, duke respektuar teknikën origjinale të tyre, ku ullukët horizontalë u prodhuan me zhvillim 33 cm të kapur me grafeta, ndërsa ullukët vertikalë me diametër 100 mm u pajisën me shkarkuesit karakteristikë, të cilët i gjejmë të stilizuar në forma nga më të ndryshmet (shih fig. 6). Për rastin e ndërtesës dykatëshe, nga vrojtimi i kujdesshëm bërë dokumentacionit të vjetër fotografik, u zbulua forma origjinale e shkarkuesit në formë koke kuçedre. Nga gjurmimet e bëra në qytet, në zonat ende të ruajtura, ky detaj u gjet i paprekur në formë origjinale në një banesë dhe shërbeu si model për prodhimin e elementit të shkarkuesit (Fig. 41). Ndërhyrje iu bë dhe oxhakëve të dalë në çati, të cilët trajtoheshin në forma dhe teknika të ndryshme, shpesh me dalje pa kriter, duke dëmtuar tërësisht pamjen e çatisë. Oxhakët që ruanin formën origjinale u restauruan, ndërsa oxhakët me dalje pa kriter iu përshtatën tipologjive të kohës. Oxhakët u pajisën me këllëfin izolues të llamarinës në ato vende ku mungonte ose ishte i dëmtuar.

Një ndër elementet kryesore ndërtimore në ndërtesat e ansamblit të rrugës "Kardinal Mikel Koliqi" dhe përgjithësisht në ansamblet e Qendrës Historike që i përket periudhës kohore së fundshek. XIX dhe fillimshek. XX, është materiali i drurit, i cili gjen një përdorim dhe aplikim në masë. Të gjithë elementet arkitektonike të pamjeve të ndërtesave, si dyert, dritaret, tarabatë, grilat, vetratat janë realizuar me teknika, forma e përmasa të ndryshme, në përshtatje me kompozimin arkitektonik të ndërtesave. Po ashtu, përdorim të drurit kemi dhe në strehët e portave të avllive, si pjesë organike e ansamblit të rrugës.

DO NOT COPY



Fig. 41. Ballkon i restauruar me parapet hekuri dekorativ

Restaurimi i këtyre elementeve arkitektonike u krye me mjaft kujdes, duke vlerësuar qëndrueshmërinë që ato duhej të siguronin në vite. Rëndësi e veçantë iu vu fillimisht restaurimit të elementeve origjinale, si provë autentike e kohës, të cilët, me origjinalitetin e tyre, do të shërbenin për t’u riprodhuar në vite. Elementet e drurit të amortizuara plotësisht apo të zëvendësuara jashtë kritereve, u riprodhuan sipas teknikave e përmasave origjinale, me shumëllojshmërinë e thikave dhe llojshmërinë e dekoracionit. Si material drurësor u përdor lëndë e stazhionuar pishe, lisi apo bredhi të cilësisë së parë, pa nyje.

Pjesë përbërëse e elementeve të arkitekturës së jashtme të ndërtesave është dhe materiali i hekurit dekorativ, të cilin e gjejmë të vendosur sipas rasteve, në timpanet e harqet të dyerve dhe të vetratave, në parapetet e ballkoneve, në hapësirat e dritareve apo portikët e portave. Ky element arkitektonik me realizime mjaft të arritura, përgjithësisht është ruajtur dhe paraqitej në gjendje të mirë, por nuk përjashtoheshin dhe rastet kur ai ishte dëmtuar pjesërisht, hequr, apo zëvendësuar me një prodhim apo material të ri jashtë kritereve. Ndërhyrja kryesore iu bë elementeve ekzistuese origjinale, të cilat iu nënshtruan procesit të restaurimit, duke u pastruar tërësisht me furçë hekuri apo zumpare speciale, për të hequr shtresat e bojës të vendosura në kohë. Hekuri fillimisht u lye me bojë kundër ndryshkut dhe pastaj me bojë vaji apo zmalto në përshtatje me ngjyrën që kishte ndërtesa në projekt. Për pjesët munguese brenda vetë elementit, u bë riprodhimi i tyre sipas kallëpeve të nxjerra, duke respektuar materialin, përmasat, teknikën e punimit dhe shkallën e dekoracionit të elementit origjinal. Ndërsa për pjesët që ishin zëvendësuar me një prodhim apo material të ri jashtë kritereve, u përdor kriteri i analogjisë në përshtatje me arkitekturën e ndërtesës.

Padyshim, veshja përfundimtare e ndërtesave të ansamblit, procesi i ngjyrosjes, kërkonte një kujdes të veçantë në arritjen e përceptimit kohor të ansamblit, por njëherazi në arritjen estetikisht të kultivuar të tij. Si rezultat i sondazheve të bëra gjatë punimeve të restaurimit të pamjeve të jashtme të ndërtesave me heqjen e kujdesshme të shtresave të bojatisjeve të bëra në vite, u arrit përcaktimi i bojës origjinale. Përsa i përket lyerjes së fashaturave rreth e qark dritareve, dyerve e vetratave, kornizave të ndërkatit dhe të strehëve apo përgjithësisht dekoracioneve në suva,

DO NOT COPY

u përdor lyerja tradicionale me bojë të bardhë, por, nuk përjashtohen dhe rastet e kompozimit të ngjyrave brenda kriterit të kohës kur ato u ndërtuan. Ngjyrat më të përdorshme të periudhës së fundshekullit XIX në dyqanet e trashëguara nga Pazari i Vjetër, veçanërishët në ato përdhese me përdorimin e fashaturave prej dërrase, muratura trajtohet me gëlqere të bardhë, ndërsa në ndërtesat dykatëshe kemi përdorimin e ngjyrave me tonacione të lehta si okër, bezhë, ndërkohë që për ndërtesat e fillimshekullit XX e veçanërisht ato të ornamentuarat, vërejmë dhe përdorimin e ngjyrave të forta si blu, vishnjë, jeshile e ftohtë etj.

Qëndrimi ndaj ndërtimeve pa kriter dhe hapësirave boshe.

Në hapësirën kohore që nga fundshekulli XIX deri në ditët tona, ansambli i rrugës "Kardinal M. Koliqi" ka pësuar dhe fenomenin e dëmtimeve të plota të ndërtesave, që për vetë vjetërsinë e tyre i përkisnin kryesisht ndërtimeve të trashëguara nga qendra e vjetër e qytetit, si dhe ndërhyrje, shtesa ndërtimesh pa kriter dhe pa vlera në aspektin e tipologjisë tradicionale. Këto boshllëqe dhe shtesat pa vlerë, si brenda kompaktësisë së ndërtimeve të ansamblit, të ndodhura buzë rrugës, në kryqëzim të rrugicave apo në fundin e vetë ansamblit, e dëmtonin rëndë unitetin urbanistiko-arkitektonik dhe panoramik të tij.

Ndërhyrjet me qëllimin e plotësimit të këtyre boshllëqeve janë bazuar në disa kritere.

Së pari, trualli i objektit iu nënshtrua sondazheve të kujdesshme për të gjetur gjurmët e mundshme që mund të hidhnin dritë sado pak mbi natyrën e ndërtimit. Së dyti, iu referua dokumentacionit të mundshëm fotografik, veçanërisht atij të pasur të fototekës Marubi dhe, së fundmi, në mungesë të këtyre dëshmive origjinale, u përdor metoda e analogjisë në përshtatje me volumin, teknikën dhe trajtimin e jashtëm arkitektonik të ndërtimeve përreth.

Qëndrimin e mbajtur ndaj ndërtimeve pa kriter, si në aspektin arkitektoniko-volumor ashtu dhe atë teknik, e shohin p.sh. në shtesën njëkatëshe bërë në vite (shih Fig. 30), e cila me pamjen dhe volumin e saj kishte dëmtuar vlerat e ansamblit.

Duke qenë se kjo shtesë ishte e vendosur buzë një kryqëzimi, në krah të një ndërtese dykatëshe, me të njëjtin hap ndërtimi me të, u pa e arsyeshme trajtimi i saj arkitektoniko-volumor i njëjtë me ndërtesën në krah, duke përftuar tashmë një ndërtesë të vetme me vlera dhe në aspektin urbanistiko panoramik të ansamblit (Fig. 42).

Te një bllok ndërtimi njëkatësh (Fig. 36), nga vrojtimi i kujdesshëm dhe gjurmët e zbuluara, rezultoi se hapësirat e vetratave kishin pësuar transformime. Nga sondazhet e bëra doli se në dy hapësirat e para ruhej mjaft mirë elementi origjinal i vetratave prej druri, ku njëra hapësirë shërbente si vetrate-hyrje dhe tjetra si vitrinë. Fakte të shumta si: përmasat relativisht të mëdha të këtyre hapësirave, si dhe formati i veçantë i kompozimit të vetratave, mjaft i përparuar për kohën, të cilat nuk i gjejmë të trajtuar gjetiu, formulimi dhe trajtimi arkitektonik i kornizës së suvasë si parapet mbi soletën e katit, hedhin dritë mbi faktin se kemi të bëjmë me projektimin e një ndërtese dykatëshe të tipit të ri, por që mbeti i parealizuar në vite. Kështu, projekti i këtij blloku njëkatësh u plotësua me katin e sipërm sipas kritereve të ndërtimit të ndërtesave të tipit të ri, duke e ruajtur kornizën e suvasë, si pjesë organike e trajtimit arkitektonik të katit të sipërm; në të gjitha hapësirat e katit përdhe u vendos formati i veçantë vetrato-hyrje, i cili u riprodhua sipas elementit origjinal (Fig. 43).

Takohen dhe disa ndërhyrje ndërtimore me qëllimin e plotësimit të vlerave arkitektoniko-volumore si dhe unitetit panoramik të tij. Te fragmenti i parë i projektit, (Fig. 32), është rasti kur ndërtimi, për arsye të ndryshme ka mbetur pa e përfunduar katin e sipërm dhe kjo shihet mjaft qartë te trajtimi i njëjtë arkitektonik

DO NOT COPY



Fig. 43. Pjesë e një vetratoje të restauruar

i elementeve të pamjes së jashtme të katit përdhe me ato të katit përdhe të ndërtesës ekzistuese dykatëshe të ndodhur në krah. Kështu, projekti i ndërtimit të katit të sipërm të ndërtesës në fjalë respektoi me përpikmëri detajet origjinale të katit të sipërm të ndërtesës dykatëshe, duke formuar një kompleks ndërtimor. Për ndërtesën përdhese në formë rrënoje të ndodhur në krah të djathtë të ndërtesës dykatëshe (shih Fig. 31), kemi rastin e plotësimit të ndërtimit dykatësh, i cili, në katin përdhe u restaurua plotësisht mbi bazën e elementeve origjinale, ndërsa kati i sipërm u projektua në analogji me kriteret e projektimit të ndërtesave të kësaj periudhe. Kështu, me realizimin e kësaj ndërhyrjeje në projekt kemi përfitimin e një blloku ndërtimor me vlera të spikatuara në fushën e artit shqiptar të të ndërtuarit.

Në ansamblin e rrugës “Kardinal M. Koliqi”, vlerësojmë dy raste të ndërhyrjeve në plotësimin e boshllëqeve. Rasti i parë është ai i mungesës së ndërtimit brenda tërësisë së ansamblit (Fig. 31). Evidentimi i gjurmës së çatisë e mbështetur në murin kallkan të një ndërtimi dykatësh, si dhe dokumentacioni fotografik i gjetur (Fig. 44)[11], hodhën dritë mbi tipin

[11] Dokumentacioni fotografik është siguruar nga pronarët.



Fig. 44. Foto e vjetër e një ndërtimi përdhes

e një ndërtimi përdhes të trashëguar nga qendra e vjetër. Projekti përkatës respektoi me përpikmëri volumin, teknikën e ndërtimit dhe si tipologjinë e elementeve arkitektonike të pamjes së jashtme, sipas dokumentacionit fotografik.

Rasti tjetër është ai i ndodhur në fundin e vargut të ndërtesave të krahut të majtë të ansamblit (Fig. 32) ku, në mungesë të dokumentacionit fotografik u përdor projektimi sipas parimit të analogjisë. Në vlerësim të vendndodhjes së boshllëkut, në pjesën fundore të rrugës, njëherazi në kthesë të saj, po ashtu në mbështetje të një faqeje të lartë kallkani të ndërtesës dykatëshe të ndodhur në krah, ndërtimi i ri u projektua tre katësh me karakteristikat e periudhës së fillimshekullit XX, të cilat u gjurmuan, u studiuan dhe u projektuan me mjaft kujdes në projektin përkatës.

Rastet e ndërtimeve të reja, si dhe të përshtatjeve pa kriter në hapësirat e trojeve të rrugës “Kardinal M. Koliqi”, siç është ndërtimi në figurën 29, i cili me volumin dhe trajtimin e pamjeve të jashtme i bie ndesh

DO NOT COPY

karakteristikave tradicionale të zonës dhe për pasojë dëmton rëndë pamjen e ansamblit, hapin probleme serioze në aspektin socialo-shoqëror. Ndërtime të tilla duhet t'i përshtaten tërësisht karakteristikave të ansamblit, shpesh me ndërhyrje të dhimbshme për pronarët, pa përjashtuar dhe rastet e prishjeve të plota.

Rehabilitimi i infrastrukturës së rrugës dhe ndriçimi karakteristik

Projekti "Restaurimi i pamjeve të jashtme të ndërtesave të rrugës K. M. Koliqi" është pjesë përbërëse e projektit "Rehabilitimi i infrastrukturës së rrugës "Kardinal Mikel Koliqi" të financuar nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Rehabilitimi i infrastrukturës së rrugës ka ecur paralelisht me restaurimin e pamjeve të jashtme të ndërtesave të ansamblit. Domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje në infrastrukturën e rrugës shpjegohet me gjendjen mjaft të amortizuar të asfaltit të trasesë së rrugës dhe të trotuareve, të cilët për vite të tëra nuk i ishin nënshtruar një rikonstrusioni të mirëfilltë. Po ashtu, pamja e re e përftuar nga restaurimi i ndërtesave të ansamblit kërkonte një bazament rrugor, një trajtim të ri në përshtatje me teknikat bashkëkohëse të periudhës së fillimshekullit XX me vendet e rajonit. Kristalizimi në vite i këtij ansambli me tiparet e ndërtesave të fillimshekullit XX, ardhja deri në ditët e sotme, si dhe ndërhyrja e procesit të restaurimit, nuk e justifikonin tashmë rivendosjen e teknikës së hershme, atë me gurë e dhé të ngjeshur, përfaqësuese e qendrës së vjetër të qytetit, e cila, nuk i afronte asnjë komoditet dhe përshtatje kërkesave të kohës. Kështu, u vendos të ruhet struktura origjinale e rrugës, që përkonte njëherazi me gjendjen ekzistuese të saj, por të shtruar me asfalt. Traseja e rrugës e zhvilluar në qendër me pjerrësi në të dy krahët e saj si dhe trotuaret u shtruan me pllaka guri të daltuar me formate katërkëndëshe në ngjyrë ohër dhe gri si dhe u vendosën kunetat e gurta me fund harkor. Trajtimi i rrugës preku dhe fillimet e daljeve te kryqëzimet, atë te rrugica "Luigj Gurakuqi" dhe atë në krah të ndërtesës së "Dabërdakëve", si dhe në dalje. Në hapësirat e gjera të trotuareve, të formuara për shkak të zhvillimit të rrugës në formë gjarpëruese, u vendosën stola pushimi si dhe kënde gjelbërimi, për një relaksim të banorëve dhe kalimtarëve të rrugës.

Një element përbërës i rikonstruksionit të infrastrukturës së rrugës "Kardinal M. Koliqi" si dhe pjesë organike e rëndësishme e restaurimit të ansamblit ndërtimor ishte dhe ndriçimi karakteristik, ku struktura e vjetër e ruajtur deri në ditët tona, ajo me ndriçim qendror ishte amortizuar plotësisht dhe nuk plotësonte fluksin e duhur të ndriçimit të rrugës. Duke u nisur nga teknikat tradicionale të ndriçimit të periudhës së fillimshekullit XX, me përdorimin e ndriçuesit tip kolonë punuar me metal si dhe të ndriçuesit tip braçet me punime hekuri, u përdor ndriçimi tip kolonë në forma më të stilizuara. Ndriçuesit kolonë tip tresh u vendosën në sfondin e ndërtesave me një arkitekturë më të pasur të elementeve të saj përbërëse (Fig. 45), duke vazhduar me ndriçuesit kolonë tip njësh; në krye të rrugicave u vendos tipi braçet stilizuar nga elementet origjinale. Po ashtu, ndriçimi i rrugës u plotësua dhe me vendosjen e spoteve të ndriçimit në pika të caktuara. Procesi i ndriçimit të rrugës "Kardinal M. Koliqi" kishte për qëllim jo vetëm arritjen e fluksit të duhur të ndriçimit në përshtatje me kërkesat bashkëkohore, por, njëherazi, të pasqyronte dhe të vlerësonte momentet më të spikatura të arkitekturës së ndërtesave të fillimshekullit XX (Fig. 46).

Ndërhyrjet plotësuese për rehabilitimin e plotë të ansamblit.

Me fondin e planifikuar për projektin "Restaurimi i pamjeve të jashtme të ndërtesave të rrugës Kardinal M. Koliqi" si pjesë përbërëse e projektit "Rehabilitimi i infrastrukturës së rrugës "Kardinal Mikel Koliqi" të

DO NOT COPY

financuar nga Delegacioni i BE u arrit të realizoheshin ndërhyrjet më të rëndësishme për rivlerësimin e vlerave të dëmtuara historike, urbanistiko-arkitektonike dhe panoramike të ansamblit (Fig 47-49). Sigurimi i financimeve të mëtejshme do t’i shtyjë më tej këto ndërhyrje, sidomos për punimet e infrastrukturës, për të mundësuar restaurimin dhe rehabilitimin e plotë të këtij ansambli të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore të qytetit të Shkodrës.



Fig. 48. Pamje të restaurimit të rrugës dhe ndërtesave.

DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

RESTORATION OF URBANISTIC-ARCHITECTURAL ENSEMBLE IN THE STREET "KARDINAL MIKEL KOLIQI" SHKODER

The new shopping center coincides partially with the Historic Center of the City of Shkodra, consisting of urban-architectural ensembles of three streets: Kol Idromeno street, "13 December" street, and "Branko Kadia" street, declared Cultural Heritage, With the Decision of the Council of Ministers Nr. 249, date 01.07.1980. These urban-architectural ensembles maintain important values closely related to the construction activity of the end of 19th and beginning of the 20th century, where the first two ensembles crossing the city center, are at the same time a proof of the economic and trade development of the city for that period.

This article will address the criteria and problems of restoration intervention in the urbanistic and architectural ensemble of "Cardinal Mikel Koliqi" street with unparalleled historical, urbanistic, architectural and artistic values of the late 19th and early 20th centuries.

Constructions have begun since the last decades of the 19th century and continued in the 20th century. The economic empowerment of the city, the birth of the new commercial bourgeoisie, the trend of reconstructions in the spirit of the era in accordance with the new way of life, brought the ultimate break from the old medieval shop and apartment variant, bringing radical changes to the sights of this ensemble.

The construction ensemble of "Cardinal M. Koliqi" street is famous for its architectural accomplishments. Quite elaborate is the exterior appearance of many buildings, especially those with the ornamental plaster. All the plastic with which these images are adorned is achieved through the combination of plaster, bricks with decorative function, wood modelings, stone moldings, decorative brick uses, arched bends, and elegance of the application of decorative iron.

The reason for dominance and development to a considerable extent of this type of construction with a diverse architecture and rich décor in the main and lateral view of the alleys is that it fits in with the new commercial bourgeoisie associated with competitive commerce. This architecture overcomes the national framework in its general features without undermining the previous tradition, giving new features to this architecture that are related to the concrete circumstances of the country it developed.

Of course, designers of these constructions are figures like Kolë Idromeno, the author of the buildings, and many others; Pjetër Marubi and others named after that time, who invented new construction methods and techniques with contemporary fantasy and conception.

We will also appreciate the hands and the golden minds of our talented masters who, with their realization, gave life and spirit to this architecture, which has truly come to this day.

The restoration brought the need for a careful study of the development of the urban and architectural ensemble in time, noting the existence of several construction stages that have coexisted in harmony over the years. First: As a result of moving the old town from the rock of the castle to the area where today the city lies. Second: The new socio-economic conditions and the new contemporary demands of the early 20th century. Third: Developing a new city center in line with the new socio-economic conditions. Fourth: During the ensemble's development at the time, we have many buildings, which, for the most part, have not been able to be reconstructed. Fifth: We notice that in the 30-40s of the twentieth century, the desire for decorative treatment of the exterior of buildings was noticeably reduced, treating them simply by the decoration of the exterior. Sixth: We have many constructions built without criteria and values both in terms of architectural-volume and technical one.

In general, the technical condition of this ensemble was poorly presented. Major and serious transformations belong to the first group of constructions, due to their timelessness.

The existence of several stages of the construction of this cultural heritage, which have coexisted in harmony over the years, provide the opportunity to follow the process of evolution of popular constructions in time, as a dynamic development forward, that carries a series of joints making up a unit alone, the apartment, the building, with different degrees of achievements in the compositional and architectural-constructive plan.

The project aimed at re-evaluating the historical, and architectural - urbanistic values lost in the years as well as the complete architectural harmonization of the ensemble as an important part of the Cultural Heritage of the city of Shkodra, the period of the late 19th century and the beginning of 20th century.

The design of the restoration project was accompanied by a detailed and serious study of the evolution of the constructional character at the time of this ensemble, in order to determine in principle the criteria for restoration intervention. For this purpose, a study was carried out with the precise design of the graphic, discriptive and photographic documentation, relying heavily on the rich photographic documentation of the Marubi; as well as the collection of oral data and particularly stopped to the original tracks emerging during the careful survey of buildings.

In the space of time, from the beginning of the nineteenth century to the present day, in the beginning of the 21st century, the ensemble of "Cardinal M. Koliqi" street has suffered the phenomenon of complete damage to buildings that by their very age belonged mainly to buildings inherited from the old center of the city as well as interference, additions of constructions without criteria and without value in the traditional aspect. In this context, while respecting the in-depth study and professional care, it is achieved a compositional-volumetric reconditioning of these gaps, giving the possible contribution to the panoramic filling of the silhouette of this ensemble.

The restoration of the exterior of the ensemble buildings has proceeded in parallel with the rehabilitation of the road "Cardinal Mikel Koliqi" infrastructure. An integral element of the reconstruction of the road "Cardinal M. Koliqi" infrastructure as well as an important organic part of the restoration of the construction ensemble was the peculiar illumination, where, based on the traditional lighting techniques of the early 20th century, column type illuminators, worked with metal, and iron type bracket illuminators, lighting through column type in more stylized forms was used.

The complete lack of funds explaines the fact that many buildings, as the construction complex of prominent architectural and decorative values, were not subjected to restoration interventions, with the possibility of planning a second fund for the complete restoration of this ensemble.

DO NOT COPY

The coordination of contemporary life activities with old urban ensembles, for today and for the future, should be considered as one of the key factors in preserving cultural heritage values that can not simply live as relic. Urban and architectural ensembles of the late 19th and early 20th centuries can coexist with the city in their entirety and ensure their continuity by being in organic, functional and compositional relation between each other in respect of one another, so as the old being not as an obstacle to the new.

DO NOT COPY

monumentet
57/2018

Genci TRESKA
Gentian VOKOPOLA

DO NOT COPY

RESTAURIMI I TAVOLINËS SË PUNËS SË POETIT NDRE MJEDA

1. Hyrje

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013, në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit në Institutin e Monumenteve të Kulturës u kryen ndërhyrje për restaurimin e tavolinës së punës të klerikut dhe poetit shkodran Ndre Mjeda. Tavolina mbërriti në IMK pas përpjekjeve pothuajse dyvjeçare të inisiatorit të këtij misioni fisnik Dom Nik Ukgjinit, pa kontributin dhe dashamirësinë e të cilit nuk do të qe bërë i mundur restaurimi i saj.

Para se tavolina të zhvendosej në IMK për tu restauruar, gjendej në ambientet e Muzeut Historik të Shkodrës, e magazinuar bashkë me shumë objekte të tjera në gjendje aspak të përshtatshme për këto pasuri të kulturës sonë kombëtare. Në fillim të këtij artikulli do të donim të jepnim një panoramë më të gjerë për figurën e Ndre Mjedës si dhe historinë e rrugëtimin 100 vjeçar të kësaj tavoline.

2. Jeta dhe vepra e Mjedës

Dom Ndre Mjeda lindi në qytetin e Shkodrës më 20 Nëntor 1866 në një familje të ardhur nga fshati Mjedë. Nga viti 1880 deri më 1887 ai studioi letërsi në manastirin Carthusian e Porta Coeli në Valencia, Spanjë e më vonë studioi retorikë, latinisht dhe italisht në Kroaci në një institucion jezuit, më pas në Universitetin Gregorian në Romë dhe në një tjetër kolegj në Chieri në Itali. Gjatë këtyre studimeve Mjeda filloi të shkruajë poezi dhe në krijimtarinë e tij letrare ai u ndikua nga shkrimtari jezuit Anton Xanoni dhe poeti françeskan Leonardo De Martino. Në vitet 1887-1891 Mjeda ka dhënë mësim muzike në Kremona, Itali, në kolegjin e Marco Girolamo Vida dhe ka përkthyer literaturë të ndryshme fetare. Ai botoi « Jeta e Shën Berchmans » në 1888 dhe « Imitim i bekuar » në 1892, një përkthim spanjisht nga Katekizmi i Madh, si dhe një përkthim tjetër nga Historia e Shenjtë. Më vonë Mjeda studioi teologji në kolegjin jezuit në Krakov në Poloni ku mësoi filozofi dhe filologji, si dhe shërbeu si bibliotekar në Kolegjin Gregorian në Krajlevica ku u emërua profesor i logjikës dhe metafizikës. Në vitin 1898 i përjashtuar për mosbindje ai u kthye në atdhe, ku u emërua famulltar në fshatra të ndryshëm. Në këtë periudhë u lidh me lëvizjen patriotike kundër Perandorisë Osmane, gjë për të cilën autoritetet osmane e arrestuan.

Më 1908 Dom Ndre Mjeda ishte anëtar i Komisionit për hartimin e alfabetit të njëhsuar të shqipes. Gjatë periudhës 1920-1924 ai mori pjesë aktive në jetën politike dhe u zgjodh deputet, por pas dështimit të Revolucionit Demokratik u tërhoq nga jeta politike dhe punoi si prift në Kukël. Vitet e fundit të jetës Mjeda ishte mësues i gjuhës shqipe në Shkodër dhe ndërroi jetë në këtë qytet më 1 gusht 1937.

Pikërisht gjatë punës së tij si prift në kishën e Kuklit, e projektuar nga vetë Mjeda në stilin neoklasik kushtuar Shën Shtjefnit, martir i shekullit I, e ndërtuar në vitin 1913 me ndihmën financiare të qeverisë austriake fillon dhe historia e tavolinës së tij. Fshati Kukël gjendet në Komunën Bushat në kufirin administrativ të rretheve Lezhë e Shkodër dhe famullia është ndërtuar në një terren të lartë e dominant, duke ofruar një peisazh të mrekullueshëm të fushës së Zadrimës. Famullia e Kuklit tani Kompleksi Muzeal Ndre Mjeda Kishe-Qelë, ka në përbërjen e tij kishën, e restauruar vitet e fundit si dhe shtëpinë ku ka jetuar e punuar Mjeda. Shtëpia, sipas studiuesve të Mjedës, është më e hershme dhe i takon vitit 1906. Muret ballore të objekteve janë zbukuruar me figura të gdhendura dhe paraqesin episode mitologjike. Në ballinën e shtëpisë është koka e kurorëzuar e Bachtusit, martirit sirian të shek. IV, por sipas Dom Nik Ukgjinit, famullitarit të tanishëm të Kuklit, mund të interpretohet dhe si kurorë me gjemba e Krishtit dhe përmban disa tipare karakteristike të klerikut poet Mjedës, si mustaqet e pjesa e ballit. Në të majtë të ndërtesës është Labeatia, basoreliev i emblemës së një prej fiseve ilire.

Në një botim në « Gazetën Shqiptare » të datës 26 korrik 2011, Dom Nikë Ukgjini shprehet se tavolina e punës së Ndre Mjedës ka kryer nje rrugëtim të gjatë. Ai shton se të paktën nga autorët e Veriut të Rilindjes sonë nuk shënohet se kemi të ruajtur ndonjë objekt të tyre pune. Ajo është tryeza e punës së Ndre Mjedës në të cilën u shkruan poezitë « Vaji i bylbylit », « Shtegtari », « Tringa », « Shkodra », « Lussus », etj. Kujtime të rrogëtarit të Mjedës, Dodë Gjon Gazuli gjatë viteve 1920-1937 dëshmojnë se Mjeda e kishte këtë tavolinë të mbushur vazhdimisht « plot libra e letra ». Kjo tryezë, në të kaluarën e saj, duke kaluar nga dora në dorë, nga njeri vend në një tjetër, pësoi dëmtime të rënda. Pas vdekjes së poetit, objekte të ndryshme kishin mbetur pasuri e famullisë së Kuklit. Prej vdekjes së tij e deri në vitin 1941 tavolina u administrua nga famulltari i Barbullushit Dom Karlo Prendushi, ndërsa në vazhdim, u përdor dhe ruajt nga famulltari i ri i Kuklit, Dom Zef Gila. Sipas studiuesit të njohur të Mjedës, Mentor Quku, poeti shkodran, Sandër Gera (1926-1982), në kujtimet e tij, duke folur për mësuesin e tij të dashur, Ndre Mjedën, me nostalgji të madhe flet për tryezën e poetit. Ai thotë se « Kur kam qenë mësues në Barbullush, në vitin 1947, kam ndërrue tavolinën e Mjedes që e kishte kryetari i këshillit popullor të Kuklit, Martin Neli, me nji tjetër ». Madje Gera thotë se, nga tryeza e Mjedës, qe frymëzuar dhe shkroi sonetin e tij « Bisedë me Poetin ». (Shkodra, viti 2, nr.2, fq. 156, Shkodër 1962). Sipas poetit Gera « Shtroja e tryezës së poetit asht kadifeje së gjelbërt, dalë ngjyre nga vjetërsia dhe e grisun ndër shumë vende ». Duke njohur vlerën e saj në vitin 1959 ai e çoi tavolinën në Muzeun e Shkodrës. Këtë fakt e dëshmon dhe Vasil Llazari, drejtor i Muzeut Popullor të Shkodres, shkruar në Almanakun « Shkodra, viti 1961). Në vitin 1962 me rastin e 25 – vjetorit të vdekjes së Dom Ndre Mjedës, tavolina u kthye në Shtëpinë Muze në Kukël. Gjatë tërmetit të 15 prillit 1979, Shtëpia Muze u dëmtua rëndë dhe në 1981, Muzeu u restaurua ku në qendër të vëmendjes ishte tryeza e poetit, si objekti më autentik. Gjatë viteve 1990, bashkë me shumë objekte të tjera, edhe tryeza e punës së Mjedës u kthye në Muzeun Historik të Shkodrës ku qëndroi deri tani dhe erdhi për restaurim në IMK.

3. Stili dhe teknikat e realizimit të tavolinës

Tavolina e punës së Dom Ndre Mjedës është prodhim industrial dhe pjesërisht i punuar me dorë në teknikën e gdhendjes. Mënyra e punimit të saj i takon fundit të shek. XIX dhe fillimshekullit të XX. Për origjinën e

DO NOT COPY

vendit ku kjo tavolinë mund të jetë punuar ekzistojnë dy supozime. Kjo për faktin se nuk ka asnjë të dhënë se ku e kishte porositur Mjeda tavolinën apo dhe supozimi se më herët ajo mund të ketë qenë përdorur nga dikush tjetër. Në kërkimet tona këtë lloj krijimtarie në fushën e prodhimit të orendive të këtij tipi e kemi hasur kryesisht në Itali. Fakti që nuk ka të dhëna të sakta se nga ku mund të ketë ardhur tavolina, na bën të mendojmë që ajo mund të ketë ardhur nga Italia, por nuk përjashtohet dhe mundësia tjetër që ajo të jetë punuar në qytetin e Shkodrës në ndonjë nga punishtet e drurit që nuk ishin të pakta, duke qenë se Shkodra rreth viteve 1900, ishte qendra ekonomike e Shqipërisë së Veriut. Në dyqanet dhe punishtet e shumta mjeshtrit shkodranë përpunonin mëndafshin, argjendin, pëlhurat dhe punimin e orendive prej druri. Një arsye tjetër që është në favor të mendimit se ajo është prodhuar në Shkodër i takon ngjyrës së tavolinës. Të gjitha tavolinat e prodhuara rreth 1900 në Itali kanë ngjyrë të çelët, pranë tonit origjinal të drurit, ndërsa tavolina e Mjedës është e errët në ngjyrë arre, megjithatë nuk përjashtohet fakti që ajo të jetë lyer në këtë ngjyrë me vonë.

Tavolina i përket tipit me pesë sirtarë nga të cilët dy të mëdhenj janë sipër këmbëve në pjesën ballore, dy të tjerë sipër tyre dhe një sirtar më i hollë dhe më i gjatë në qendër. Përmasat e saj janë: Lartësia 88 cm, gjatësia 127,5 cm dhe gjerësia 65,5 cm. Sipër suprinës në pjesën fundore ka një konstruksion tjetër me katër koloneta të vogla dhe me dy sirtarë të tjerë të vegjël (Foto 1). Në pjesën e sipërme bien në sy dy parmakë të mbështetura në pjesët anësore të tavolinës me nëntë koloneta të vogla të tornuara, por në suprinën e tavolinës nuk ka shenja se ato kanë qenë të bashkuara me tavolinën, fakt ky që na shtyn të mendojmë se ato nuk janë pjesë e kësaj tavoline ose duhet ti jenë shtuar asaj më vonë. Materiali i përdorur është dru bredhi dhe rimeso arre. Bien në sy elementët e gdhendur të paraqitur në pjesen fundore të këmbëve, në këndet e tavolinës dhe në ballin e tavolinës. Gdhendja paraqitet e cekët e me motive floreale. Këmbët e tavolinës (Foto 2,3) janë të punuara në torno në forma të rrumbullakuara, ndërsa sirtaret paraqiten të kornizuara me fileto ornamentike. Sipërfaqja e tavolinës është tonuar me bojë arre dhe e vernikosur me gomallatë.

Në pjesën qëndrore të suprinës këto tipe tavolinash që përdoreshin si skrivani kishin të vendosur copë, zakonisht lëkure ngjyra të gjelbëra, më rrallë të kuqe, e akoma më rrallë edhe ngjyrë okër. Në kujtimet e poetit Gera thuhet se *« Shtroja e tryezës së poetit asht kadifeje së gjelbert …… »*, por gjatë pastrimit të suprinës së tavolinës u zbuluan edhe gjurmë të copëzave në ngjyrë të kuqe akoma të ngjitura. Në fakt shumica e tavolinave e kanë patur të gjelbër copën në pjesën qëndrore të suprinës dhe më rrallë hasen tipe tavolinash me copë të kuqe. Nuk do të ishte çudi që tavolina të ketë patur dy lloj shtresash, një të kuqe poshtë dhe të gjelbrën sipër



Foto 1. Pjesa sipër suprinës

DO NOT COPY



Foto 2. Këmbë ballore



Foto 3. Këmbë e pasme

DO NOT COPY

4. Gjendja e konservimit

Objekti kishte qëndruar për një kohë të gjatë në ambient të papërshtatshëm e me lagështirë, duke bërë që gjendja e konservimit të paraqitej mjaft e keqe dhe duke sjellë një dëmtim të madh të materialit që është përdorur për tavolinën (dru bredhi dhe rimeso arre). Tavolina na u paraqit në shumë pjesë të ndara si nga moskujdesi njerëzor ashtu dhe nga shpërbërja e faktorëve të natyrës dhe kohës. Vëreheshin mungesa të pjesshme dhe totale të pjesëve funksionale (dy sirtarët, filetot dekorative etj) të tavolinës, si dhe mungesë të elementeve konstruktivë të saj. Në përgjithësi druri ishte shumë i dëmtuar ku vëreheshin çarje, ndarje, deformime të elementeve të suprinës, depozitime sipërfaqsore (pluhura), sulm i insekteve ksilofagë, sulm i faktorit biologjik (myk), dhe si pasojë e prezencës së gjatë të lagështirës konstatuam shkëputje të rimesos nga suporti i drurit të bredhit ndërsa në disa zona vërehej mungesë totale e saj. (Foto 4,5,6,7,8)



Foto 4. Gjendja e tavolinës para ndërhyrjes



Foto 5. Element sirtari i madh



Foto 6. Kapak sirtari i madh



Foto 7. Element sirtari i madh



Foto 8. Sirtar i vogël mbi suprinë

5. Ndërhyrjet konservuese – restauruese që u kryen

- Ndërhyrja e parë që u krye, ishte disinfektimi nga insektet ksilofagë, i cili u realizua nëpërmjet penelit dhe injektimit me substanca me bazë **PER-XIL 10**. Menjëherë pas këtij procesi u procedua me mbështjelljen e tavolinës me plasmas, gjendje në të cilën u la për 21 ditë duke kryer kështu dizinfektimin e plotë të objektit.
- Më pas puna u përqendrua në pastrimin e sipërfaqes së tavolinës. Në fillim u krye mikroaspirimi i të gjithë sipërfaqes, proces që u realizua nëpërmjet një peneli të butë dhe aspiratorëve me presion të ulët. Heqja e depozitimeve sipërfaqësore u bë e mundur nëpërmjet një solucioni ujor **Tween 20 2%** në **H2O** dhe me **Alkool etilik** me tampona të vegjël pambuku. Heqja e substancave të huaja u krye nëpërmjet solventit **AE (açeton + ethanol) fd 41,5** dhe me mënyrën mekanike me bisturi.
- Duke parë se kishte shumë çarje në pjesë të ndryshme të drurit, shkëputje të pjesëve konstruktive të tavolinës nga njëra-tjetra si dhe shkëputje të rimesos nga druri u krye ringjitja e tyre. Procesi i ringjitjes u krye me ngjitës organik i llojit tutkall dhe në pjesën më të madhe të rasteve u përdorën dhe morsetat për të arritur një rezultat më të mirë të këtij procesi që forcoi strukturën e tavolinës.

DO NOT COPY

- Konsolidimi i sipërfaqes së sfungjerizuar të drurit në shumë pjesë u krye me **Paraloid B72 3%** në **DOWANOL**.
- Plotësimi i pjesëve të munguara u krye me të njëjtin lloj druri (bredh) duke ruajtur konfiguracionin origjinal, kjo jo vetëm për arsye të një paraqitje sa më estetike por edhe sepse në disa pjesë ndihmoi dhe konstruksionin e tavolinës mjaft të dëmtuar. Gjatë këtij procesi tavolina u plotësua me dy sirtare që mungonin, ndërsa sirtaret ekzistues që kishin mungesa të kornizave u konfiguruan me korniza të reja.
- Gjithashtu në disa zona u aplikua dhe rimeso e re e cila më pas u tonua në uniformitet me ngjyrën e tavolinës. Stukimet e të gjitha vrimave dhe lakunave të thella u kryen me **Araldite**.
- Të gjitha pjesët e reja, si sirtaret ashtu dhe kornizat, u integruan me bojë arre me ton më të lehtë, për ti diferencuar nga masa e madhe origjinale e tavolinës. Në fund u krye vernikosja përfundimtare me **Gomallatë**.

Të gjitha ndërhyrjet që shpjeguam më sipër janë të dokumentuara nga një numër i madh fotografish, një pjesë të të cilave po i paraqesim më poshtë (Foto 9 deri 20).

DO NOT COPY



Foto 9. Përforcimi i bazamentit të këmbës



Foto 10. Montimi dhe përforcimi i sirtarit të madh



Foto 11. Sirtari para montimit



Foto 12. Montimi i sirtarit



Foto 13. Plotësimi me dru i elementit të dëmtuar



Foto 14. Plotësimi me dru i elementit të dëmtuar



Foto 15. Montimi i përgjithshëm

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Foto 16. Plotësimi me kornizë



Foto 17. Plotësimi me kornizë



DO NOT COPY

Foto 18. Para integrimit



Foto 19. Pas integrimit



DO NOT COPY

Foto 20. Tavolina e përfunduar

Në datë 20 Nëntor 2013 me rastin e 147 vjetorit të lindjes së Ndre Mjedës, tavolina tashmë e restauruar, u rikthye dhe u prezantua në famullinë e Kuklit, atje ku është shtëpia e saj.

monumentet
57/2018

Genci TRESKA
Gentian VOKOPOLA

DO NOT COPY

RESTORATION OF POET NDRE MJEDA'S WORK TABLE

In the second half of the year 2013, in the Laboratory of Restoration of Arts' in the Institute of Monuments of Culture, procedures, of restoration of the personal table of the well known poet and priest Ndre Mjeda, were accomplished.

This table was finally delivered in IMK, as a result of e very consistent, 2 years long endeavor, from Dom Nik Ukgjini, whom, as a very attentive and willful supporter of this initiative, contributed greatly in this achievement.

Dom Ndre Mjeda was born in 20 November 1866 in Scutari, in a family originating from the village of Mjeda.

Memories from Mjeda's village clerk, Dod Gjon Bazuli, tell that during the period 1920-1937, the poet's table was always "full of books". In the years to come, this table passed from owner to owner and from place to place, being gravely damaged in this the process.

After poet's death, his belongings were inherited by the chapel of Kukli's village. Later on, till the year 1941, this table was passed to Dom Karlo Prendushi at the chapel of Barbullush's village and after that under the ownership of the new priest of Kukli's village, Dom Zef Gila.

This personal table of Dom Ndre Mjeda is mainly a factory production, partly embellished by hand craft works by carving techniques. Its production dates back to the end of 19th century and beginning of 20th century. The table is considered a scrivener type, with 5 drawers, 2 of them, the biggest ones, positioned centrally above the frontal part of the table and the 2 others smaller drawers and a thin longer one, position in the center.

The table was stored for a long period in inappropriate and humid conditions, causing a lot of damage to its berth wood and nut rimeso.

The restoration intervention, performed by the specialists, consisted mainly in disinfecting the object, clearing its damaged surfaces, sticking together the broken parts and polishing the surface of the wooden parts of it.

After that, the substitution, using the same type of wood, of the missing part of the table, was accomplished by the very professional stuff of IMK. In the end the integration of the object and the final lacquer was realized.

In 20th of November of 2013, date of 147th anniversary of Ndre Mjeda's birth, the restored table, was returned to its origins in the chapel of Kukli village.

DO NOT COPY

Dr. Elio HOBDARI

DO NOT COPY

PROPOZIM ANASTILOZE PËR KANGJELLËN E BAZILIKËS MESJETARE TË SHËN JANIT (BLERIMAS, DELVINË)

Bazilika mesjetare (shek. X-XI) e Shën Janit ndodhet në një kodër të ulët në perëndim të fshatit Blerimas (dikur Shënjan) pranë Finiqit. Ajo ndodhet jashtë zonës arkeologjike të Finiqit (*Phoinike*), por duhet parë si një monument që paraqet një vazhdimësi të jetës në zonë. Fakti që një pjesë e materialit të përdorur për ndërtimin e saj, sidomos elementëve të skulpturës së saj, duhet të vijë nga Finiqi i jep edhe më kuptim këtij pohimi. Ajo është gërmuar nga një ekip i Institutit të Arkeologjisë të Tiranës ndërmjet viteve 2001 dhe 2003[1]. Një sondazh ishte bërë në pjesën e sanktuarit në vitin 1978 dhe duhet të ishte vazhduar edhe një vit më pas.

Monumenti ka kaluar nëpër disa faza nga të cilat më e rëndësishmja është ajo e ndërtimit të bazilikës trenefëshe mbi një kishë më të hershme njënefëshe[2]. Në këtë kohë kisha transformohet në një bazilikë trenefëshe me harkada me nga tre harqe secila mbi pilastra në muraturë mjaft të gjata. Sanktuari zë një pjesë të madhe të nefit qendror, rreth 2/5 e gjatësisë (fig. 1). Në absidë krijohet një sintron me disa shkallë (katër prej tyre ruheshin pjesërisht në momentin e gërmimit). Sanktuari ndahej nga naosi me anë të kangjellës dhe përpara saj ndodhej korridori i kalimit *(solea)*, me parapete në dy anët, që e lidhte me ambonin e vendosur në qendër të nefit.

Kangjella e Shën Janit është, për nga forma, e njëjtë me shembujt e tjerë të njohur në arkitekturën bizantine dhe është më e ruajtura në kategorinë e saj në territorin e Shqipërisë. Elementë kangjellash mesjetare ruhen edhe në monumente të tjera në territorin tonë (Peshkëpi e Sipërme[3], Labovë e Kryqit[4], Xhermëhallë (Delvinë), Ballsh[5], Mesopotam, Berat etj), por vetëm nga kangjella e Shën Janit ruhet një sasi e tillë elementësh që na lejon të bëjmë një rikonstruksion hipotetik me saktësi të pranueshme dhe me toleranca vetëm në detaje.

Një ringritje (anastilozë) e saj nëpërmjet integrimit të pjesëve përbërëse dhe riprodhimit të pjesëve që mungojnë është e mundur.

Kjo kangjellë do të zinte një vend të rëndësishëm në

[1] S. Muçaj, K. Lako, E. Hobdari dhe I. Vitaliotis, Rezultatet e gërmimeve në bazilikën e Shën Janit, Delvinë (2001-2003), Candavia 1, 2004, f. 93-123.

[2] Po aty, f. 98-102.

[3] E. Hobdari, Skulptura dhe instalimet liturgjike në kishën e Shën Mërisë në Peshkëpi të Sipërme (Gjirokastër), Iliria XXXIV (2009-2010), Tiranë 2011, f. 336-337.

[4] Po aty, f. 334, tab. XI, 9.

[5] S. Muçaj, E. Hobdari, Manastiri i Shën Mërisë, Ballsh (Glavinicë). Gërmime të vitit 2003, Candavia 1, 2004, f. 202.



DO NOT COPY

Fig. 1. Planimetria e bazilikës së Shën Janit me pjesën e stilobatit të evidentuar me gri.

një muze të ardhshëm arkeologjik në Sarandë që duhet parë si domosdoshmëri për të prezantuar materialin e shumtë arkeologjik që vjen nga sitet arkeologjike shumë të pasura të territorit përreth saj, përveç Butrintit, i cili ka tashmë muzeun e tij arkeologjik të konsoliduar.

Të dhënat arkeologjike për kangjellën

Situata e arkeologjike e gjetjes së elementëve përbërës të kangjellës nuk ndihmonte për të kuptuar diçka në lidhje me pozicionin e ndonjë elementi të saj. Pas shkatërrimit të bazilikës, materiali skulpturor është shpërndarë, ripërdorur dhe, me gjasë, pjesërisht marrë dhe zhvendosur nga siti. Besohet se amboni dhe *solea* janë eliminuar më herët dhe disa pjesë të tyre janë ripërdorur në riparime të dyshemesë së nefit qendror dhe ambienteve në perëndim të kishës. Kangjella duhet të ketë mbijetuar duke pësuar modifikime. Rindërtimi hipotetik i saj pas studimit paraprak të elementëve të gjetur ishte jo i vështirë (fig. 2-3), pasi shembuj të kangjellave të këtij lloji ruhen në numër të madh[6]. Ajo përbëhet nga katër pilastra me seksion katërkëndor, të cilat në pjesën e sipërme reduktohen në koloneta me seksion tetëkëndor me kapitel të inkorporuar, mbi të cilët vendoset epistili. Dy hapësirat anësore mbyllen me pllaka parapeti me një dorërrëshqitës *(handrail)* mbi të.

Si stilobat shërbenin ekstremet e pllakave më perëndimore të dyshemesë së sanktuarit, e ndodhur kjo mesatarisht rreth 10 cm mbi dyshemenë e nefit qendror (fig. 4).

Ajo që nuk është e qartë është prejardhja e elementëve të kangjellës në momentin e ndërtimit fillestar të saj. Një nga dy pllakat është reduktuar pak në gjatësi për t'u përshtatur me hapësirën. Dhe nuk është e qartë pse elementët e epistilit mund të kenë pasur dekore të ndryshme. Mund të mendohet edhe që disa elementë të kenë ardhur nga kisha të ndryshme, të dala jashtë



Fig. 2. Rikonstruksion hipotetik i kangjellës së bazilikës së Shën Janit.



Fig. 3. Pamje 3D e sanktuarit me instalimet e tij.

funksionit dhe të jenë ripërdorur.

Fakti që pilastrat në të dy anët e hyrjes duket se kanë pasur dekor në faqen ballore është i çuditshëm duke qenë se në këto faqe mbështeteshin pllakat e *solea*-s. Dy janë mundësitë: ose kangjella i takon një fazë më të hershme dhe shtimi i *solea*-s dhe ambonit kanë ndodhur në një moment të dytë, ose kangjella është rindërtuar pas eliminimit të këtyre instalimeve që zhvilloheshin në

[6] S. Muçaj, K. Lako, E. Hobdari dhe I. Vitaliotis, Rezultatet e gërmimeve në bazilikën e Shën Janit, Delvinë (2001-2003), Candavia 1, 2004, f. 100.

DO NOT COPY



Fig. 4. Pamje e pjesës së dyshemesë që shërben si stilobat i kangjellës.

nefin qendror. Vërehet njëfarë ndryshimi në gdhendjen e dekorit ndërmjet pllakave të parapetit të kangjellës në njërën anë dhe atyre të *solea*-s dhe të shkallëve të ambonit në anën tjetër, që mund të jetë indikator i dy proceseve të ndryshme të prodhimit të tyre.

Për dorëmbështetësit *(handrail)* nuk është e qartë se cilët i takonin parapeteve të kangjellës dhe cilët atyre të *solea*-s. Ndërmjet ekzemplarëve të dalë në dritë nga gërmimi, më shumë mundësi ka që elementi me profil dhe dekor më të zhvilluar të ketë qenë pjesë e kangjellës. Të tjerët duhet t'i takojnë kangjellës së solea-s.

Elementët janë montuar dhe lidhur me njëri-tjetrin duke përdorur ganxha dhe kunja (në varësi të pozicionit) prej hekuri të fiksuara me plumb.

Elementët përbërës të kangjellës dhe gjendja e ruajtjes së tyre

Pilastrat-kolonetat e fragmentuara ruhen në numër të konsiderueshëm (fig. 5-10). Sigurisht që një pjesë i takonin kangjellave të nefeve anësorë dhe 2-4 prej tyre (pilastra të shkurtër) i takojnë *solea*-s. Ndonjë më i thjeshtë duhet të vijë nga ballkoni i ambonit. Natyrisht ekzemplarët më cilësorë përsa i takon dekorit duhet menduar se i takonin kangjellës së nefit qendror.

Të paktën një fragment i takon njërit nga pilastrat që ndodheshin në anët e hyrjes (SJ 50)[7] (fig. 5, a-b). Këta kanë edhe një pilastër më të hollë, po me seksion katërkëndor, të bashkëngjitur, i cili në pjesën e sipërme (në pikën e fillimit të kolonetës) mbyllet me një kokë sferike (SJ 33 dhe SJ 34) (fig. 6,a-b). Kalimi nga seksioni katërkëndor në atë tetëkëndor bëhet pak më lart se faqja e sipërme e dorëmbështetësve.



Fig. 5 (a, b). Pilastër i krahut të djathtë të hyrjes në sanktuar (SJ 50).

[7]Numrat identifikues të elementëve janë ata të katalogut të skulpturës së kësaj bazilike, ende i pabotuar.

DO NOT COPY





Fig. 6 (a, b). Fragment pilastri me pjesën e ngushtimit në kolonetë (SJ 37).





Fig. 7 (a, b). Fragment pilastri (SJ 38).

DO NOT COPY





Fig. 8 (a, b). Fragment pilastri (SJ 36).





Fig. 9 (a, b). Fragment pilastri me dekor në dy faqe të njëpasnjëshme (SH 35).

DO NOT COPY



Fig. 10. Fragmente kolonetash me seksion tetëkëndor (SJ 46+48 dhe SJ 90).

Pilastrat (fig. 5 - 9) janë të ndryshëm nga njëri tjetri për nga dekori. Dy fragmente të pjesëve me seksion tetëkëndor, SJ 37 dhe 90, ruajnë pjesë dekori (fig. 6, a-b dhe fig. 10). Ruhen dy kapitele të kolonetave tetëkëndore, SJ 114 (fig. 12, a-b) dhe SR 1174[8]. Ato janë të njëjta dhe janë të dekoruara me një gjysmëpalmete vetëm në faqen kryesore. Të dy duket se kanë qenë të inkorporuar me kolonetën tetëkëndore. Por koloneta SJ 90 që mbyllet në pjesën e sipërme tregon që të paktën një nga kapitelet ka qenë i veçantë dhe i lidhur me kunj hekuri me kolonetën.

Dy pllakat që mbyllnin hapësirat mes pilastrave në dy anët e hyrjes kanë dekor të njëjtë (fig. 13, a-b dhe fig. 14, a-b). Siç u tha më lart, njëra prej tyre (SJ 8) (fig. 14, a-b) është reduktuar disi në krahun e djathtë për t'u përshtatur me hapësirën. Dekori është një kryq me ekstremet e krahëve të zgjeruara me nga një disk i vendosur mbi një suport të shkallëzuar. Në dy kuadrantët e sipërm ka një dekor në formë vorbulle, ndërsa në të poshtmit nga një degë palme. Bordura përbëhet nga dy listela, ndërmjet të cilave ka një motivshiriti *torsadé* të realizuar në mënyrë jo cilësore. Ruhen të thyera në shumë fragmente, por janë plotësisht të rindërtueshme grafikisht.

Mbi pllakat vendosej dorëmbështetësi *(handrail)*. Më i përshtatshëm për pozicionin në kangjellën kryesore duket një prej tyre (SJ 31), cili ka dekor të zhvilluar sipas një aksi simetrie me gjatësi që përputhet me atë të pllakave (fig. 15, a-b).

Nga epistili ruhen njëri nga të tre elementët pothuajse i plotë (SJ 76+107) (fig. 16, a-b) dhe një fragment i vogël i një elementi tjetër (SJ 64+129) që, nisur nga përmasat, materiali dhe dekori, duhet të jetë pjesë e epistilit (fig. 17, a-b). Profili i kornizës është i drejtë me kënd rreth 45°, nën fashën e sipërme vertikale. Elementi i plotë është i dekoruar në reliev me një kërcell dysh sinusoidal, nga i cili dalin gjysmëpalmeta në të njëjtin drejtim. Fragmenti tjetër është i dekoruar, po në reliev, me një harkadë mbi kolona me kapitele, me palmeta brenda secilës hapësirë.

[8]Numër inventari i fondit arkeologjik të Sektorit të Sarandës të Institutit të Arkeologjisë të Tiranës.

DO NOT COPY





Fig. 11 (a, b). Koka pilastrash të hyrjes së kangjellës (SJ 33 dhe SJ 34).





Fig. 12 (a, b). Kapitel kolonete i kangjellës (SJ 114).

DO NOT COPY



Fig. 13.a. Pllakë ndarëse e kangjellës (SJ 5).



Fig. 13.b. Pllakë ndarëse e kangjellës (SJ 5).





Fig. 14 (a, b). Pllakë ndarëse e kangjellës (SJ 8).

Materiali i elementëve përbërës të kangjellës

Të gjitha pilastrat dhe pilastër-kolonetat e dala nga gërmimi janë prej mermeresh të ndryshëm, sigurisht të ripërdorur. Megjithë përpjekjet, ende nuk janë bërë analiza për të përcaktuar prejardhjen e mermereve. Disa ekzemplarë duket se janë prodhuar me mermer Prokonezi. Këto analiza do të duhet të bëhen në rast se do të ndërmerret restaurimi i këtij instalimi.

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 15 (a, b). Dorëmbështetës (handrail) i kangjellës (SJ 31).

Të dyja pllakat e parapetit janë prej guri gëlqeror të fortë shtresor të zonës. Janë të njëjta, për nga materiali, me shumë pllaka të tjera që janë përdorur në dyshemenë e nefit qendror. Fragmentet kanë prirje të ndahen në dy shtresa. Ato të njërës nga pllakat (SJ 5) duket se janë reduktuar të gjitha në trashësi, si edhe ndonjë fragment i pllakës së dytë. Kjo do të duhet të kihet parasysh në rast të restaurimit integrues të tyre. Fakti që në pjesën e prapme ato nuk kanë dekor, e lehtëson punën për integrimin dhe fiksimin e tyre në instalim. Materiali i dorëmbështetësit që do të përdoret është mermer Prokonezi, ndërsa elementët e ruajtur të epistilit janë prej guri ranor lokal.



Fig. 16 (a, b). Element i epistilit të kangjellës (SJ 76 + 107).



Fig. 17 (a, b). Element i epistilit të kangjellës (SJ 64 + 129).

DO NOT COPY

Restaurimi i propozuar

Pjesa e dyshemesë së nefit qendror që shërben si stilobat për kangjellën (fig. 4) do të duhet të riprodhohet në interierin ku do të montohet kangjella, së bashku me pjesët e mureve anësore (në praktikë dy ante), aty ku fiksohet epistili. Pllakat janë tri të mëdha dhe dy të vogla në ekstremet dhe ruajnë të gjitha vrimat ku fiksoheshin elementët vertikalë. Kjo do të okuponte një hapësirë lineare prej rreth 4,8 m që i duhen shtuar edhe spesori i dy mureve (anteve).

Në varësi të pilastrave që do të zgjidhen për t'u përfshirë në kangjellë në ringritjen e saj, do të kishim jo më pak se 40% të sipërfaqes të përbërë nga material origjinal. Pjesa tjetër do të duhet të riprodhohet.

Ndërsa jemi mjaftueshëm të qartë për pamjen e kangjellës, megjithë pikëpyetjet lidhur me mungesën e një homogjeniteti të plotë të elementëve përbërës, e paqartë mbetet lartësia e kangjellës. Vështirësia shtohet edhe sepse monumenti ruhet në gjendje rrënoje dhe nuk kemi asnjë referencë për lartësinë është mund të ketë pasur interieri. E vetmja e dhënë indirekte për lartësinë e elementëve vertikalë të instalimeve të brendshme është ekzistenca e një kolone të vetme të plotë, prej graniti gri[9], me prejardhje nga ciboriumi i monumentit me lartësi 235 cm. Kjo kolonë montohej mbi një bazë të ngritur rreth 20 cm, kishte një kapitel (ata që ruhen

[9] S. Muçaj, K. Lako, E. Hobdari dhe I. Vitaliotis, Rezultatet e gërmimeve në bazilikën e Shën Janit, Delvinë (2001-2003), Candavia 1, 2004, f. 104.

janë të lartë 17,5 cm dhe 20,5 cm) dhe mbi të qëndronin harqet, të larta rreth 100 cm. Mund të imagjinojmë një lartësi të përgjihshme të kangjellës jo më shumë se 3 m dhe në këtë mënyrë pilastrat, pa kapitelin, do të ishin rreth 260 cm, pra rreth 2,5 herë lartësinë e pllakave të parapetit.

Dy elementë: një pjesë e epistilit dhe një nga dy dorëmbështetësit do të riprodhohen tërësisht, secili sipas modelit të elementit simetrik me të që na ruhet.

Një nga dorëmbështetësit (SJ 31) (fig. 15, a-b) do të duhet të integrohet (pjesa e ruajtur është rreth 56%), ndërsa tjetri do të riprodhohet si elementi simetrik me të prej mermeri Prokonezi.

Pilastër-kolonetat do të duhet të integrohen në pjesët që mungojnë (seksione katërkëndore dhe tetëkëndore). Dekoret e tyre ndoshta do të ishte më e përshtatshme që vetëm të jepeshin në linja të përgjithshme me incizim, duke u nisur nga pjesët e ruajtura. Nuk duket e udhës që të theksohet fakti që ato kanë dekore të ndryshme.

Ndoshta për integrimin e elementëve të ruajtur mund të përdoret edhe mermer i ndonjë lloji vizualisht të përafërt, nëse gjetja e mermereve origjinalë do të rezultonte e pamundur ose shumë e vështirë apo e kushtueshme.

Bashkimi i fragmenteve të ruajtura të dy pllakave dhe integrimi i tyre mund të jetë më i vështirë nisur nga karakteristikat jo të mira (fortësia dhe shtresëzimi) të gurit lokal, prej të cilit janë prodhuar.

Bashkimi i pjesëve të pilastrave do të bëhet me kunja metalikë të lidhur me plumb. Në të njëjtën mënyrë do të lidhen edhe elementët e epistilit duke përdorur vrimat e lidhjeve origjinale në elementin ku ruhen. Megjithatë kjo nuk do të mjaftojë për të garantuar strukturën dhe do të jetë e nevojshme që të përforcohet ajo me një strukturë ndihmëse hekuri. Fakti që kangjella propozohet të ngrihet në një ambient të mbyllur, me më shumë mundësi përpara një pareti, e bën më të lehtë realizimin e saj, duke e ankoruar në murin në sfond. Kjo justifikohet edhe me faktin tjetër se asnjë nga elementët e strukturës nuk ka dekor në faqen e prapme.

Ideja mund të zhvillohet edhe duke parë mundësinë e rindërtimit të *solea*-s dhe ambonit, duke plotësuar tërësisht strukturën që në këtë rast do të ishte voluminoze dhe do të kërkonte një hapësirë më të madhe me një zhvillim prej rreth 7 m në drejtim të qendrës së sallës ku do të duhej të vendosej.

Do të duhej të parashikohej gjithashtu në të njëjtën hapësirë edhe vendi për ekspozimin e pjesëve të tjera të skulpturës (elementë të ciborium-it, pllaka dekorative të fasadës etj) që nuk do të jenë të përfshira në ringritje (anastilozë).

Në këtë mënyrë do të kishim një objekt masiv që është për momentin unikal në Shqipëri dhe dinjitoz për prezantimin e artit, arkitekturës dhe skulpturës bizantine në territorin tonë.

DO NOT COPY

Dr. Elio HOBDARI

DO NOT COPY

PROPOSAL FOR ANASTYLOSIS OF THE TEMPLON IN MEDIEVAL BASILICA OF ST. JOHN (DELVINË)

The medieval Basilica of St. John (10th-11th century) is situated in a low hill, on the west side of the village Blerimas (Shënjan), near Finiq. The basilica was excavated by a team of Insitute of Archaeology of Tirana, between 2001 and 2003. The monument has undergone through several phases, most important of which is the construction of a three naves basilica over an earlier one nave church. Inside the apse is a synthronon which consists of few stone steps (four of which were partially preserved at the time of excavation). The sanctuary and the naos were divided by a templon, in front of which was the solea with closure panels on two sides, which connected the sanctuary with the ambo placed in the center of the nave. The St. John's templon, by its shape, is the same as the other examples known in Byzantine architecture and is the best preserved in its category in the territory of Albania. An anastylosis by re-assembling its component elements and reproduction of missing ones is possible. This templon, (possibly) along with the ambo and solea, would possibly occupy an important place in a future archaeological museum in Saranda.

Archaeological evidence of the templon

The archaeological situation of finding of the component elements did not help to understand something about the position of any element of it. After the destruction of the basilica, the sculptural material was distributed, reused and, possibly, partially taken and displaced from the site. The templon must have survived undergoing modifications. Its hypothetical reconstruction after the preliminary study of the found elements was not difficult, as examples of this type of installation are preserved abroad. As stylobate served the extremes of the western row floor tiles of the sanctuary, which is situated averaged about 10 cm above the central nave floor. The elements are fixed and pegged together by using iron clamps and pins (depending on the position) lead-fixed.

Component elements of the templon and their state of conservation

Uprights are preserved in a considerable number.

Certainly, a part of them belongs to the aisles screen and 2-4 of them (short pilasters) belong to solea. Of course, the finest decorated are thought to belong to the central nave templon. Two capitals of the octagonal uprights, SJ 114 and SR 1174 (inventory numbers), are preserved. Both appear to have been incorporated with the octagonal upright, but at least one of them was special and was pegged with the colonette using an iron pin. The two tiles that close the spaces between the pilasters on both sides of the entrance have the same decor. Above the tiles was placed the handrail. The most suitable handrail to be positioned on the main templon seems one of them, SJ 31, which has a decoration with a symmetry axis, and with a length matching the one of the closure panels. From the epistyle, is preserved one of the three elements, almost complete (SJ 76 + 107) and a small fragment of another element.

The material of the templon components

Uprights are of different marbles, of course reused ones. Some exemplars are of Proconnesian marble. Analyzes are needed to be made in case the restoration of this installation will be undertaken. Both closure panels are of compact, hard and stratified limestone found in the area. The handrail is of Proconnesian marble, while the epistyle elements are of local sandstone.

Proposed restoration

The slabs of the central nave floor that serves as stylobate for the templon should be reproduced where the templon will be mounted, along with portions of the side walls (in practice, two antæ), where the epistyle is to be fixed. Depending on the uprights selected to be included in the templon for restoration, we would have at least 40% of the surface made up of original material. The rest needs to be reproduced. Concerning the integration of preserved elements, it may be used probably a type of marble that is visually similar, if the original marbles would result impossible, expensive of very difficult to provide. Re-assembling of the uprights on the stylobate will be made with metal pins pegged with lead. Similarly, epistyle elements will be pegged by using the original holes (where they are preserved) in the element. However, this could not be enough to guarantee the structure stability and it will be necessary to reinforce it with an iron support structure. Since the templon is proposed to be reconstructed indoor, most likely in front of a parapet wall, is possible to anchor it on the wall in the background. This is also justified by the fact that none of the elements of the structure has decoration on the back.

This idea can also be developed, by seeing the possibility of reconstruction of both solea and ambo, thus completing the whole set of installations of the central nave of the basilica of St. John.

DO NOT COPY

Frederik STAMATI
Ariola PRIFTI

DO NOT COPY

FLAMURI ME TË CILIN U MBULUA ARKIVOLI I ISMAIL QEMALIT GJATË CEREMONISË SË VARRIMIT. PROCESI I KONSERVIMIT PËR RUAJTJEN E JETËGJATËSISË SË TIJ

Më datë 2 dhjetor 2011, në fondin etnografik të Qendrës së Studimeve Albanologjike u zbulua flamuri, me të cilin u varros Ismail Qemali.

Ismail Qemali vdiq në Peruxhia, në hotelin "Brufani" më 26 janar të vitit 1919. Në darkën e 10 shkurtit 1919 luftanija italiane "Alpino" solli në Skelë të Vlorës arkivolin me trupin e balsamosur të Njeriut të Madh.

Në atë kohë, Vlora ndodhej nën pushtimin italian. U vendos që Ismail Qemali të varrosej në Kaninë, në varrezën familjare të familjes Vlora, meqë në qytet nuk kishte mundësi urbanistike. Komanda italiane, që ia kishte frikën rebelimit, urdhëroi që në ceremoni të mos përdorej asnjë flamur shqiptar. Por, Këshilli Bashkiak i Vlorës këmbënguli në përdorimin e simbolit shqiptar. Komanda italiane e kuptoi mirë ultimatumin atdhetar dhe lejoi që gjatë ceremonisë arkivoli të mbulohej me flamurin shqiptar. Dhe ashtu u bë. Arkivoli u mbulua me flamurin e kuq me shqiponjën e zezë. Këtë flamur ia kishte dhuruar Ismail Qemalit Duka i Monpasiesë në mars të vitit 1913 (shih dokumenti 6), kur ai bëri një vizitë në Vlorë. Në ato ditë flamurin e mbante me vete djali i madh i Ismail Qemalit, Et'hem Bej Vlora.

Ceremonia e varrimit u bë më 12 shkurt 1919. Ishte e mërkurë. U mbajtën dy fjalime mbresëlënëse nga Jani Minga dhe nga Qazim Kokoshi. Mbas heshtjes u ekzekutua hymni mbretëror italian. Pastaj, kortezhi i gjatë u nis për në Kaninë. Ishte ora dhjetë. Karroca ku ndodhej arkivoli tërhiqej nga gjashtë kuaj. Anash ecnin me ngadalë dy rreshta ushtarësh. Banda ushtarake ekzekutonte melodinë e përmortshme "Jone" të kompozitorit italian Errico Petrella.

Kortezhi prihej nga dymbëdhjetë kurora që mbaheshin nga "Djelmoshat e Vlorës", të shoqërisë me po këtë emër. Kurorat ishin gjithë lule, si shprehje e nderimit dhe dashurisë nga populli i Vlorës, nga shkollat, nga shoqëria "Djelmoshat e Vlorës" dhe nga gazeta "Kuvendi". Mbas këtyre vinte "Shoqëria djaloshare". Pastaj ecte banda ushtarake që luante marshin funebër. Mbas bandës ushtarake ishin ushtarët e regjimentit 86 dhe reparti i mitralierëve italianë. Mbas këtyre ecte karroca me arkivolin e mbuluar me flamurin e kuq dhe shqiponjën e zezë, e nderuar dhe e ruajtur nga dy rreshta ushtarësh. Mbas karrocës ecte grupi i hoxhallarëve dhe mbas tyre të tre djemtë e Ismail Qemalit. Mbas djemve të Ismail Qemalit ecte gjenerali Settimo Pacentini, kundëradmirali Lrubetti, pas tyre autoritet ushtarake dhe civile të krahinës, paria e qytetit dhe e qarkut, qytetarët, nxënësit e shkollave dhe në fund ushtarët e kavalerisë.

Flamurin e morën djemtë e Ismail Qemalit, të cilin e përdorën përsëri në rivarrimin e tij në "Sheshin e Flamurit" më 28 nëntor 1932. Mbas kësaj, Et'hem Bej Vlora e dhuroi flamurin për Muzeun Kombëtar.

Në Arkivin e Shtetit ruhen disa dokumente që vërtetojnë ngjarjen. Po i paraqesim:

Dokumenti 1: AQSH, fondi 195, viti 1933, dosja 173.

"MBRETNIJA SHQIPTARE
PREFEKTURA MBRETNORE
VLONË

Nr. 172

Vlonë me 21. Kallnuer. 1933

P.T.

Ministris Aresimit

T i r a n e

Kétu ngjitun kemi nderin me Ju paraqite proces-verbalin e mbajtun me rastin e marrjes né dorézim té Flamurit qé ashte ngritun pér té parén here né Vlone, prej Patriotit Ismail Qemalit.

Gjith ashtu né pako te veçanté dhe po me kété shkresé dérgohet edhe Flamuri né fjalé.

Shtojme se me gjith qe Z. Etéhem Vlora pretendon se ky Flamur ashte ngritur pér té parén heré né ndértesén Qeveritare me doren Atit tij, por nga sa kemi hetue ky Flamur ashte ngritur me té vértet me 28 Nanduer 1912, por jo né ndértesén Qeveritare, por né Zyren e doganave né Vlone.

Lutemi me na njoftue marrjen né dorézim.

P r e f e k t i :
Nepravishta"

Shkruar me dorë:
"T'i dërgohet ky flamur Bibliotekës"
Nën këtë shënim, është një tjetër, që konfirmon marrjen e flamurit në dorëzim:
"asht këtu në bibliotekën t'onë"
(firma)
28/10/33
Vijojnë disa vula dhe firma dhe në fund:
"Marrë në dorëzim me 29-X-933".


MBRETNIA SHQIPTARE
PREFEKTURA MBRETNORE
VLONË

Vlonë, me 21. Kallnuer. 1933

Nr. 172

P. T.

Ministris Aresimit

T i r a n e.

Kétu ngjitun kemi nderin me Ju paraqite proces-verbalin e mbajtun me rastin e marrjes né dorézim té Flamurit qé ashte ngritun pér té parén heré né Vlone, prej Patriotit Ismail Qemalit.

Gjith ashtu né pako te veçanté dhe po me kété shkresé dérgohet edhe Flamuri né fjalé.

Shtojme se me gjith qe Z. Etéhem Qemal Vlora pretendon se ky Flamur ashte ngritur pér té parén heré né ndértesén Qeveritare me doren Atit tij, por nga sa kemi hetue ky Flamur ashte ngritur me té vértet me 28 Nanduer 1912, por jo né ndértesén Qeveritare, por né Zyren e Doganave né Vlone.

Lutemi me na njoftue marrjen né dorézim.

P r e f e k t i :
A.Nepravishta

Shkurtim:

T'i dërgohet ky flamur Bibliotekës
A. Këtu në Bibliotekën t'onë
28/10/33.

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

7/4/33.

marrë në dorëzim me 29-X-933

D.Q. Nr. F 195 v 1933 d. 173 f 2

Dokumenti 1: (Sipas orijinalit që ruhet në Arkivin e Shtetit)

Në procesverbalin e mbajtur më 28 Nëntor 1932, me rastin e transferimit të eshtrave të Ismail Qemalit nga Kanina në përmendoren e ngritur në kujtim të tij, Prefekti i Vlorës ia dorëzoi Flamurin e shenjtë Ministrit të Arsimit Shk. tij Z. Hil Mosi, për ta depozituar në Muzeun Kombëtar në Tiranë.

DO NOT COPY

Më poshtë teksti i këtij procesverbali:

"P R O C E S – V E R B A L

Sot mé 28 Nanduer 1932, ditén e Héné, me rrastin e transferimit té eshtravet té shénjtorit té Kombit té ndjerit Ismail Qemalit nga Kanina né Pemendoren kujtimore té ngrehun prej N.M. Tij Mbretit dhe né pranie té Pérfaqesuesit té N.M.Tij Mbretit Shkelqésis sé tij Gjeneral Leon De Gjilardi dhe té shkelqesave té tyne Z.Z. Hil Mosi, Ministér i Arésimit, Milto Tutulani, Ministér i Drejtésis dhe té Prefektit té Vlonés Z. Abedin Nepravishta, zoti Hetem Bej Vlora, i biri i té ndjerit Ismail Qemal pér kujtim Kombétar i dorézoj Prefektit té Vlonés Flamurin Kombétar té cilin mé 28 Nanduer 1912 ati i tij Eroj i Kombit i ndjeri Ismail Qemal e ngriti né qytetin e Vlonés tue prokllamuar indinpendencén e Shqipnisé pas shumé shekuj rrobnije.

Kété Flamur té shenjté Prefekti i Vlonés ja dorézoj Ministrit té Arésimit Shk. tij Z. Hil Mosi pér t'a dépozituar né Muzeun Kombétar né Tirané.

Pér sa ma nalté u redaktua ky Proçes-Verbal i mbajtun né katér kopjo dhe i nénéshkruem prej té gjithéve qe pérménden ma sipér.

Ministri i Arésimit - Hil Mosi
Ministri i Drejtésis - Milto Tutulani
Pérfaqesuesi i N.M.Tij Mbretit - Gjeneral Leon De. Gilardi
I biri i té djerit Ismail Qemal - Etem Vlora"
Prefekti i Vlonés - A. Nepravishta

Në shkresën e mëposhtme (dokumenti 3), të firmosur nga vetë ministri i arsimit Mirash Ivanaj, vërtetohet se flamuri iu dorëzua Muzeut Kombëtar. E citojmë:

Dokumenti: AQSH, fondi 195, viti 1933, dosja 173.

Tiranë më_____193___

" MINISTRI E ARSIMIT
Nr. Prot. 1208.
Dërgohet Flamuri Komtar i ngrehun për herë të parë në Vlonë.
Drejtoris së Muzeut Komtar,
Tiranë

Këtu ngjitun i dërgojmë asajë Drejtorije kopjen e shkresës nr. 172 me d .21 . kallnuer 1933 si dhe kopjen e process-verbalit të mbajtun me 28 Nanduer 1932 mbi flamurin komtar qi asht ngreh për herë të parë nga i ndieri Ismail Qemali në Vlonë.

Për njiherit me këto shkresa ju dërgojmë dhe këtë flamur historik për t'a ruejtun me kujdes në muzeun komtar.

Ministr'i Arsimit - Mirash Ivanaj (firma)
Nisë më 6/XI/1933"


P R O C E S – V E R B A L

Sot mé 28 Nanduer 1932, ditén e Héné, me rrastin e transferimit té eshtravet té shénjtorit té Kombit té ndjerit Ismail Qemalit nga Kanina né Pemendoren kujtimore té ngrehun prej N.M. Tij Mbretit dhe né pranie té Pérfaqesuesit té N.M.Tij Mbretit Shkelqésis sé tij Gjeneral Leon De Gjilardi dhe té shkelqesave té tyne Z.Z. Hil Mosi, Ministér i Arésimit, Milto Tutulani Ministér i Drejtésis dhe té Prefektit té Vlonés Z.Abedin Nepravishta, Zoti Hetem Bej Vlora, i biri i té ndjerit Ismail Qemal pér kujtim Kombétar i dorézoj Prefektit té Vlonés Flamurin Kombétar té cilin mé 28 Nanduer 1912 ati i tij Eroj i Kombit i ndjeri Ismail Qemal e ngriti né qytetin e Vlonés tue prokllamuar indinpendencén e Shqipnisé pas shumé shekuj rrobnije.

Kété Flamur té shenjté Prefekti i Vlonés ja dorézoj Ministrit té Arésimit Shk. tij Z. Hil Mosi pér t'a dépozituar né Muzeun Kombétar né Tirané.

Pér sa ma nalté u redaktua ky Proçes-Verbal i mbajtun né katér kopjo dhe i nénéshkruem prej té gjithéve qe pérménden ma sipér.

Ministri i Arésimit Hil Mosi
Ministri i Drejtésis Milto Tutulani
Pérfaqesuesi i N.M.Tij Mbretit Gjeneral Leon De.Gjilardi
I biri i té djerit Ismail Qemal Etem Vlora
Prefekti i Vlonés A. Nepravishta

A.Q.SH. F. 195 V. 1933 D. 173 fl. 3

Dokumenti 2. Procesverbali shoqërues i Dokumentit 1 (sipas origjinalit që ruhet në Arkivin e Shtetit).

FOTOCOPY



MINISTRI E ARSIMIT

Tiranë më 193

Dega .....

Prot. Nr. .....

SHKURTIM:

1208

Drejtoris së Muzeut Kontar

Tiranë

Dërgohet Flamuri i Kontar i ngrohun për herë të parë në Vlonë.

Këtu ngjitun e i dërgojmë asaj Drejtorije kopjen e shkresës Nr.172 me d.d.Tëllmor 1933 si dhe kopjen e proces-verbalit të mbajtun me 28 Nanduer 1932 mbi flamurin kontar qi esht ngreh për herë të parë nga i ndieri Ismail Qemali në Vlonë.

DREJTIM:

Për njiherit me këto shkresa ju dërgojmë dhe këtë flamur historik për t'a ruejtun me kujdes në muzeun komtar.

Ministr'i Arsimit:

Koncept:
Lidhje: 3.-

Përshk:

Shqyrt:

Lidhje

Nisë më 6/XI/1933

A.Q.SH. F. 195 V. 1933 D. 173 fl. 1

Dokumenti 3. (sipas origjinalit që ruhet në Arkivin e Shtetit).

Ndërsa, më poshtë është dokumenti (dokumenti 4) që vërteton marrjen në dorëzim të flamurit nga Muzeu Kombëtar:

"M.A.
Nri 402/749
Flamuri i Vlorësë

Mënistërijës' së Arësimitë

Q y t e t

Bashkë me shkresën' Nri 1208 të së 6s' së këtij muaji, të shoqëruarë me verbalin' e endur'në Vlorë më 28 të Vjeshtës' së Tretë 1932. Muarëm' në dorëim:

Flamurin' kombëtar që shtolli në Vlorë vetë Ismail Qemal Vlora, mbë 28 të Vjeshtës së Tretë 1912.

Ky flamur zu vëndin' në rjeshtën' e kujtimevet' t' tjerë, me vlejë të jëstorijëtë, që ruhen' në Tiranë, 9 Vjesht' e Tretë 1933.

Drejtori (Firma dhe vula)

Ngjitur' pas kësaj' dorë-dëftesa e jonë Nri C. 208



M.A.
Nri 402/749
Flamuri i Vlorësë.

Mënistërijës' së Arësimitë

Q y t e t

Bashkë me shkresën' Nri 1208 të së 6s' së këtij muaji, të shoqëruarë me verbalin' e endur' në Vlorë, mbë 28 të Vjeshtës' së Tretë 1932, muarëm' në dorëzim:
Flamurin' kombëtar që shtolli në Vlorë vetë Ismail Qema
Vlora, mbë 28 të Vjeshtës' së Tretë 1912.
Ky flamur zu vëndin' në rjeshtën' e kujti
mevet' t' jerë, me vlejë të jëstorijëtë, që ruhen' në
Muzejën' Kombëtare.
Tiranë, 9 Vjesht' e Tretë 1933 Drejtori

Ngjitur' pas kësaj' dorë-dëftesa
e jonë Nri C.208

MBRETNIJA SHQIPTARE
MINISTRIJA E ARSIMIT
Nr. 1208/1
Dos

10/11/33.

98-XI-933

A.Q.SH. F. 195 V. 1933 D. 173 fl. 4

Dokumenti 4. (sipas origjinalit që ruhet në Arkivin e Shtetit).

DO NOT COPY

Kështu, në bazë të këtij dokumenti, Shqipëria u bë me flamur kombëtar. Por, shumë mohime iu bënë këtij fakti të servirur nga dëshmitarët e atyre ngjarjeve, që detyruan autoritetet e kohës të bënin verifikime të shumta, për të sqaruar të vërtetën. U desh kohë që ngatërresa të shpështillej, por kjo është çështje që nuk lidhet me këtë shkrim, aq më tepër që është sqaruar.

Vijojmë të paraqesim dokumente të tjerë që shkojnë më pranë të vërtetës.
(Dokumenti Rezervat M. A. - teksti)

Më datë 18 shkurt 1936, Muzeu Kombëtar i dërgoi Ministrisë së Arësimit një shkresë, e cila vuloset dy herë si "rezervate".
"REZERVATË A. A.
Të ruhet
N= 113
d. 19 – II – 936
REZERVATE
M. A.
Nri 544/988
Për flamurin' e Vlorësë.

Mënistërijës' së Arësimitë
Q y t e t

Për t' uruajtur' në dozarin' e " Flamurit' të Vlorësë ", të ormitur' prej kohe pranë së Shkëlq. Mënistërijë, kemi nderin' të përsjellim' sot:

1) Një verbal për sa pati mirësijën' të na thotë Zoti Ethem Bej Vlora mbi punën' e flamurit' që valoi i pari në Vlorë, ditën' e 28s' së Vjeshtës' së Tretë 1912.

2) Një verbal për hollësijat' që Zoti Et-hem Bej Vlora pati mirësijën' të na apinj' për flamurin' që fali vetë dhe që i ka qënë dorëzuarë Muzejës' Kombëtare në Vjeshtë të Tretë 1933.

Duarët' të dyta të këtyre verbaleve janë ruajtur' dhe në dozarin' e Muzejës' s'ënë.
Tiranë, 18 Shkurt 1936.

Drejtori (Firma dhe vula)

Më poshtë:
(Dokumenti Rezervat M. A)
(sipas origjinalit që ruhet në Arkivin e Shtetit)


REZERVATË

M. A.
Nri 544/988
Për flamurin' e Vlorësë.

N= 113
d. 19-II-936
REZERVATE

Mënistërijës' së Arësimitë

Q y t e t

Për t' uruajtur' në dozarin' e " Flamurit' të Vlorësë ", të ormitur' prej kohe pranë së Shkëlq. Mënistërijë, kemi nderin' të përsjellim' sot:

1) një verbal për sa pati mirësijën' të na thotë Zoti Et-hem Bej Vlora mbi punën' e flamurit' që valoj i pari në Vlorë, ditën' e 28s' së Vjeshtës' së Tretë 1912.

2) një verbal për hollësijat' që Zoti Et-hem Bej Vlora pa mirësijën' të na apinj' për flamurin' që fali vehtë dh që i ka qënë dorëzuarë Muzejës' Kombëtare në Vjeshtë t Tretë 1933.

Duarët' të dyta të këtyre verbaleve janë ruajtur' dhe në dozarin' e Muzejës' s' ënë.

Tiranë, 18 Shkurt 1936

Drejtori

A.Q.SH. F. 195 V. 1936 D. 62 fl. 1

Dokumenti Rezervat M. A

Bashkëngjitur u dërguan edhe dy shkresat e mëposhtme:
Shkresa 1. (dokumenti 5 - tekst):
Dokumenti: AQSH, Fondi 195, viti 1936, dosja 62.

"Flamuri i Vlorësë

Për punën, e flamurit' kombëtar që valoj në Vlorë për herë të pare ditën' e të lëçiturit' të Shqipërijsë mbë krye të vehtë, Zoti Et-hem Bej Vlora, bir i të ndjerit Iamail Qemal Bej Vlora, pati mirësijën' të shtronjë këta kujtime:

1) flamuri upat nga shtëpija e Zotit' Syreja Bej Vlora. (Shënim nga autorët e shkrimit: fjalët, "nga shtëpija e Zotit' Syreja Bej Vlora", janë të shuara me një vijë përsipër).

2) pëlhura e flamurit' qe e leshtë dhe shkaba e shtampuarë; nuk' mban në mënt të ketë pasur' theka o kravatë.

DO NOT COPY

3) të madhët' të tijë, gjer sa mund të caktohet' me të maturë syri, munt të qe afëro 0 m. 80 për së gjati, dhe 0 m. 50 për së gjëri.

Sa për fundin' e këtij' flamuri Zoti Et-hem Bej Vlora ësht' i mejtimit' se flamuri nuk' ka qënë shdukurë, po se ndodhet' i ruajturë në Shqipërijë, ndër duar' që do të kujtohen' ndofta ndonjë ditë t'i a falin' Muzejës' Kombëtare.

Tiranë, 10 shkurt 1936"

Më poshtë, në të majtë, është vula e Bibliotekës dhe Muzeut Kombëtar, si dhe firma, ndërsa në të djathtë, firma e Ethem Bej Vlorës. Poshtë ka një shënim:

a) Zoti Et-hem Bej Vlora ndreqi me dorën' e vehtë: "nga shtëpija e Zotit' Xhemil Bej Vlora".


Flamuri i Vlorësë.

Për punën' e flamurit' kombëtar që valoj në Vlorë
për herë të parë ditën' e të lëçiturit' të Shqipërijësë
mbë krye të vehtë, Zoti Et-hem Bej Vlora, bir i të ndjeri
Ismail Qemal Bej Vlora, pati mirësijën' të shtronjë këta
kujtime:
(a) 1) flamuri upat nga shtëpija e Zotit' Xyreja Bej Vlora.
2) pëlhuara e flamurit' qe e leshtë dhe shkaba e shtampu-
arë, nuk' mban në mënt të ketë pasur' theka o kravatë
3) të madhët' të tijë, gjer sa munt të caktohet' me të ma
durë syri, munt të qe afëro 0 m. 80 për së gjati, dhe
0 m. 50 për së gjëri.

Sa për fundin' e këtij' flamuri Zoti Et-hem Bej
Vlora ësht' i mejtimit' se flamuri nuk' ka qënë shdukurë,
po se ndodhet' i ruajturë në Shqipërijë, ndër duar' që do
të kujtohen' ndofta ndonjë ditë t' i a falin' Muzejës' Kom
bëtare.
Tiranë, 10 Shkurt 1936

(a) Zoti Et-hem Bej Vlora ndreqi me dorën' e vehtë:
" nga shtëpija e Zotit' Xhemil Bej Vlora ".

A.Q.SH. F. 195 V. 1936 D. 62 fl. 2

Dokumenti 5. (sipas origjinalit që ruhet në Arkivin e Shtetit).

Shkresa 2. (dokumenti 6 - tekst):
Dokumenti: AQSH, fondi 195, viti 1936, dosja 62. Po e citojmë:

"Flamuri i Doganës' së Vlorësë.

Me shkresën' e Mënistërijës' së Arësimitë Nri 1208 të së 6s' së Vjeshtës' së Tretë 1933, i udorëzua Muzejës' Kombëtare një flamur i trajtuarë prej dy fijesh pëlhure të leshtë, 1 m. 45 i gjatë dhe 0 m. 95 i gjërë, me shkabën', me dy krerë dhe me krahë të shtallurë mbë të përpjetë, pa theka dhe pa kravatë.

Pas shkresës' që i përsillte Muzejës' Kombëare këtë flamurë, janë mpështeturë:

1) një verbal me ditë 28 të Vjeshtës ' së Tretë 1932, në të cilin' kan' vënë duarëtë:
Përfaqësi i L. Madhërijës' së Tijë Mbëretitë, Gjeneral Leon de Ghilardi,
Ministri i Arësimitë, Hil Mosi,
Ministri i Drejtësijësë, Milto Tutulani,
Zoti Et-hem bej Vlora, përfaqësi i Fëmijës' së të ndjerit' Ismail Qemal Beutë,
Prefekti i Vlorësë, A. Nepravishta.

Në këtë verbal është shënuarë se flamuri i dhuruarë Muzejës' Kombëtare është muu ay që pati ngriturë në Vlorë me dorën' e vehtë i ndjeri Ismail Qemal Beu, të 28në të Vjeshtës' së tretë 1912.

2) një shkresë e Prefekturës' së Vlorësë, Nri 172 me ditë 21 Jenar 1933, në të cilën', ndër t' jera, është shënuarë se si pas kërkim' -e hetimeve të bërë nga Prefektura e Vlorësë, ky flamur nuk' ka qënë ngritur' kurrë mbi ndërtesën' qëverritare as ditën' që ulëçit të krye-mbë-vehtët' të Shqipërijësë as mëë pas, po ka valuarë vetëmë për një kohë të gjatë mbi godinën' e Doganës' së detitë të Vlorësë.

Për të kthillurë këtë pikë ukërkuanë hollësija nga Zoti Et-hem Bej Vlora, i cili pati mirësijën' të apinj' këta shënime:

1) flamurin' që i u dorëzua Muzejës' Kombëtare, i a fali të ndjerit' Ismail Qemal Beutë Duku i Monpansierit', kur pat' ardhurë në Vlorë, nga Marsi i vitit' 1913.

DO NOT COPY

2) qëverrija e Shqipërijësë e përdori për Doganën' e Vlorësë, mbi ndërtesën' e së cilësë valoj gjer ditën' që Ismail Qemal Beu hoqi dorë nga Kryesija e Qëverrijësë.

3) mbë t' ularguarë nga Vlora Ismail Qemal Beu, kërkoj të ketë si kujtim një nga flamuret' të Qëverrijësë; usgjoth ky flamur dhe i udorëua Zotit' Et-hem Bej Vlora, i cili e pati me vehte gjatë kohës' që bashkë me t' anë undodhën' ndëpër Evropë.

4) ditën' që i ndjeri Ismail Qemal Vlora ndërroj jetë në Perrugjë të Italjësë (25 Jenar 1919) Zoti Et-hem Bej Vlora mbuloj trupin' e t'et me këtë flamur.

5) kur upru i vdekuri në Vlorë dhe uvendos në sallën' e fllugërijës' së përmortëshme, që pati navaturë Kumanda e Ushtërijës' Italjane, prapë ky flamur under mbi arqivolin' e të vdekuritë.

6) gjatë përsjellës' së trupitë nga Vlora në Kaninë, arqivoli qe mbuluarë me po këtë flamur.

7) edhe ditën' që eshtërat' të të ndjerit' Ismail Qemal Beutë umbartën' nga Kanina në Vlorë, për t' ukallurë në varrin'-monoment, që ngrehu Qëverrija Mbëretërore e Shqipërijësë, ky flamur qe nderur' mbi arqivolin' edhe gjatë rrugësë edhe gjer sa mori funt shërbesa e të kalluritë, pas së cilësë Zoti Et-hem Bej Vlora u a dorëzoj Përfaqësvet' të Qëverrijësë Mbëretërore, si kujtim për t' uruajtur' në Muzejën' Kombëtare.

Tiranë, 10 Shkurt 1936"

Më poshtë, majtas, është firma dhe vula e Bibliotekës dhe Muzeut Kombëtar, ndërsa djathtas firma e Et-hem Bej Vlorës.

Në vitin 1947, materialet e Muzeut Kombëtar i kaluan Institutit të Shkencave. Në vitin 1957, kur u krijua Universiteti i Tiranës, mori jetë edhe Instituti i Histori-Gjuhësisë, i cili pati në vartësi të vet edhe Muzeun Arkeologjik-Etnografik, si edhe fondin etnografik. Në këtë fond kaluan edhe flamujt, që ndodheshin dikur në Bibliotekën dhe Muzeun Kombëtar. Mirëpo, nuk pati asnjë dokument për historinë e tyre. Kështu, ata mbetën enigmë. Edhe i ndjeri Rrok Zojsi, themeluesi dhe shefi i etnografisë dhe i fondit etnografik, e kishte me të dëgjuar se dikush i kishte dorëzuar flamujt, pa dhënë ndonjë sqarim për ta. Ai kish thënë: merrini dhe ruajini edhe këta!



Flamuri i Doganës' së Vlorësë.

Me shkresën' e Mënistërijës' së Arësimitë Nri 1208 të së 6ës' së Vjeshtës' së Tretë 1933, i udorëzua Muzejës' Kombëtare një flamur i trajtuarë prej dy fijesh pëlhure të leshtë, 1 m. 45 i gjatë dhe 0 m. 95 i gjërë, me shkabën', me dy krerë dhe me krahë të shtallurë mbë të përpjetë, të shtampuarë me njgjyrë të zezë mbi lëmën' e kuqe të pëlhurësë, pa theka dhe pa kravatë.

Pas shkresës', që i përsillte Muzejës' Kombëtare këtë flamurë, janë mpështeturë:

1) një verbal me ditë 28 të Vjeshtës' së Tretë 1932, në të cilin' kan' vënë duarëtë:
Përfaqësi i L. Madhërijës' së Tijë Mbëretitë, Gjeneral Leon de Ghilardi,
Ministri i Arësimitë, Hil Mosi,
Ministri i Drejtësijësë, Milto Tutulani,
Zoti Et-hem Bej Vlora, përfaqësi i Fëmijës' së të ndjerit' Ismail Qemal Beutë,
Prefekti i Vlorësë, A. Nepravishta.
Në këtë verbal është shënuarë se flamuri i dhuruarë Muzejës' Kombëtare është muu ay që pati ngriturë në Vlorë me dorën' e vehtë i ndjeri Ismail Qemal Beu, të 28në të Vjeshtës' së Tretë 1912.

2) një shkresë e Prefekturës' së Vlorësë, Nri 172 me ditë 21 Jenar 1933, në të cilën', ndër t' jera, është shënuarë se si pas kërkim' e hetimeve të bërë nga Prefektura e Vlorësë, ky flamur nuk' ka qënë ngritur' kurrë mbi ndërtesën' qëverritare as ditën' që ulëgit të krye-mbë-vehtët' të Shqipërijësë as më pas, po ka valuarë vetëmë për një kohë të gjatë mbi godinën' e Doganës' së detitë të Vlorësë.

Për të kthillurë këtë pikë ukërkuanë hollësija nga Zoti Et-hem Bej Vlora, i cili pati mirësijën' të apinj' këta shënime:

1) flamurin', që i udorëzua Muzejës' Kombëtare, i a fali të ndjerit' Ismail Qemal Beutë Dukn i Monpansierit', kur pat' ardhurë në Vlorë, nga Marsi i vitit' 1913.

2) qëverrija e Shqipërijësë e përdori për Doganën' e Vlorësë, mbi ndërtesën' e së cilësë valoj gjer ditën' që Ismail Qemal Beu hoqi dorë nga Kryesija e Qëverrijësë.

3) mbë t' ularguarë nga Vlora Ismail Qemal Beu, kërkoj të ketë si kujtim një nga flamuret' të Qëverrijësë; usgjoth ky flamur dhe i udorëzua Zotit' Et-hem Bej Vlora, i cili e pati me vehte gjatë kohës' që bashkë me t' anë undodhën' ndëpër Evropë.

4) ditën' që i ndjeri Ismail Qemal Vlora ndërroj jetë në Perrugjë të Italjësë (25 Jenar 1919) Zoti Et-hem Bej Vlora mbuloj trupin' e t' et me këtë flamur.

5) kur upru i vdekuri në Vlorë dhe uvendos në sallën' e fllugërijës' së përmortëshme, që pati navaturë Kumanda e Ushtërijës' Italjane, prapë ky flamur under mbi arqivolin' e të vdekuritë.

6) gjatë përsjellës' së trupitë nga Vlora në Kaninë, arqivoli qe mbuluarë me po këtë flamur.

7) edhe ditën' që eshtërat' të të ndjerit' Ismail Qemal Beutë umbartën' nga Kanina në Vlorë, për t' ukallurë në varrin'-monoment, që ngrehu Qëverrija Mbëretërore e Shqipërijësë, ky flamur qe nderur' mbi arqivolin' edhe gjatë rrugësë edhe gjer sa mori funt shërbesa e të kalluritë, pas së cilësë Zoti Et-hem Bej Vlora u a dorëzoj Përfaqësvet' të Qëverrijësë Mbëretërore, si kujtim për t' uruajtur' në Muzejën' Kombëtare.

Tiranë, 10 Shkurt 1936

A.Q.Sh. F 185 V 1936 Vl. 62 f 3

Dokumenti 6 (sipas origjinalit që ruhet në Arkivin e Shtetit).

Puna për identifikimin e tyre filloi shumë vjet më parë. Më 2 dhjetor 2011 i erdhi radha këtij flamuri.

Flamuri ishtë i plotë, por kishte dëmtime të shumta. Ngjyra e kuqe ishte zbehur nga veprimi i diellit. Agjentët atmosferikë e kishin ndotur dhe kishin lënë gjurmë. Duhej restauruar. Dhe do të ishte një punë jo e lehtë në gjendjen që kishte flamuri!

U vendos të restaurohej dhe procesi i restaurimi duhet të fillonte me procesin e larjes.

Pse u mor një vendim i tillë?

Mendimi i parë dhe ndjesia e parë, kur identifikuam flamurin me të cilin u mbulua trupi i Ismail Qemalit kur

DO NOT COPY

ai vdiq, ishte që të ruhej prekja e fundit e tij mbi flamur. Le të mbetej në përjetësi! Ndjenjë e pavullnetshme e ekzaltimit shpirtëror!

Por, këto ishin thjesht mendimi i parë dhe ndjesia e parë. Gjatë një viti të tërë u ndeshën në mendjen time (F. S.) dy përbindësha, ai nostalgjik dhe ai i detyrës së ruajtjes fizike të vetë objektit. Ja që natyra e ka ndërtuar lëndën pa shpirt dhe ajo do t'i nënshtrohet proceseve të detyrueshme të degradimit. Detyra jonë është që ta ndalonin këtë proces, ose ta ngadalësonim sa më shumë.

Sipas raportit të datës 31 mars 1913, të konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec, për ministrin e Punëve të Jashtme, kontin Berchold, Duka i Monpensies ia dhuroi flamurin Ismail Qemalit me 29 mars të vitit 1913. Po atë mbasdite, apo me 30 mars, flamuri u ngrit në shtizën e oborrit të ndërtesës së Doganës në Skelë të Vlorës. Ai flamur qëndroi dhe u valavit në shtizë, deri kur Ismail Qemali dha dorëheqjen me 22 janar 1914. Kur do të largohej nga Shqipëria Ismail Qemali kërkoi të merrte si kujtim nga Shqipëria një flamur historik dhe si kujtim iu dha pikërisht ky flamur. Flamuri u ul ngadalë nga shtiza me litarin që e ngrinte dhe që u pre, duke mbetur pjesë e përhershme e dhuratës.

Pra flamuri qëndroi i ekspozuar në dritën natyrale për gati dhjetë muaj. Gjithashtu ai u valavit në bregdet, i rrahur nga erërat detare.

Që në këto momente ka filluar dëmtimi fizik, kimik dhe fotokimik i flamurit.

Flamuri është kompozuar në një pëlhurë të leshtë. Për të parë gjendjen e fibrave, jo ajo që duket me sy, por me aparatura të zmadhimit të madh, iu drejtuam miqve në universitetin e Ljubljanës. U përdor SEM, (Scaning Electron Microscopy), e cila tregoi realen përtej mundësive të syrit dhe dha disa tregues mbi elementët kimikë. (Foto 1)

Analizat e llojit të ngjyruesit të kuq të përdorur për ngjyrim nuk janë kryer, sepse nuk mund të bëhen në Shqipëri: ato duan laboratorë të specializuar dhe shumë të kushtueshëm. Por, të dish se çfarë ngjyruesi është përdorur, do të thotë që të kuptosh më mirë



Foto 1. Dëmtimi nga mikroorganizmat.

proceset nëpër të cilat ka kaluar objekti dhe se çfarë masash duhet të marrësh, për ta ruajtur sa më mirë atë. Sidoqoftë, ne mund të gjykojmë deri diku bazuar në teknologjitë e përdorura në ato kohë, për ngjyrimin e tekstileve. Natyrisht, që gjykimi nuk mund të përdoret për citim në këtë fazë të dijes.

Mund të jetë e mundur që të jetë përdorur një ngjyrues natyral me bazë antrakinonin, ndoshta nga bima Rubbia tinctorum, që botanistët tanë e quajnë rrëza ngjyruese. Analizat me anë të SEM treguan praninë e zinkut dhe të kalciumit. Mos vallë kalciumi vjen nga ndotja. ndërsa zinku është përdorur si mordant, pra si një lidhës midis ngjyruesit dhe fibrës? Kjo gjë, jo vetëm që i jep më shumë forcë ngjyrës, por e bën edhe më të qëndrueshme ndaj dritës. Dhe vërtet, flamuri e ruan mirë ngjyrën e kuqe, por që gjithsesi kjo është relative, sepse ne nuk e dimë pamjen e parë origjinale. Problem është prania e kalçiumit. Ai ka ndikim negativ në qëndrueshmëninë e ngjyrës. Do ta analizojmë më poshtë.

Në fotografitë e marra dallohet shumë mirë papastërtia mbi fibra. (Foto 2). Kjo vjen nga pluhurat dhe ka mundësi edhe nga dherat, të cilat e kanë shoqëruar flamurin gjatë udhëtimit të tij historik.

Pluhurat e të gjitha llojeve kanë një ndikim negativ të madh në tekstile. Aspekti estetik është njëra anë dhe më e thjeshta. Pluhurat janë edhe kristalinë dhe cepat e kristaleve në këtë rast punojnë si tehe, që me kohë i dëmtojnë fibrat, deri në këputje. Në vartësi të përbërjes kimike ata thithin lagështinë nga atmosfera

DO NOT COPY



Foto 2. Papastërtia në flamur

dhe ia kalojnë këtë lagështi tekstilit. Bymimi dhe tkurrja në vartësi të lagështisë relative do të punojë për dëmtimin e mëtejshëm të fibrave. Por jo vetëm kaq. Në ujin e lagështisë treten ndotësat atmosferikë, acide, etj. dhe kjo masë tashmë kimike, i kalon fibrave, të cilat i nënshtrohen dëmtimit kimik. Gjithashtu, lagështia që i transmetohet fibrave, sidomos kur është i pranishëm edhe kalçiumi, bën që elektronet π, (pi), të jenë më të lëvizshën në vargun e konjuguar dhe të shkaktojnë dëmtimin e ngjyrës. Tekstilet e pluhurosura zbehen me shpejt nga drita. Tekstilet në muzeume nuk lahen me ujë çesmeje, por me ujë të demineralizuar, pa përmbajtje kalçiumi dhe magnezi. Por, lagështia e formuar nga pluhurat rrit edhe mundësinë e veprimit të bakterieve mbi fibrat e tekstilit dhe një veprim të tillë shkatërrues e dallojmë vende-vende në rastin e flamurit për të cilin po shkruajmë.

Ndërtesa e Doganës së Vlorës ndodhej pranë detit. Erërat e forta bregdetare e kanë shqyer në një vend. Po ka edhe diçka tjetër. Erërat rrëmbejnë nga kreshtat e valëve cikla uji, të cilat kanë në përmbajtjen e tyre kripën e detit. Është parë se këto cikla shkojnë deri në njëmijë e gjashtëqind metra përtej bregut. Kripa ka një veprim tejet negativ në tekstile, sepse i brishtëzon fibrat, duke i bërë të thyeshme. Dhe flamuri e ka një farë brishtësie të parikthyeshme, e cila do të përparojë nga prania e kripës.

Vura në peshoren e llogjikës ndjenjën, që do të mbetej e çastit dhe jetëgjatësinë që vjen nga konservimi dhe kjo e dyta fitoi.

Procesi i larjes dhe konservimit të Flamurit u realizua me sukses, duke përdorur banjën standard të pastrimit të njomë, në bazë të recetave që rekomandon British Museum.

Flamuri u gjallërua, por mbi të gjitha u larguan dëmtuesit që ndodheshin në të.

Tashmë, Flamuri është i sigurtë dhe ruhet brenda parametrave të konservimit muzeal.

DO NOT COPY

monumentet
57/2018

Frederik STAMATI
Ariola PRIFTI

DO NOT COPY

THE FLAG WITH WHICH ISMAIL QEMALI'S COFFIN WAS COVERED DURING THE BURIAL CEREMONY. CONSERVATION PROCESS TO PRESERVE ITS LIFESPAN

On December 2, 2011, in the ethnographic fund of the Center for Albanological Studies was discovered the flag, which covered the body of Ismail Qemali during the day of the burial ceremoni.

Ismail Qemali died on January 26, 1919, in the "Brufani" hotel, city of Perugia, Italy.

Late at the night of February 10, 1919, the Italian warship "Alpino" brought the coffin with the embalmed body of the great man to Skela-Vlora.

At that time Vlora was under the Italian occupation. It was decided for Ismail Qemali to be buried in Kanina, at the family Vlora cemetery.

The Italian Command, fearing the rebellion, ordered not to use the Albanian flag during the burial ceremony. But, the municipal council of Vlora insisted to use the Albanian symbol. The Italian command was well aware of the patriotic ultimatum and allowed the coffin to be covered with the Albanian flag during the ceremony. And so it was. The coffin was covered with the red flag and the black eagle.

This flag was donated to Ismail Qemali by the Duke of Monpazier in March 1913, when he visited the city of Vlora.

Et'hem Bey Vlora the great son of Ismail Qemali was the banner of this flag during those days.

The funeral ceremony took place on February 12, 1919.

The flag used during the ceremony was taken by the sons of Ismail Qemali and was used again in his reburial at the "Flag Square" in Vlora, on 28 November 1932. After that, Et'hem Bey Vlora donated the flag to the National Museum.

In 1946, the materials of the National Museum were all transfered to the Institute of Science. In 1957, the year when the University of Tirana was founded, the Institute of History and Linguistics was created too. This Institute had its own archaeological-ethnographic museum as well as the ethnographic fund.

The flags that were once in the Library and the National Museum became part of this fund.

But there was no document for their story. Thus, they remained unidentified. Even the late Rrok Zojsi, the founder and head of the Ethnographic Institute and fund, had heard that someone had delivered the flags without giving any clarification about them, just saying:

"take them and keep them!"

The flag is complete, but damaged a lot. The red color is faded, because of the sun action.

Washing the flag was necessary!

For this process, wet cleaning baths, based on recipes recommended by the British Museum were used. The Flag was revived again, but above all, the pests in it were already gone.

Now, The Flag is safe and kept within museum conservation parameters.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Msc. Erilda SELAJ

DO NOT COPY

KONSERVIMI DHE KONSIDERATA RRETH NJË KUTIE LIPSANESH TË ARTIT POST-BIZANTIN

Kontekst i shkurtër historik

Viti 2016 përkoi me 1000 vjetorin e vdekjes së Shën Gjon Vladimirit[1]. Muzeu Historik Kombëtar në vitin 2014 vendosi të fillojë përgatitjet për të organizuar një ekspozitë duke u nisur nga numri i konsiderueshëm i objekteve në fondet e tij. Një pjesë e mirë e objekteve ishin artifakte argjendi që lidheshin me kultin e Shenjtit. Fatkeqësisht, në pasaportat e objekteve, informacioni është tepër i cunguar dhe mungon informacioni mbi prejardhjen e tyre.

Reliket e Shën Gjon Vladimirit janë lëvizur në objekte të ndryshme kulti përgjatë shekujve. Objekti në fjalë është një kuti argjendi me dekor të pasur. Në vitin 1967, regjimi i kohës vendosi ndalimin e të gjithë besimeve fetare. Mijëra objekte kulti u mbyllën dhe shumë të tjerë u shkatërruan përgjithmonë. Lipsanet e Shën Gjon Vladimirit u lëvizën nga kisha ku ndodheshin dhe u depozituan në fondin e Institutit të Monumenteve të Kulturës. Nga ky institucion ato do të depozitoheshin në vitet '90 në Muzeun Historik Kombëtar, ku gjenden dhe sot, por do të bëheshin zyrtarisht pjesë e koleksionit të muzeut në vitin 2004. Kutia e lipsaneve me nr. inv. 5707 së bashku me objekte të tjera që lidhen me kultin e Shenjtit, që në momentin e vendosjes në muze, ka qenë pjesë e fondit të artit mesjetar ose i quajtur ndryshe, fondi i ikonave. Janë kryer ndërhyrje konservimi dhe janë bërë hulumtime në 9 objekte të kultit të Shën Gjon Vladimirit, por në këtë artikull do të trajtojmë rastin e objektit nr. inv. 5707 i emërtuar: "Kuti me kocka Shenjtori".

Përshkrimi i objektit dhe të dhëna të reja rreth tij

Kutia e lipsanave ka formë oktagonale, është argjendi (Ag) dhe ka përmasa 19 cm x 13 cm x 8 cm. Ajo është e dekoruar në kapak dhe në të gjithë faqet anësore me motive të ndryshme, kryesisht floreale. Kapaku ka po formë oktagonale dhe është i harkuar. Poshtë kapakut, në pjesën e sipërme të kutisë ndodhen një fletë argjendi me formë gjithashtu oktagonale në të janë hapur dy fole që përvijojnë formën e fragmeteve

[1] Shën Gjon Vladimiri jetoi në shek X-XI. Ai ishte princi dhe më pas udhëheqësi i rajonit jugor të Malit të zi sot. I njohur për përpjekjet e tij për përhapjen e krishtërimit në rajonin e Malit të Zi, Shqipërisë dhe Maqedonisë e më gjerë. U vra me tradhti në maj 1016. Shih: Selaj, E., "Konservimi i kutisë së relikeve të Shën Gjon Vladimirit", Studime Muzeologjike nr. 5, 2015, f. 71-72. Për zhvillimin e kultit të Sh. Gjon Vladimirit shih: Bryer, A., "Kultet e tre shenjtorëve martirë në Shqipëri", 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri, 2003, f. 54-55.

të eshtrave. Në këto fole qëndrojnë eshtrat dhe në sipërfaqen midis dy eshtrave ndodhet një kryq i larë me ar[2]. Njëra është fragment i marrë nga brinjët, ndërsa tjetra është fragment kocke fyellore, që mendohet të jetë marrë nga femuri.

Në qendër të kapakut është kompozuar figura e Shenjtorit e cila rrethohet me një kornizë, në këndet e së cilës janë kompozuar katër ëngjëj. Hapsira kompozicionale jashtë kornizës është trajtuar me motive floreale, format e lakuara të të cilave harmonizohen në tërësinë e tyre. Brenda kornizës, në qendër të kapakut është kompozuar Shenjti.

Ikonografia e Shenjtit përdorur në kompozimin e objektit është shumë e ngjashme me gravurën e Hristofor Žefarović, 1741 (Fig.1). Në këtë gravurë Shenjti paraqitet në kompozimin figurë e plotë, duke qëndruar në këmbë në njërën dorë mban kokën e tij, ndërsa në tjetrën kryqin dhe palmën e parajsës. Ky kompozim do të marrë një përdorim të gjerë në pasqyrimin e Shenjtit në shekujt e ardhshëm[3].

Shën Gjon Vladimiri paraqitet në këmbë e mban në kokë kurorën mbretërore. Pas supeve ka hedhur një pelerinë të gjatë, e cila është e dekoruar me motive floreale.

Në dorën e majtë mban kokën e prerë, ndërsa në dorën e djathtë mban kryqin dhe palmën e parajsës. Në këmbët e Shenjtit gjendet shpata, që i ka prerë kokën. Mbi kuti është shkruar në greqishten bizantine "**Ο Αγιος Ιωανης ο Βλαδιμηρος**" e shqipëruar "Shën Gjon Vladimiri".



Fig. 1. Gravurë e Shën Gjon Vladimirit, Hristofor Žefarović, 1741 Stemmatographia[4]

Kutia është dekoruar me motive floreale dhe zoomorfe në pjesën e sipërme ndërsa në faqet anësore me motive floreale. Në qendër të dy faqeve ballore paraqitet kupa e kungimit, e mbuluar me lule shege, ndërsa në pjesën e sipërme dhe anësore në faqeve janë kompozuar motive floreale që përbëhen nga gjethe, lule dhe kërcenj të lakuar, trajtuar në mënyrë mjaft melodike e dinamike. Faqet anësore të kutisë janë zbukuruar me motive floreale, që gërshetohen me njëra-tjetrën në mënyrë ritmike, duke përpjekur të respektojë një rend të përsëritur e simetrik.

[2] Eshtrat mbahen të fiksuara në fole, me anë të disa kapseve të lugëta që ndodhen në anën e brendshme të fletës.

[3] Portretizimi më i hershëm i Shenjtit daton në1690, Akolouthia St. John Vladimir, botuar në Venecia, ku ai paraqitet në kompozimin portret me duar, por këto dy tipe ikonografie nuk janë të vetmet, më vonë Shenjti do të paraqitet kompozim ekuestro (kalorësi mbi kalë) si dhe në kompozimin, Shenjti i ulur në fron. Shih: Giakoumis, K., "An Unpublished Icon of St. John Vladimir and a Typological Classification of the Saint's Imagery", Church Studies 2016, v. 13, f. 169-208.

[4] https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Saint_Jovan_Vladimir_(Stemmatographia).jpg

DO NOT COPY

Shkëmbimet e shumta tregtare midis qyteteve të ndryshme nën perandorinë osmane dhe atyre europiane sollën dhe shkëmbime kulturore, duke sjellë në shekullin e XVIII (1740) frymën e barokut në perandorinë osmane e cila do të shpërndahej nga qendra e saj, Kostantinopoja, drejt periferisë. Ky stil do të pagëzohet me emrin baroku otoman dhe do të influencojë jo vetëm artin religjioz, por dhe atë laik në thuajse gjithë territorin e perandorisë. Kjo influencë e stilit barok të kohës vërehet në tërësinë e stilizimit të motiveve floreale dhe na ndihmon në datimin e objektit rreth 1800.

Dy ekstremitetet e kockës fyellore janë mbuluar me kapak argjendi që shërben në këtë kontekst për të mbrojtur ekstremitetet e eshtrës. Të dy kapakët janë lidhur ndërmjet tyre me zinxhir argjendi në njërën anë. Kapakët i përshtaten formës së sipërfaqes së ekstremiteteve kockore. Kështu, këllëfi i skajit të poshtëm ka një formë thuajse trekëndore, ndërsa këllëfi i sipërm ka formë vezake. Pas pastrimit të kujdesshëm të dy këllëfëve, në atë të sipërm doli në pah një mbishkrim në greqishten bizantine "**του αγιου Κωνσταντινου**", që në rasën gjinore do të thotë "i Shën Kostantinit"[5].



Fig. 2. Foto e mbishkrimit të gjetur (© E.Selaj)

[5] Shën Kostantini apo siç njihet ndryshe Kostantini i Madh. Ishte perandor i perandorisë romake, i cili në vitin 313 nxorri dekretin e Milanos, me të cilin u jepej liria të krishterëve që të praktikonin lirisht besimin e tyre në të gjithë perandorinë. Shih. https://www.britannica.com/biography/Constantine-I-Roman-emperor). Ishte perandori i parë romak që predikoi krishtërimin. Ai quhet ndryshe Apostulli i trembëdhjetë në kishën Ortodokse. Shih: Starr. B. D., Life of King Judicael Saint and The Saints of His Ancestrypp, 2014 USA, f. 16.

Ky mbishkrim na vë në dyshim mbi përkatësinë e eshtrave, pasi bie ndesh me mbishkrimin në kapakun e kutisë. Duke menduar se gjetja e prejardhjes së kutisë do të na ndihmonte për të hedhur dritë mbi përkatësinë e eshtrave, u hulumtua historiku i lëvizjeve të objektit. Fatkeqësisht, informacioni rreth objektit është tepër i cunguar dhe mungon informacioni mbi kishën nga e cila origjinojnë eshtrat. Në një rast të tillë nevojiten të kryhen kërkime dhe ekzaminime të mëtejshme, analiza e izotopit të karbonit C14 do të ndihmonte në datimin e eshtrave për të përcaktuar cilit Shenjt i përkasin.

Teknika e punimit të objektit

Ndërhyjet konservuese në këtë grup objektesh ishin një mundësi e rrallë për të studiuar mënyrën, teknikën dhe mjeshtërinë e prodhimit të tyre, për të cilat dihet shumë pak. Nuk ka shumë informacion (botime) mbi mënyrën e prodhimit të relikuareve. Për të kuptuar teknikën e prodhimimit e sidomos të punimit të relievit duhej të vëzhgohej në mënyrë të hollësishme objekti për gjurmë të mbetura nga punimi e njëkohësisht të kërkonim mbi teknikat e punimit të argjendarisë në shekujt XVIII-XIX. Për këtë arsye u bënë disa analiza të imtësishme autoptike, të cilat u kryen me anë të stereomikroskopit. Gjurmët e punimit në pjesën e brendshme të kapakut indikuan mënyrën e punimit të dekoracioneve të relievit. Pjesët përbërëse të kutisë janë punuar një e nga një, të veçuara nga njëra tjetra. Në tërësi, kutia përbëhet nga 11 fletë argjendi 1-1.5 mm të trasha. Për t'u lidhur me njëra tjetrën me qëllim krijimin e një trupi solid, janë përdorur fletëza të vogla argjendi në formë shiritash në këndet ku lidhen me faqet, të cilat janë kapur me faqet e dekoruara me disa kunja argjendi, që janë puthitur mirë.

Bazuar në gjurmët e "daltës", pllakat e dekoruara me relieve janë punuar nga ana e brendshme.

Argjendarët fillimisht vizatonin me dorë të lirë kompozimin e përgjithshëm të punimit që do kryenin, në pjesën e brendshme (më pak të shkëlqyeshme) të pllakës së argjendit. Pllakëza që do të punohet në

PROOF COPY

reliev e do të gdhendet, fiksohej në një sipërfaqe të fortë mbuluar me një shtresë 2-5 cm të trashë katrani ose zifti, në bazë të thellësisë apo lartësisë së punimit. Pjesa e pllakëzës fiksohej në mënyrë të tillë që ajo që do të ishte sipërfaqja e jashtme e objektit të ishte e ngjeshur në masën e butë të katranit. Metali gdhendej në negativ, pra sipërfaqja që punohej ishte ajo që do të përbënte më pas pjesën e brendshme të objektit. Relievi punohej me çekiç dhe dalta të formave dhe mprehtësive të ndryshme, sipas nevojës së mjeshtrit për të arritur thellësinë, format dhe motivet e dëshiruara. Kapaku dhe tetë faqet e trupit të relikuarit janë punuar veç e veç. Pasi punoheshin format, masat e mëdha dhe motivet e kompozimit, pllakëza e argjendit hiqet nga masa që e mbante të fiksuar. Sipërfaqja që ishte ngjeshur në zift pastrohet nga mbetjet e ziftit me anë të nxehtësisë, më pas në këtë anë bëhej gdhendja apo inçizimi me kujdes e detajeve të imëta. Pra, për të përftuar format e bazorelievit, altorelievit dhe dekoret floreale, fletëza e argjendit punohej në negativ. Ndërsa detajet e imëta, si lulet në veshjen e Shenjtit, dekoret e pikave etj, janë bërë me inçizim në pozitiv. Po e njëjta metodë është ndjekur dhe për punimin e kryqit, i cili është vendosur midis kockave.

Nuk mund të anashkalohet mjeshtëria e lartë me të cilin është punuar ky objekt e gjithashtu zgjidhja kompozicionale e funksionale e bërë nga autori që fatkeqësisht mbetet anonim. Punimi i figurave njerëzore kërkon mjeshtari të lartë dhe eksperiencë. Në këtë rast, punimi i figurës së Shenjtit në kapakun e relikuarit është shumë i arrirë e njëkohësisht i përmbahet kanoneve post bizantine. Një trajtim i tillë tregon që autori njeh shumë mirë parimet e argjendarisë dhe skulpturës së relievit. Faqet anësore që përbëjnë trupin e kutisë mund të jenë punuar dhe nga ndihmësit e mjeshtrit pasi në disa prej faqeve kanë një simetri që nuk është realizuar në mënyrë të përpiktë. Për mënyrën e punimit dhe dekorin e përdorur mund të gjykojmë se ky objekt është i ngjashëm me objekte të tjera të prodhuara rreth vitit 1800, ndoshta nga esnafët e Gjirokastës.

Çështje të etikës në konservim/restaurim

Pas identifikimit të objekteve që mendohej se lidheshin me kultin e Shën Gjon Vladimirit rezultoi që pjesa më e madhe e tyre nuk ishin në gjendje të mirë konservimi. Ato kishin nevojë të trajtoheshin së pari për të ruajtur dhe konsoliduar objektin, së dyti për të studiuar objektin pasi shtresat e depozitimeve e bënin të pamundur këtë gjë, madje në disa raste dhe identifikimin e objektit dhe së treti për t'i bërë objektet estetikisht të prezantueshme për publikun e gjërë. Por, që në fillim u vu re që duhet të zgjidhnim një çështje shumë thelbësore në konservimin e objekteve religjioze, etika e konservimit/restaurimit. Kutia e lipsaneve përbënte një sfidë parësore që duhej zgjidhur, që kishte të bënte me vetë lipsanet. Në këtë rast nuk bëhej fjalë për një objekt të thjeshtë religjoz por për një objekt me rëndësi të veçantë pasi mbante eshtrat e një shenjti, eshtrat e një njeriu, eshtrat e një udhëheqësi. Në këtë aspekt duhej gjetur zgjidhja për të trajtuar objektin, por pa prekur dhe duke respektuar lispanet për të cilat ishte krijuar objekti. Duke u këshilluar me teologun Andrea Llukani u vendos që eshtrat të lëvizeshin nga objekti me shumë kujdes në mënyrë që të mos pësonin dëmtime gjatë ndërhyrjeve në objekt. U krijua një suport me pambuk të sterilizuar mbi të cilin u vendosën lipsanet. Së bashku më suportin ato u vendosën në një kuti druri dhe u siguruan në një nga kasafortat e fondit të muzeut. Duhet theksuar se lipsanet u trajtuan me respekt dhe nuk u bënë subjekt i ndërhyrjeve konservuese.

Gjendja e Konservimit

Në momentin e marrjes në trajtim, objekti paraqiste një sërë problematikash. Pavarësisht gjendjes së përgjithshme relativisht jo të mirë, në tërësi objekti nuk paraqiste probleme të mëdha të natyrës fiziko-statike. Disa nga problematikat e konstatuara ishin:
Depozitime koherente pluhuri dhe mbetjesh të tjera të ngjashme.

DO NOT COPY

Depozitime të konsiderueshme parafine të përqendruara kryesisht në pjesën e jashtme të kutisë sidomos në faqet anesore.

Depozitime karboni në sipërfaqen e jashtme, kryesisht në faqen e kapakut.Prani ngjitësish të hershëm. Fraktura e deformime të ndryshme. Krisje, nxirje[6] dhe korrozion të sipërfaqes së argjendit, depozitime biologjike[7]. Prezencë e oksideve të bakrit[8] etj.

Pjesa e jashtme e kutisë, duke qenë e ekspozuar ndaj faktorëve ambientalë dhe jo vetëm, ishte dukshëm më e dëmtuar në krahasim me pjesën e brendshme.

Në pjesën e kapakut të kutisë gjendeshin depozitime koherente pluhuri, karboni dhe parafine. Gjithashtu, u vërejt prania e oksideve të bakrit, si malakiti e kupriti dhe korrozion i sipërfaqes së argjendit. Faqet anësore të kutisë paraqitnin një intensitet më të lartë të depozitimeve të parafinës, të cilat zënë një sipërfaqe më të madhe.

Depozitimet e parafinës ishin të shoqëruara më depozitime biologjike me ngjyrë të gjelbër[9]. Në sipërfaqen e brendshme të objektit u evidentuan depozitime koherente pluhuri të përqendruara në pjesën e sipërme, depozitime karboni dhe parafine.[10] Po ashtu, si në sipërfaqen e jashtme u vërejtën depozitime biologjike rreth zonave me depozitime parafine. Shiheshin qartë gjurmë të ndërhyrjeve të mëparshme, përgjithësisht të një natyre artizanale.

Në pjesën e sheshtë të metalit ku janë fiksuar eshtrat, e cila ndodhet në pjesën e brendshme të kutisë, mund të shihen, në njërin prej këndeve gjurmët e një ngjitjeje të mëparshme me kallaj, e cila nuk i ka rezistuar kohës, pasi frakturat janë shkëputur dhe kanë mbetur vetëm depozitimet e degraduara të metalit.Gjithashtu, kutisë i mungojnë dy vida që shërbenin për të fiksuar sipërfaqen e argjendit që mban eshtrat. Në të njëjtën kohë, një nga mbajtëset e eshtrave ishte thyer e dy të tjera mungonin. Eshtrat pushojnë në pambukun që mbush kutinë, njëra prej tyre ka dy këllëf argjendi në ekstremitete që lidhen midis tyre me zinxhir. Në të dy këllëfët kishte depozitime dhe papastërti (Fig. 3,4).



Fig. 3. Foto e kutisë me lipsane përpara konservimit(© E.Selaj)



Fig. 4. Foto anësore e kutisë përpara konservimit (© E.Selaj)

[6] Shtresa e nxirë në sipërfaqen e objektit të argjendit krijohet kur ai është në kontakt me sulfurin, duke krijuar sulfatin e argjendit Ag2S.

[7] Alga të gjelbërta

[8] Malakit CU2(CO 3) (OH)2 karbonat i bakrit. Kuprit Cu20

[9] Materiali organik që përbën parafinën është shkak për praninë e depozitimeve biologjike.

[10] Këto depozitime parafine vijnë nga përdorimi i qirinjve mbi apo rreth kutisë, gjatë riteve apo lutjeve në kishë.

DO NOT COPY

Ndërhyrjet Konservuese

Pas studimit të kujdesshëm të gjendjes së objektit u krye në mënyrë mekanike pastrimi nga depozitimet e pluhurit dhe papastërtive të tjera nga sipërfaqja. Gjithashtu u pastruan mekanikisht depozitimet e parafinës në faqet anësore të objektit dhe ato biologjike. Shumë prej këtyre depozitimeve ishin koherente dhe për heqjen e tyre u përdorën solucione në tretësirë ujore. Depozitimet e mbetura, pjesa më e madhe e tyre me natyrë yndyrore, u pastruan me përdorimin e solucioneve të tjera[11]. Me qëllim pastrimin e depozitimeve të ndryshme si malakiti, kupriti etj., u përdorën tretësira ujore Rochel 1 për eliminimin e depozitimeve të malakitit dhe Rochel 2 për reduktimin e atyre të kupritit. Prezenca e këtyre oksideve lidhet me përbërjen e argjendit, i cili në këtë rast nuk është i pastër por ka përmbajtje metalesh të tjera, kryesisht bakër. Pjesa e brendshme e kutisë ishte shumë më e mbrojtur se ajo e jashtme e si rrjedhojë paraqiste më pak problematika.

Ndërhyrjet në këtë sipërfaqe ishin minimale. Ato konsistuan në pastrimin mekanik të depozitimeve të parafinës si dhe depozitimeve biologjike. Për të lehtësuar heqjen e depozitimeve të trasha të parafinës u përdor white spirit alternuar me pastrimin mekanik. Duke qenë se objekti ishte ngjitur më parë (pikuar me kallaj) dhe kjo ngjitje kishte humbur tashmë funksionin, u krye një punë e kujdesshme për heqjen e depozitimeve të kallajit të cilat cënonin harmoninë e objektit. Pas heqjes së depozitimeve të vjetra të kallajit, frakturat u pastruan mirë dhe u ngjitën me HMG dhe Paraloid B72.[12] Gjithashtu, u pastruan plotësisht këllëfët e fragmentit të kockës së femurit dhe zinxhiri që i lidhte ato. Gjatë ndërhyrjeve doli në pah një mbishkrim në këllëfin e sipërm të eshtrës.

Pas pastrimit të kujdesshëm, objekti u stabilizua dhe mbi të u aplikua një shtresë Paraloid B72 5% në aceton, me qëllim konsolidimin dhe mbrojtjen e metalit. Ndërhyrjet konservuese u kryen duke i qëndruar besnik parimit të ndërhyrjes minimale, duke ruajtur patinën e kohës ose siç quhet ndryshe patina fisnike e argjendit.

Konkluzione dhe këshilla

Ndërhyrjet e konservimit dhe hulumtimi rreth këtij objekti provuan që kjo kuti me lipsane shenjtori është një objekt me vlera të rralla në llojin e saj dhe i përket fund shekullit XVIII-fillim shekullit të XIX. Artifakti është një dëshmi e mjeshtërisë së lartë artistike dhe teknike në punimin e objekteve të argjendit. Këshillohet të ruhet në një vitrinë me klimë të kontrolluar me parametra: temperaturë 18°C ± 2 dhe lagështi relative 35% ± 5. Në pamundësi, këshillohet që lagështia relative të kontrollohet me silica gel.

DO NOT COPY

[11] Alkool etilik, Aceton

[12] Paraloid B72 është një rezinë akrilike, koopolimer i etilmetakrilatit, reversibël në ketone, hidrokarbure aromatikë etj.



Fig. 5. Foto e kutisë me lipsane pas konservimit (© E.Selaj)



Fig. 6. Foto anësore e kutisë pas konservimit (© E.Selaj)

DO NOT COPY

monumentet
57/2018

Msc. Erilda SELAJ

DO NOT COPY

CONSERVATION AND CONSIDERATIONS REGARDING A POST BYZANTINE BOX OF RELICS

The box of relics which was subject of conservation belongs to the Eastern Church (Orthodox), is made of composite metal mainly silver, with a small percentage of cooper and other metals. It has octagonal shape, decorated mainly with floral motifs on the sides and with the figure of St. Joan Vladimir in the lid inside of a decorated frame with angels on each corner of it. In the lid of the box there is an inscription O Αγιος Ιωανης ο Βλαδιμηρος which means Saint Joan Vladimir. The box was named after the inscription as it was thought, it stated to whom the object was dedicated and to whom were the relics on in. It contains two fragments of bones inside. During the conservation process, an important discovery was made as an inscription was revealed in one of the protective covers of one of the bones. The inscription is Greek and is written "του αγιου Κωνσταντινου" - which is in genitive and it means "to Saint Constantin". This was a very interested development of the object that might change it's identity and makes necessary the conduction of DNA analysis and C14 analysis in the future. The box was not in a good state of conservation. It had thick layers of deposits, dust, dirt, carbon deposits, paraffin deposits which made difficult to see the surface of the object. Deposits of old glues and other metals were present too. The box also had mechanical damages such as fractures, cracks and different deterioration on (remains of older restorations) the surface of the metal, tarnish, traces of corrosion, presence of malachite and cuprite. After the full documentation and several autoptic examinations started the treatment of the object. First was conducted the mechanical cleaning of layers of dust and pollution, which was later combined with chemical cleaning due to the difficulties to remove paraffin deposits, biological deposits and copper oxide deposits. Deposits of older glues and metals used as glues were removed and the fragments were attached again.

It was necessary to conduct consolidation and stabilization of the object. To protect the object from pollution and hazards a protective layer of coating was applied. After extensive research the box was estimated to date circa 1800 and is a fine example of applied post-byzantine art and craftsmanship.

DO NOT COPY

PUNIME RESTAURUESE, MIRËMBAJTJEJE DHE KONSERVIMI 2015-2017

DRKK BERAT

VITI 2015

Punimet e mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe ato konservuese përbëjnë drejtimin kryesor të ndërhyrjeve nga DRKK e qytetit të Beratit, gjatë vitit 2015. Ndërhyrjet kanë konsistuar në riparimin e dëmtimeve të fasadave, në ritrajtimin e portave, detajeve arkitektonike e dekorative etj.

A. Punime mirëmbajtjeje dhe konservuese

1. U kryen punime mirëmbajtjeje në kishën e "Shën Triadhës dhe Shën Todrit", ku u trajtuan të gjithë elementët e drurit.

2. U vendosën tabelat informuese në kishën e "Shën Todrit".

3. U kryen punime mirëmbajtjeje në hamamin e fshatit Sllatinjë dhe Çorovodë, në dy monumente kulture kategoria e parë.

4. U restaurua fasada e banesës së Lefteri Heqimit.

B. Projekte restaurimi

Specialistët e DRKK Berat kanë hartuar një sërë projektesh restaurimi, të cilat janë miratuar nga Këshilli Shkencor i IMK-së dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

1. Punime për restaurimin e çatisë së portës dhe strehës me dy palë bishta në banesën e Vangjel Bushit në lagjen Goricë, monument kulture kategoria e dytë. Punimet konsistojnë në prishjen e çatisë së portës dhe strehës. Restaurimi do të bëhet duke përdorur të njëjtën konfiguracion dhe teknikë.

2. Punime për restaurimin e kishës "Shën Evangjelizmoi". Ndërhyrja restauruese konsistoi në: restaurimin e pjesshëm të çatisë, zbritjen e tjegullave, zëvendësimin e petavrave të dëmtuara, zëvendësimin e trarëve të thyer si dhe qeramosje e çatisë. Punimet po kryhen nga punëtorët e mirëmbajtjes së DRKK Berat.

3. Restaurimi i një pjesë të murit kufizues me kullën nr. 14 (brenda Kalasë së Beratit).

4. Restaurimi i strehës së portës së oborrit tek ish shkolla e lagjes "Goricë". Fillimisht u krye zbërthimi i elementëve drusorë, pjesë përbërëse e strehës së vjetër. Nga amortizimi dhe degradimi i të gjithë elementeve drusorë u vendos që streha e re të realizohej me të njëjtën teknikë ndërtimi dhe realizimi të punimit të drurit, duke ruajtur konfiguracionin e mëparshëm. Streha u realizua me një palë bishta të punuar. Më pas u krye petavrimi, hidroizolimi me letër katrama dhe

mbulimi me tjegulla vendi. Të gjithë elementët e drurit u trajtuan me vaj lini e antimol. Lloji i drurit, i cili u përdor, është pishë vendi e stazhionuar për një kohë të gjatë në magazinën e DRKK Berat. Punimet u realizuan nga punëtorët e mirëmbajtjes së DRKK Berat.

5. Punimet restauruese të çatisë së kupolës së kishës së "Shën Triadhës" në Kalanë e Beratit. Gjatë muajit tetor, nëntor dhe në vazhdim, DRKK Berat me specialistët e mirëmbajtjes, do të ndërhyjnë në strukturën e çatisë së këtij monumenti të rëndësishëm, i cili daton në fund të shekullit të XIII - fillim të shekullit XIV.

6. Restaurimi i murit midis kullave 7-8 në Kalanë e Beratit. Pjesa e murit të restauruar ndodhet në anën perëndimore të kalasë së Beratit, midis kullave 7 dhe 8. Punimet restauruese filluan në muajin korrik dhe përfunduan në fillim të muajit shtator 2015. Fazat e punimit respektonin projektin e rindërtimit të pjesës së shembur gjatë vitit 2009 dhe konsolidimin e pjesës së murit, që edhe pse ende qëndronte në këmbë, kishte probleme në qëndrueshmërinë e tij. Gjithashtu, punimet bënë të mundur riintegrimin e pjesës së dëmtuar të rrënojave të ish garnizonit italian, me murin e restauruar.

7. Ndërhyrje për restaurimin në monumentin e kulturës së kategorisë së parë "Ura e Kasabashit".

C. Ndërhyrje konservuese në veprat e artit

Një drejtim i rëndësishëm i veprimtarisë së specialistëve të DRKK është edhe ndërhyrja (restaurimi) në veprat e artit.

1. Ikonat që po restaurohen janë: "Fjetja e Shën Marisë", "Shën Joan Pagëzori", "Krishti Pantokrator", "Shën Maria". Procesi i ndërhyrjes restauruese do të kalojë nëpër këto faza: Konsolidim i pikturës së ikonës; Dezinfektim; Pastrim; Rivendosje e Vernikut për mbrojtjen e pikturës së ikonës.

2. Restaurimi i ikonës "Krishti Pantokrator".

3. Restaurimi i ikonave "Joan Pagëzori" dhe "Shën Mari" (Eleusa) nga restauratorët e DRKK Berat, në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit -Berat.

VITI 2016

Punimet e mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe ato konservuese përbëjnë drejtimin kryesor të ndërhyrjeve nga DRKK e qytetit të Beratit, gjatë vitit 2016. Ndërhyrjet kanë konsistuar në riparimin e dëmtimeve të fasadave, në ritrajtimin e portave, detajeve arkitektonike e dekorative etj.

A. Punime mirëmbajtjeje dhe konservuese

1. Riparimi i suvatimeve dhe trajtimi i tyre duke i lyer me shërbet gëlqereje, punime të kryera në banesën e znj. Gjena Toromani, M-010 lagjja Mangalem.

2. Trajtimi i fasadës së banesës së z. Xhovani Koçaku, M- 018, lagjja Mangalem.

3. Punime restauruese në portën e oborrit të banesës së z. Petraq Simsia, lagjja"Goricë".

4. Pas hartimit të projekteve restauruese nga specialistët e DRKK Berat dhe miratimit nga Këshilli Shkencor i IMK-së dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit pranë Ministrisë së Kulturës, filloi zbatimi i tyre me paketën e mirëmbajtjes në objektet e ansamblit të lagjes Goricë:

a) banesa e z. Lil Gjogu, G-048;
b) banesa e z. Lil Çilingiri, G-069;
c) banesa e z. Sotiraq Ndrio, G-106.

5. Në kuadër të bashkëpunimit me organizatën Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) u morën shembujt praktikë në terren për zbatimin e projekteve të mësipërme, që i shërbyen njëkohësisht edhe restauratorëve të rinj për anën praktike të kursit të trajnimit. Ky kamp rajonal i restaurimit ishte i 30-ti që u realizua në qytetin e Beratit. Studentët e kampit rajonal të restaurimit e kryen praktikën e

DO NOT COPY

tyre në ndërhyrjet e kryera në banesën e Lil Gjogut G- 048 në lagjen Goricë, në restaurimin e portës së banesës Petraq Simsia G - 093 në Goricë, në portën e banesës së Z. Sotiraq Ndrio, G-106 në Goricë, në restaurimin e murit rrethues në banesën Çilingiri G - 069 në lagjen Goricë dhe konsolidimin e afreskut në kishën e Shën Triadhës në Kala.

6. Kanë filluar punimet restauruese në murin midis kullave 1 dhe 2, në Kalanë e Beratit. Projekti i restaurimit është hartuar nga specialisë të DRKK Berat. Financimi për zbatimin e tij u bë i mundur nga Bashkia Berat. Janë drejt përfundimit punimet restauruese në murin e rrëzuar midis kullave 1 dhe 2. Punimet filluan me sistemimin e materialit ekzistues në vepër. Gurët e paretit të jashtëm u mblodhën me kujdes në mënyrë që të ripërdoreshin për të ruajtur të njëjtën tipologji murature në sipërfaqe. Duke pastruar terrenin u vërejt shkalla e dëmtimit të muraturës ekzistuese. Në pjesët e murit të cilat ishin të paqëndrueshme dhe paraqisnin rrezik shembjeje, gurët u hoqën me kujdes dhe u sistemuan për t'u ripërdorur. Pas konsolidimit të themelit u bë e mundur ringritja e murit. Pareti anësor i jashtëm po realizohet me ripërdorimin e gurëve gëlqerorë që ndodhen në vend, të cilët po rivendosen në vepër me të njëjtën teknikë si muri ekzistues. Aktualisht është realizuar pjesa më e madhe e këtij procesi.

B. Projekte restaurimi

Specialistët e DRKK Berat kanë hartuar një sërë projektesh restaurimi, të cilat janë miratuar nga Këshilli Shkencor i IMK-së dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

1. Projekt restaurimi i çatisë së banesës kategoria e II-të me kod G-132, lagjja "Goricë". Janë drejt përfundimit punimet e restaurimit të çatisë, të kryera kryesisht me shpenzimet e vetë qytetarit. Qëllimi kryesor i restaurimit ishte zgjidhja e problemeve për mosdepërtimin e reshjeve të shiut (lagështisë), ruajtja e ambienteve për kushte sa më normale banimi për jetesë.

2. Projekt restaurimi i çatisë së banesës kategoria e I-rë me kod G-031, lagjja "Goricë". Aktualisht është në proces zbërthimi i çatisë, vrojtimi i kujdesshëm i elementeve drusore që përbëjnë strukturën e çatisë dhe më pas zëvendësimi i atyre elementeve të degraduara me material të stazhionuar sipas përmasave ekzistuese. Shpenzimet e investimit janë përballuar kryesisht nga qytetari.

3. Projekt restaurimi i çatisë së banesës kategoria e parë me kod G-136, lagjja "Goricë". Kanë përfunduar punimet (e pjesshme) restauruese të çatisë për eliminimin e depërtimit të rreshjeve të shiut (lagështisë), ruajtjen e ambienteve për kushte sa më normale banimi për jetesë dhe përkujdesjen për mosdëmtimin e tavanit dekorativ, i cili zbukuron brendinë e njërit prej ambienteve të banesës.

4. Përfundoi faza e parë e ndërhyrjes restauruese e konservuese në banesën kategoria e I-rë e znj. Areti Xhimitiku (Hoxha) lagjja "Goricë", sipas projektit të realizuar nga specialistët e DRKK Berat.

5. Punimet restauruese në çatinë e banesës së Romano dhe Luçi Heqimit, monument kulture i kategorisë së I-rë, në lagjen Mangalem. Punimet restauruese do të kryhen tërësisht me kontribut shtetëror me qëllim restaurimin e plotë të çatisë së monumentit, duke parandaluar degradimin e plotë të saj, në të cilën nuk është ndërhyrë rrënjësisht prej shumë vitesh.

6. Në kuadrin e projekteve të realizuara nga specialistët e DRKK Berat dhe me paketën e mirëmbajtjes, restaurimit dhe konservimit në Qendrën Historike, përfundoi restaurimi i çatisë së portës së oborrit në banesën e z. Arjan Meroli, në lagjen "Goricë". Aktualisht po kryhet trajtimi me vaj lini e antimol i elementëve të strehës së drurit, e cila, nga një strehë prej llamarine e improvizuar, tashmë përshtatet më së miri me kontekstin e lagjes

DOKTORATURA

historike të Goricës.

C. Ndërhyrje konservuese në veprat e artit

Një drejtim i rëndësishën i veprimtarisë së specialistëve të DRKK është dhe ndërhyrja në veprat e artit.

1. Restaurimi i dy ikonave: "Mbledhja e Kryeengjëjve" me nr. kartele 91, me dimensione 96.5 x 60.5 x 3.5 cm, me autor Kostandin Zografi, me prejardhje nga Kisha e Shën Kollit, Vanaj Fier dhe ikona "Mbledhja e Kryeengjëjve" me nr. kartele 81, me dimensione 7.5x70 cm, me autor Gjergj Johan Çetiri, me prejardhje nga Kisha e Shën Thanasit, Karavasta, Lushnjë, pjesë e fondit të DRKK-së Berat. Ndërhyrjet konservuese dhe restauruese konsistojnë në nxjerrjen nga gjendja e degradimit, duke i dhënë mundësinë e ekspozimit dhe promovimit të tyre.

2. Ka përfunduar restaurimi i ikonës "Shën Maria" (Eleusa). Ndërhyrja konservuese konsistoi në: konsolidimin e grundit, fiksimin e pelikulit të ngjyrës dhe pastrimin e sipërfaqjes së pikturës. Ndërhyrja u krye vetëm në atë pjesë të ikonës ku materiali i përdorur për pastrimin e saj (dimitil) nuk rrezikonte dëmtimin e ngjyrave dhe humbjen e vlerave orgjinale

3. Specialistët e Sektorit të Artit pranë DRKK Berat kanë nisur procedurën për rilevimin dhe hartimin e projektit të konservimit të pikturës murale të kishës së Shën Triadhës në Kala. Piktura murale e ruajtur ende në brendësi të kishës së Shën Triadhës është unikale në llojin e vet në qytetin e Beratit, pasi përbën dëshminë e vetme të mbetur nga piktura e stilit të vonë bizantin në artin ikonografik. Programi ikonografik i përket ndikimit të shkollës paleologiane të shek. XIII-XIV, me karakteristikë kryesore ngjyrat e theksuara dhe ndarjen e skenave në korniza të veçuara nga një shirit i kuq. Afresket murale të Kishës së Shën Triadhës janë në një gjendje jo të mirë dhe në to nuk është ndërhyrë asnjëherë në këto dekada. Duke parë gjendjen aktuale tejet të rënduar në pikturën murale të kishës së Shën Triadhës del e domosdoshme një ndërhyrje emergjente, e cila është e nevojshme për shpëtimin dhe parandalimin e pjesëve të rrezikuara të afreskut, të cilat kanë krijuar fugime, çarje dhe mbulim nga shtresa e gëlqeres dhe të kripërave, të cilat do të çlirohen gjatë procesit të konservimit.

VITI 2017

Punimet e mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe ato konservuese përbëjnë drejtimin kryesor të ndërhyrjeve nga DRKK e qytetit të Beratit, gjatë vitit 2017. Ndërhyrjet kanë konsistuar në riparimin e dëmtimeve të fasadave, në ritrajtimin e portave, detajeve arkitektonike e dekorative etj.

A. Punime mirëmbajtjeje dhe konservuese

1. Vazhdon puna për vendosjen e tabelave në portat e monumenteve. Këtë herë u pajisën me tabelën identifikuese dy monumente në lagjen Goricë: Kisha e Shën Spiridhonit dhe Kisha e Shën Thomait.

2. Po vijon trajtimi i elementëve drusorë me vaj liri dhe antimol në çardakun e Konakëve të Dervishëve në "Qendrën Mesjetare" të qytetit të Beratit, ku ndodhen dhe zyrat e DRKK-Berat. Trajtimi konsiston në lyerjen e dyshemesë, parmakut, kollonave të qoshes si dhe elementëve konstruktivë të çatisë së çardakut.

3. Punime mirëmbajtjeje në banesën e z. Vasillaq Goxhomane në Mangalem për vendosjen e dritareve të reja.

4. Ndërhyrje restauruese në muraturën e kullës pranë banesës së Z. Mbreshtanaku, në afërsi të zonës së Akropolit, në Kalanë e Beratit.

5. Ndërhyrje mirëmbajtjeje në fasadat e banesave të z. Bilal Bilali dhe z. Koço Nova, monumente kulture

DO NOT COPY

kategoria e dytë.

6. Pas dëmtimit nga faktorë natyrorë të murit rrethues të banesë së z. Vladimir Oço, në lagjen Goricë, monument kulture kategoria e parë, DRKK Berat ka ndërhyrë me specialistët e DRKK Berat për restaurimin e këtij fragmenti muri.

7. Punime mirëmbajtjeje në banesën e z. Islam Kërkuta, monument kulture kategoria e dytë, lagjja Mangalem.

8. Punime mirëmbajtjeje në banesën e z. Sheh Hasanit, monument kulture kategoria e parë, në lagjen 13 Shtatori.

9. Ndërhyrje emergjente në murin rrethues pranë banesës së z. Vasil Naço, në lagjen Kala, pas raportimeve të dëmtimeve pas lëkundjeve sizmike të shënuara në 2017. Këto dëmtime shkaktuan shembje të pjesshme të murit, që rrezikonte kalimtarët. Për restaurimin e këtyre dëmtimeve u ndërhy nga specialistët e DRKK Berat.

10. Restaurimi i portës së banesës së znj. Fatbardha Kodheli në lagjen Mangalem.

11. Punime mirëmbajtjeje në banesën e znj. Theodhora Heqimi, banesë e kategorisë së parë, kodi M-0.35 në lagjen Mangalem.

12. Punime mirëmbajtjeje në kala, në banesat e z. Piro Heqimi, monument kulture kategoria e dytë dhe z. Cac Dollani, monument kulture kategoria e parë.

B. Projekte restaurimi

Specialistët e DRKK Berat kanë hartuar një sërë projektesh restaurimi, të cilat janë miratuar nga Këshilli Shkencor i IMK-së dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

1. Ndërhyrjet restauruese në banesën e z. Mika Buhasi, monument kulture i kategorisë së parë, lagjja 28 Nëntori, e cila në "odën e mirë" ruan një nga tavanet më interesantë të dekoruar bukur e me mjeshtëri. Në fazën e parë ndërhyrjet kanë konsistuar me konsolidimin, pastrimin dhe restaurimin e afreskut në fasadën e banesës, ku u nxorr në pah ornamenti i një afresku me vlera artistike dhe në fazën e dytë me restaurimin e çatisë së monumentit.

2. Punimet restauruese në banesës e z. Filip Sinjari, lagjja Goricë.

3. Punimet restauruese në banesën e Z. Lili Vrohoriti, lagjja Mangalem.

4. Projekti i restaurimit në banesën e z. Dragush Polovina ka si synim restaurimin, rikonstruksionin në disa pjesë në ambientet e brendshme dhe rikonceptimin e hapësirave të interierit, pa cenuar pamjen e jashtme.

5. Përshtatja dhe restaurimi i banesës së z. Vladimir & Skerdilajd Meroli në lagjen Goricë u realizua me qëllim rivlerësimin e një pjese të ansamblit të kësaj lagjeje.

6. DRKK Berat në bashkëpunim me organizatën Trashëgimia Kulturore pa Kufij ka përfunduar ndërhyrjen restauruese në banesën e z. Bedri Merko, monument kulture i kategorisë së parë, dhe në banesën e z. Ilir Meqemeja, monument kulture i kategorisë së dytë, në lagjen Goricë. Ndërhyrjet restauruese në këtë banesë konsistuan në restaurim të çatisë së banesës, restaurim të portës së oborrit si dhe ndërtimin e çatisë së saj me material drusor si dhe mbulimin me tjegulla vendi.

C. Ndërhyrje konservuese në veprat e artit

Një drejtim i rëndësishën i veprimtarisë së specialistëve të DRKK është dhe ndërhyrja në veprat e artit.

1. Janë kryer punime konsolidimi dhe restaurimi të pikturës murale në kupolën e kishës së "Shën Triadhës". Në fazën e parë të ndërhyrjes është punuar për konsolidimin e shtresës lidhëse të suvasë me murin për të vijuar më tej procesin delikat të konsolidimit dhe restaurimit të afreskut në kupolë.

2. Është realizuar dezinfektimi i veprave të artit pranë ambienteve të laboratorit të DRKK Berat, një proces delikat ky që kryhet në periudhën stinore, kur veprimtaria e insekteve është më agresive dhe që mund të dëmtojnë panelin e drunjtë të ikonës.

DO NOT COPY

DRKK DURRËS

1. Rehabilitimi i hapësirës së Amfiteatrit, Durrës.

Përfundoi me sukses procesi i shpronësimit të fazës së parë, të tre kartelave të pasurive (objekte + truall) me numër pronësie 24/15, 24/16, 24/173, të cilat ndodheshin në arenën e amfiteatrit. Pronarët u shpronësuan sipas procedurës dhe u larguan nga banesat, gjë e cila bëri të mundur fillimin e punimeve për prishjen e banesave dhe lirimin e hapësirës përreth Amfiteatrit.

Projekti i hartuar nga specialistët e IMK dhe DRKK-Durrës dhe i miratuar në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve, u tenderua nga DRKK-Durrës me fond limit: 4,002,347.5 lekë (katër milion e dymijë e treqind e dyzetë e shtatë pik pesë) lekë pa tvsh dhe afat të punimeve 60 ditë nga lidhja e kontratës.

Mbikëqyrja e këtij procesi është ndjekur nga DRKK-Durrës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës, ku janë caktuar tre supervizorë, dy arkeologë dhe një arkitekt, të cilët kanë ndjekur të gjitha punimet në mënyrë të vazhdueshme. Puna për prishjen e objekteve është kryer manualisht sipas specifikimeve në projekt.

Është ruajtur çdo element, si: tjegullat, trarët, tullat, objektet e gurit, ku disa prej të cilave janë marrë nga Amfiteatri dhe janë ripërdorur për ndërtimin e këtyre banesave. Duhet theksuar se projekti parashikonte vetëm prishjen e banesave dhe jo gërmime arkeologjike.

Gjatë punimeve për zbatimin e projektit *"Rehabilitimi i hapësirës së Amfiteatrit, Durrës"*, u konstatuan tre gjetje arkeologjike. Këto gjetje erdhën si rezultat i çmontimit të dy banesave, të cilat ndodheshin prej vitesh në arenën e amfiteatrit. Kishim të bënim me tre gjetje:

1. Fragmente muri të Amfiteatrit;
2. Fragmente muri të një banese të vjetër;
3. Portë në formë "Hark Triumfi", e dekoruar me ornamente.

Fragmentet e murit të amfiteatrit dolën në pah pas heqjes së suvasë të njërës prej banesave. Nga struktura e ndërtimit dallohet se është vazhdimësi e strukturave murale të amfiteatrit. Orientimi i tij ka formën e një harku, është lehtësisht e dallueshme se ndiqte formën e galerive radiale të amfiteatrit. Deri në ditët e sotme vihet re se janë të ruajtura 3 (tre) fragmente muri. Nga sa vihet re, muri fillestar mund të ketë qenë i vazhdueshmë pa hapje, por në adaptimet e bëra nga banesa ka pësuar ndërhyrje, ku janë hapur dy dyer, të cilat në gjendjen aktuale krijojnë dhe tre strukturat murale. Nga teknika e ndërtimit dallohet qartë se kemi të bëjmë me teknikën *opus mixtum dhe opus caementicum*. Në njërën nga strukturat e murit vihen re dhe gjurmë të qemerit të njërës "galeri" të amfiteatrit.

Ndërhyrjet konservuese për ruajtjen e këtyre strukturave konsistojnë në: pastrimin e mureve nga materiali i degraduar dhe pjesët e dëmtuara, injektimin me llaç në sipërfaqet e dëmtuara si dhe konsolidimin e pjesës së sipërme të murit (kreut) e cila ishte dhe më e dëmtuar nga ndërhyrjet e mëparshme. Fugatimi do të kryhet vetëm në ato pjesë ku është dëmtuar në thellësi llaçi lidhës.

Gjatë heqjes së suvatimit në banesën e dytë, doli në dritë një mur me teknikë ndërtimi që nuk i përkiste periudhës moderne të shtëpisë ekzistuese. Ky mur kishte vazhdimësi nga kati i parë në katin e dytë. U vu re se muri i katit të dytë *"ana lindore dhe jugore"* ka vazhdimësi me murin e katit të parë, kjo pasi soleta e katit të dytë është mbështetur në këtë mur dhe muri nuk ishte i mbështetur plotësisht në soletë. Muri kishte formën e një dhome, e cila mund të ketë qenë e hapur dhe me ndonjë strehë në formën e një hajati. Këndi i murit është i ndërtuar me gurë më të mëdhenj dhe në formë kuadratike të skalitura mirë me kënd të drejtë. Kjo tipologji ndërtimi është gjerësisht e përhapur në territorin e Shqipërisë, duke filluar nga mesi i shekullit të XIX

DO NOT COPY

deri në fillim të shekullit të XX. Karakteristikë dalluese janë dhe dy kamaret e vendosura nga të dyja anët e oxhakut.

Portë në formë "Harku Triumfi", me ornamente.

Pranë banesës së parë kemi dhe një portë në formë harku triumfi, ku në pjesën frontale në të dyja anët është e zbukuruar me ornamente floreale. Në pjesën ballore, nga rruga, porta është e zbukuruar me dredha dhe rozeta kurse në pjesën e brendshme të shtëpisë, si ornament zbukurues, ka tre rozeta. Nga teknika e ndërtimit duket se i përket periudhës së ndërtimeve italiane në qytetin e Durrësit.

RRËNOJAT E NDËRTESËS ME MOZAIK

Është fjala për monumentin e zbuluar që në vitin 2005, "Rrënojat e ndërtesës me mozaik". I ndodhur në kushte shumë të vështira ndotjeje dhe lagështire për një kohë të gjatë, ky monument ishte drejt shkatërrimit. Pasi pjesa më e madhe e të gjithë objektit ishte e mbuluar nga ujërat e zeza dhe nga mbetje mbeturinash dhe materiale inerte. Për të bërë të mundur ruajtjen e strukturave ekzistuese u bë një projekt konsolidimi dhe pastrimi, për bërjen të vizitueshme për publikun të hapësirës së këtij monumenti.

Punimet konsistuan kryesisht në heqjen masive të mbeturinave, të cilat kishin zënë pothuajse të gjithë hapësirën në të cilën ndodheshin strukturat arkeologjike, si dhe u bë rrethimi dhe mbulimi i objektit në mënyrë të tillë që të shmangej hedhja e mbeturinave në ambientet e brendshme të monumentit.

U bë i mundur largimi i ujërave të zeza, kjo duke ndërhyrë dhe në sistemin e kanalizimit të pallatit në të cilin ndodhen këto rrënoja. Me largimin e ujërave u bë dhe nivelimi i dyshemesë. U bë i mundur konsolidimi i pareteve të mureve anësor "mbajtës" në të cilën ndodhet mozaiku. Kjo për t'i krijuar një bazament mbajtës mozaikut në mënyrë të tillë që mos të rrezikohej prishja e strukturës së tij.

U bë pastrimi dhe largimi i të gjitha materialeve inerte që ndodheshin në strukturat murale të rrënojave arkeologjike, në mënyrë të tillë që këto rrënoja të jenë të vizitueshme dhe të aksesueshme në çdo orë të ditës, si dhe u bë e mundur vendosja e sistemit të ndriçimit.

DRKK Durrës e transformoi këtë rrënojë të lënë pas dore në një momument tërheqës, duke e kthyer në një vlerë të shtuar në zonën turistike të Durrësit.

RESTAURIMI I GODINËS SË MUZEUT TË PËRGJIMEVE "SHTËPIA ME GJETHE"

U finalizua procesi i restaurimit dhe i rehabilitimit të plotë të godinës së përgjimeve. Procesi i restaurimit u krye nga një firmë private e licencuar për punime restauruese në objekte me statusin Monument Kulture. U krye restaurimi i plotë i të gjitha ambienteve të brendshme dhe të jashtme, projekti mekanik dhe elektrik, si dhe procesi i muzealizmit.

PUNIME MIRËMBAJTJEJE NË MUZEUN ETNOGRAFIK TË ELBASANIT

Kjo është një banesë tipike Elbasanase me çardak, e ndërtuar në fund të shekullit XVIII. Banesë e kategorisë së parë e shpallur monument kulture në 16/10/2008. U shpall muze i qytetit në vitin 2008. Ky muze është i konceptuar në dy kate. Në katin përdhe janë të ekspozuara mjetet dhe veglat artizanale të kohës. Në katin e parë gjejmë të paraqitur mënyrën e jetesës dhe veshjet tradicionale të qytetit.

Pas një gjendjeje jo të mirë konservimi Muzeu Etnografik në qytetin e Elbasanit iu nënshtrua një procesi konsolidimi në disa nga ambientet e tij. Problematika kryesore që shfaqej në këto ambiente ishte prania e lagështisë, degradimi i suvatimeve

DO NOT COPY

në disa pjesë të strukturës së mureve të banesës, kryesisht në fasadën veriore si dhe degradimi i shtresës së dyshemesë prej druri në pjesën e çardakut. Këto punime u kryen nga një firmë e licensuar në restaurim për monumentet e kulturës.

U krye suvatimi dhe mbushja e fugave në ato pjesë ku kishte degraduar pothuajse plotësisht suvaja. U krye zëvendësimi i të gjithë elementëve të kalbur të dyshemesë së çardakut. Këto element u zëvendësuan me elementë të rinj druri për dysheme, duke iu përshtatur përmasave dhe përbërjes prej të njëjtit dru që është përdorur në dyshemen e çardakut. Për të bërë të mundur mbrojtjen maksimale të drurit nga agjentët atmosferikë u aplikua lyerja me vaj lini. Mbrojtja nëpërmjet imprenjantit ose vajrave bën të mundur mirëmbajtjen më të lehtë të drurit me kalimin e kohës. U bë e mundur riparimi i dritareve ekzistuese prej druri dhe zëvendësimi i të gjithë xhamave të thyer. U krye dhe lyerja me shërbet gëlqereje e ambienteve të banesës.

KONSERVIMI NË PIKTURËN MURALE TË XHAMISË SË ET'HEM BEUT, TIRANË

Xhamia e Haxhi Et'hem Beut është e vetmja ndër tetë xhamitë e shekullit XVIII-XIX të ndërtuara në Tiranë, që e shohim ende sot. Sipas mbishkrimeve që përmban xhamia e Haxhi Et'hem Beut, themelet e saj i vuri në fund të shek. XVIII, Molla Beu, kurse faltoren e plotësoi i biri i tij, Haxhi Et'hem Beu në çerekun e parë të shek. XIX.

Sipas mbishkrimit që përmban vetë xhamia, themelet e faltores i vuri Mulla Beu në vitin 1207 'h (1794-1795), i cili arriti të ndërtonte xhaminë deri në përfundimin e kubesë, pa mundur të plotësonte minaren dhe të përfundonte sofanë (portikun, hajatin), suvatimet dhe dekoracionet, të cilat u kryhen pasi ai vdiq. Vizitorëve u ofrohet një arkitekturë e mrekullueshme e xhamisë, e zbukuruar me piktura mural edhe sipas traditës orientale.

- Pas një shkëputje nga suporti ekzistues i një pjesë të pikturës murale në xhaminë e Et'hem Beut rreth 0,5 m2 në arkadën e parë në drejtimin veri – lindor, specialistë të Institutit të Monumenteve të Kulturës bënë një ndërhyrje emergjente konservuese në këtë pjesë. Mënyra e ndërhyrjes:

Në fillim sipërfaqja e pikturës murale u pastrua nga depozimet sipërfaqësore (pluhurat) dhe u sigurua me bendazhe me letër japoneze të ngjitur me Paraloid B72 të tretur 10% në Açeton. Më pas u kryen injektime me shiringë, me ujë dhe alkool në raportin 70/30 për zbutjen e shtresës së afreskut. Pas këtij procesi u injektua konsolidant PLM-AL dhe me anë të disa pajantimeve me kompesatë të lakuar u arrit puthitja dhe ngjitja e afreskut me suportin. Me tharjen e plotë të strukturës tashmë të konsoliduar u hoqën dhe bendazhet me letrën japoneze me anë të solucionit açeton.

STACIONI ROMAK AD-QUINTUM, ELBASAN

Stacioni Romak Ad Quintum është ndërtuar në shek. e II p.e.s. përgjatë rrugës Egnatia, për t'i shërbyer udhëtarëve si terma dhe si mutatio. Ai përbën një kompleks së bashku me nimfeun, të vendosur në një sipërfaqe 4 këndëshe 45 x12 ml. Termat zënë një sipërfaqe të kufizuar prej 130 m2 të llogaritura për pak persona. Banjot e këtij stacioni kanë një zgjidhje racionale planimetrike dhe estetike. Stacioni antik i Ad Quintum paraqitej në një gjendje jo shumë të mirë për sa i përket mbulesës dhe konstruksionit mbi të cilin ishte vendosur kjo mbulesë.

Mbulesa e cila ishte realizuar me konstruksion druri me kollona 12 x 12 cm, me trarë e binarë mbajtës kryesor me përmasa 6 x 12 cm dhe me ristela dërrase të vendosura çdo 50 cm me përmasa 3 x 5 cm.

Mbulesa e sipërme ishte një katrama e trashë e gomuar me ngjyrë të gjelbër. Ajo ishte dëmtuar totalisht dhe nuk e kryente më funksionin e saj.

Gjithashtu, struktura e drurit kishte pësuar dëmtime për shkak të dëmtimit të një kollone qendrore në anën jugore, e cila ishte spostuar nga bazamenti dhe

DO NOT COPY

ishte thyer.

Trarët kryesore (binarët) horizontalë ishin harkuar dhe ishin thyer për shkak të gjatësisë së madhe pa mbështetje në mes. Këto binarë ishin mbështetur me pjesën më të ngushtë dhe jo vertikalisht për të rritur qëndrueshmërinë. Një pjesë e mirë e ristelave nuk ekzistojnë më.

Ndërhyrjet e bëra:

- Restaurimi i konstruksionit mbajtës të mbulesës, duke ruajtur pothuajse të gjitha kollonat përveç kollonës së mesit, në anën jugore, e cila u zëvendësua;
- Zëvendësimi i të gjithë trarëve dhe binarëve me të njëjtën përmasë si ato ekzistueset, por të vendosura vertikalisht, për të rritur qëndrueshmërinë e strukturës;
- Zëvendësimi i ristelave lidhëse e mbështetëse dhe lyerja me antimol e të gjithë dërrasave;
- Zëvendësimi i katramasë me mbulesë plastike e cila mund të jetë e valëzuar apo jo, që mbështetet dhe mbërthehet në strukturën e dërrasës;
- Zëvendësimi i ulluqeve horizontale e vertikale dhe kapja e tyre në kollona;
- Vendosja e dy tabelave informuese në monument;
- Pastrimi i monumentit nga vegjetacioni.

MURET E PORTËS (PORTO ROMANO)

Muri i Portës ndodhet rreth 7 km në veri të qytetit të Durrësit në vendin e quajtur "Porto Romano". Ruhen ende mbetjet e një muri që mbyllte dikur rripin e ngushtë të tokës, ndërmjet detit dhe kënetës. Pra, sot kemi vetëm një trakt rreth 60 m i gjatë dhe një kullë katërkëndëshe me lartësi 4 m. Hyrja e kështjellës, "Porta", prej së cilës ka marrë emrin krejt fortifikimi, ndodhet në perëndim të kullës. Forma e kullave dhe teknika e ndërtimit ndryshon nga ajo e murit rrethues të qytetit të Durrësit. Kalaja e Portës u ndërtua në shek. VI. Kulla e vetme e ruajtur në murin e Portës, si nga përmasat vendosja e shkallëve, hyrjeve etj, të kujton kalanë e Rusofës në Siri, të ndërtuar nga perandori Justinian.

Ky projekt konsiston në vendosjen e një rrethimi si dhe vendosjen e tabelave informuese në Murin e Portës, i cili është Monument Kulture i Kat. së I-rë, me vendndodhje në Porto Romano të qytetit të Durrësit.

Vendosja e rrethimit të murit të portës është bërë për arsye të ruajtjes së tij nga ndërhyrjet e ndryshme që mund të bëhen. Vendosja e rrethimit u bë me material druri, në mënyrë të tillë që njerëzit dhe turistët, qoftë vendas apo të huaj të kenë mundësi ta shohin këtë monument.

Në një fragment të murit, në pjesën e pasme të tij, në një gjatësi rreth 20m u pa e nevojshme të bëhej çlirimi i murit nga prezenca e dherrave, duke bërë skarifikimin e tyre dhe hapjen e një bankine kaluese me gjerësi 1m, pjesa tjetër e dherrave është shkallëzuar në gjerësi 1m dhe në gjatësi 0.5 m, për të mos lejuar rrëshkitjen e dherave. Ky masiv dheu paraqiste problem në prezencë e lagështirës, e cila përveç rritjes së vegjetacionit ndikon në dobësimin e materialit lidhës (llaçit) të murit rrethues.

Përveç të tjerave, u bë dhe pastrimi i zonës nga vegjetacioni, ndërhyrje kjo e cila bëhet në vazhdimësi nga ana e DRKK Durrës.

DRKK Durrës, duke parë se zona në të cilën ndodhet ky monument vitet e fundit ka marrë një zhvillim të madh si nga ana e turizmit gjithashtu dhe nga ana e zhvillimit industrial, u pa e arsyeshme që ky objekt të jetë dhe një pikë atraksioni turistik si dhe të ketë një paraqitje sa më dinjitoze për vizitorë të ndryshëm.

BAZILIKA E SHËN MËHILLIT-ARAPAJ DURRËS.

Bazilika e Shën Mëhillit ndodhet në kodrën e Shën Mëhillit pranë fshatit Arapaj në rrethin Durrës.

Bazilika paleokristiane e Shën Mëhillit është një nga bazilikat më të mëdha në Shqipëri. Mozaiku që ruhet në një nga ambientet e saj shquhet për

DO NOT COPY

kompozimin, realizimin e figurave dhe ngjyrat e pasura. Me një vendndodhje shumë pranë rrugës që lidh veriun me jugun e Shqipërisë, ajo paraqet një interes të veçantë për vizitorët vendas dhe të huaj.

Gjendja e Monumentit

Bazilika e Shën Mëhillit ruhet në gjendje rrënojë. Vetëm ambienti i mozaikut është i mbuluar, me një mbulesë plasmasi gjeotekstil dhe me një shtresë rreth 20-30 cm rërë të larë lumi. Kjo shtresë mbulimi bëhet për të mbrojtur atë nga vegjetacioni, likenet, myshqet dhe algat.

I gjithë territori ku ndodhen rrënojat e bazilikës është i rrethuar (pjesërisht me kangjella hekuri dhe pjesërisht me gardhe druri). Rrënojat e bazilikës ruhen në nivelin e dyshemesë me konturet e mureve rrethues (të cilat arrijnë vende vende në lartësinë 0.5 m). Megjithë ndërhyrjet periodike me karakter mirëmbajtës, vegjetacioni i ulët është problem i vazhdueshëm në këtë monument. Rrënojat vazhdimisht mbulohen nga vegjetacioni dhe nga shtresa e humusit.

Objektivat që priten të arrihen me këtë projekt.

Ndërhyrjet konservuese që janë kryer në këtë monument të rëndësishëm të arkitekturës paleokristiane kanë për qëllim rritjen e vizitueshmërisë. Synimi kryesor është ruajtja e vlerave origjinale që paraqet monumenti. Ndërhyrja konservuese në këtë projekt ka të bëjë me ruajtjen e mozaikut, ku u vendos që të bëhej tenda prej druri mbi sipërfaqen e mozaikut, për ta ruajtur nga agjentët atmosferikë, kryesisht nga shiu dhe uji. Siç dihet, në këtë mënyrë nuk bëhet vetëm mbrojtja e strukturës së mozaikut, por dhe e varrit që ndodhet poshtë këtij mozaiku. Me këtë ndërhyrje arrihet një eliminimi i lagështirës në strukturat pranë mozaikut.

DRKK GJIROKASTËR

DRKK Gjirokastër, në vazhdimësi të punës për mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës së kategorisë së parë, të dytë si dhe kishat, për vitin 2015-2016 ka kryer në total 64 ndërhyrje në këto monumente.

Në këtë material po pasqyrojmë disa nga ndërhyrjet më të spikatura të cilat patën si synim konsolidimin e monumenteve nga ana statike, ku në disa është kryer edhe trajtim i pjesshëm arkitektonik, duke ruajtur vlerat e çdo monumenti.

VITI 2015

BANESA "BEQIRI" kategoria I L. "Dunavat"

Punimet restauruese konsistuan në ruajtjen e vlerave arkitektonike (testekët e gjatë, dritaret) si dhe në restaurimin e çatisë.

BANESA "DHRAMI" kategoria I L. "Palorto"

Punime restauruese në fasadë, ruajtja e vlerave arkitektonike të dritareve dhe çatmasë.

PORTA E BANESËS "XHENETI" kategoria I L. "Partizani"

Ndërhyrja konsistoi në ribërjen e çatisë, pasi elementët drusorë të saj ishin të kalbur dhe të thyer. Porta u rikthye në gjendjen e mëparshme.

BANESA "RESO" kategoria I L. "Dunavat"

Punimet restauruese konsistuan kryesisht në restaurimin e çatisë si dhe në punime përforcuese dhe konsoliduese të çarjeve në mure si dhe eliminimin e lagështisë.

BANESA "SALARIAJ" kategoria II L. "Partizani"

Punimet restauruese u kryen në sprethin e ballit të

DO NOT COPY

banesës me dy krahë.

VITI 2016

BANESA "XHEZO" kategoria I L. "Palorto"

Punimet restauruese konsistuan në sprethin verior të banesës.

PORTA "STAVRI" kategoria II L. "Pazar i Vjetër"

Porta e ndodhur në lagjen më të vjetër të qytetit ishte e rrëzuar, ndërhyrja e ktheu portën në gjendjen e mëparshme, duke ruajtur elementët arkitektonikë të portës.

PORTA "GJEBRE" kategoria II L. "Dunavat"

Punimet te kjo portë u kryen dhe u bë restaurimi i plotë i çatisë të portës, konstruksioni i drurit ishte kalbur totalisht dhe porta rrezikonte banorët e banesës.

BANESA "CIU" kategoria II L. "Dunavat"

Ndërhyrja në këtë banesë të kategorisë II konsistoi në çatinë në të cilën nga lagështia ishin deformuar disa trarë e mahi. Ndërhyrja eleminoi degradimin e mëtejshëm të çatisë.

KISHA NË LABOVËN E KRYQIT kategoria I

Punimet restauruese u kryen në çatinë e hajatit të kishës për zëvendësimin e petavrës së kalbur.

DRKK KORÇË

VITI 2015

Punimet e mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe ato konservuese përbëjnë drejtimin kryesor të ndërhyrjeve nga DRKK Korçë, gjatë vitit 2015. Ndërhyrjet janë përqendruar në objektet e kultit, në banesa etj.

A. Punime mirëmbajtjeje dhe konservuese

1. Banesa e Vangjush Mios është një banesë dykatëshe, me planimetri në formën e shkronjës "L". Përbëhet nga "dhoma e miqve", "studioja" dhe "dhoma mbi pus", të cilat përfaqësojnë në vetvete dhe fazat e ndryshme ndërtimore të banesës. Zbulimi i datës 1841, e cila i përkiste fazës së dytë ndërtimore, fitoi një rëndësi të veçantë, jo vetëm për faktin se është data më e vjetër e zbuluar deri më sot në qytetin e Korçës, por se ajo shërben si një pikë e sigurtë referimi për përcaktimin kohor të zhvillimit të banesës korçare dhe njëkohësisht hidhte dritë mbi shtrirjen gjeografike të tipit të banesës me çardak. Punimet e ndërmarra në këtë banesë konsistuan në ndërrimin e çatisë, rinovimin e fasadës në gjithë elementët e saj dhe në sistemimin e territorit përreth.

B. Projekte restaurimi

Specialistët e DRKK Korçë kanë hartuar një sërë projektesh restaurimi, të cilat janë miratuar nga Këshilli Shkencor i IMK-së dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

1. Restaurimi i mureve të Manastirit të Shën Pjetrit në Vithkuq, i cili përbëhet nga Kisha e Shën Pjetrit, Kisha e Shën Kozmait dhe Damianit dhe ambientet e manastirit, të cilat kanë qenë në formë rrënojash. I gjithë kompleksi i manastirit ka një mur rrethues ku përfshihen brenda këto tre objekte.

DO NOT COPY

Ndërtimet janë të fundshek. XVIII. Megjithëse muret e Manastirit kanë qenë të shembura, bërthamat e tyre nga themeli deri në kuotën mesatarisht 1m kanë ekzistuar. Projekti i hartuar dhe i zbatuar në muret e Manastirit konsistonte në përdorimin e gurëve ekzistues dhe në riformimin e tyre sipas bërthamave ekzistuese. Gjatë realizimit të procesit të restaurimit janë kryer me kujdes shumë gërmime për të rinxjerrë kuotat ekzisuese, pasi ishin të mbuluara me dhé dhe mbeturina, për të rigjetur ekzakt vendndodhjen e murit. Muret janë riformuar deri në kuotën 1.2 m. E rëndësishme ka qenë riformimi i harkut të hyrjes kryesore. Restaurimi është kryer konform kushteve teknike të zbatimit për restaurim dhe projekti do vazhdojë me akordimin e fondeve të tjera.

2. Restaurimi i kishës së Ristozit në fshatin Mborje i realizuar në vitin 2015 konsistoi në përforcimin e mureve, restaurimin komplet të çative dhe kupolës, të dekoracioneve arkitekturore, të shtresave si edhe të pikturave murale. Rëndësi të veçantë pati restaurimi i kupolës, e cila kishte dëmtime të mëdha, që pasqyroheshin edhe në faqet e brendshme, ku ka pjesërisht piktura.

3. Restaurimi i Urës së Shën Prodhromit në Voskopojë konsistonte në restaurimin e mbishtresës së kalldrëmit të Urës, së bashku me parapetet anësore. Janë bërë fugatime dhe injektime në plasaritjet dhe çarjet që kishin pësuar harqet e urës. Gjithashtu, është restauruar edhe një pjesë e murit mbajtës në anën veriore të urës.

C. Ndërhyrje konservuese në veprat e artit

Një drejtim i rëndësishën i veprimtarisë së specialistëve të DRKK është dhe ndërhyrja në veprat e artit.

1. Ndërhyrja në pikturë në kishën e Shën Pjetrit në Vithkuq konsistonte kryesisht në konsolidimin e pikturave murale të naosit dhe rëndësi të veçantë i është kushtuar pastrimit dhe konsolidimit të pikturës murale në kupolë.

VITI 2016

Punimet e mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe ato konservuese përbëjnë drejtimin kryesor të ndërhyrjeve nga DRKK Korçë, gjatë vitit 2016. Ndërhyrjet janë përqendruar në objektet e kultit, në banesa etj.

A. Punime mirëmbajtjeje dhe konservuese

1. Tuma e Kamenicës si objekt është rivitalizuar në vitin 2008, ku u përfshi pjesa tumulare si edhe ngrehinat informative brenda territorit të tumave. Gjatë viteve ka pasur amortizim të pjesëve prej druri, si edhe prurje dhe mbivendosje të dheut mbi tumë prej erozionit dhe agjentëve atmosferikë. Në projektin e ndërhyrjeve janë kryer punime si: zëvendësimi i elementeve prej druri të rrethimit; rindërtimi i portës së jashtme; pastrimi dhe evidentimi i pjesës tumulare; restaurimi i mureve rrethues të Tumës; përforcimi i bordurave rrugore si edhe pastrimi dhe sistemimi i territorit nga bimësia spontane.

2. Ndërhyrjet në kishën e Shën Marisë në Vithkuq kanë konsistuar në zëvendësimin e elementëve të strukturës së lehtë prej druri në vendet e degraduara, në vendosjen e shtresës hidroizoluese në çati, në zbulimin dhe mbulimin e çatisë, si edhe zëvendësimin e plloçave të dëmtuara dhe sistemimin e terrenit.

B. Projekte restaurimi

Specialistët e DRKK Korçë kanë hartuar një sërë projektesh restaurimi, të cilat janë miratuar nga Këshilli Shkencor i IMK-së dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

1. Në kishën e Shën Johanit në Boboshticë, problematikat konsistonin në efektet e lagështirës së krijuar prej nivelit të lartë të ujërave nëntokësore. Gjithashtu, territori përreth ishte i mbushur me rrënojat e murit të hajatit tashmë të prishur dhe të narteksit të dikurshëm. Në zbatim të projektin të

PO NJË COPY

restaurimit u krye drenazhimi, pastrimi i territorit, si edhe restaurimi i muraturës së hajatit dhe të portës, që tashmë shërben si oborr për kishën. Gjithashtu, u krye dhe shtrimi i pjesës së oborrit me plloçat ekzistuese sipas origjinalit.

VITI 2017

Punimet e mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe ato konservuese përbëjnë drejtimin kryesor të ndërhyrjeve nga DRKK Korçë, gjatë vitit 2017. Ndërhyrjet janë përqendruar në objektet e kultit, në banesa, etj.

A. Projekte restaurimi

Specialistët e DRKK Korçë kanë hartuar një sërë projektesh restaurimi, të cilat janë miratuar nga Këshilli Shkencor i IMK-së dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

1. Restaurimi i kishës së Ristozit në fshatin Mborje i realizuar në vitin 2017 konsistoi në restaurimin e mureve rrethuese, ku u ndërhy në ringritjen e pjesës së rrëzuar të murit në pjesën lindore dhe veriore, u bë fugatimi i mureve rrethues në pjesët ku materiali lidhës ishte degraduar, si edhe u vendos shtresa e pllakave mbi murin rrethues, në pjesët e munguara.

2. Kisha e Shën Dhimitrit ndodhet në pjesën perëndimore të fshatit Boboshticë. Problematikë në këtë kishë ka qenë prezenca e lagështisë, kjo e theksuar sidomos në pjesën veriore, ku tabani i dyshemesë së kishës është nën nivelin e tokës. Muret e kishës kishin nevojë për fugatim, për shkak të degradimit të materialit lidhës. Në anën perëndimore të objektit, në qoshe, muri kishte pësuar çarje, e cila kishte nevojë për ndërhyrje. Punimet restauruese në këtë objekt konsistuan në qepjen e murit perëndimor të narteksit, në fugatimin e mureve të brendshme të tij, në drenazhimin dhe ndërtimin e një trotuari me kalldrëm përreth kishës.

3. Kisha e Shën Thanasit është një bazilikë 3-nefëshe e ndodhur në pjesën veriore të Voskopojës. Ndërhyrjet restauruese në këtë objekt konsistuan në ringritjen e murit rrethues të kishës në pjesën perëndimore dhe veriore të saj. Pjesa e dekoracionit të fasadës kryesore kishte pësuar dëmtime dhe degradim të materialit lidhës. Si rrjedhim, u bë restaurimi i një pjese të fasadës kryesore, restaurimi i murit nën kolonë të hajatit, si edhe restaurimi i shtresës së hajatit.

DO NOT COPY

DRKK SHKODËR

Pas reformës së thellë strukturore që pësoi në fund të vitit 2013 është institucioni rajonal me territorin më të gjerë nën administrim në vendin tonë. Aktualisht, institucioni ynë ka në inventarin e tij 302 monumente kulture, nën administrim 3 zona arkeologjike A dhe B, respektivisht (Shkodër, Lezhë, Koman) si dhe 12 Zona të Mbrojtura. Ky numër i madh monumentesh, si dhe shtrirja e gjerë e tyre në territor përbën, le të themi dhe vështirësinë më të madhe të punës sonë. Një nga detyrat parësore të DRKK SHKODËR është dhe hartimi dhe zbatimi i projekteve në lidhje me mbrojtjen, konservimin, restaurimin e objekteve monumentale, dëshmi e trashëgimisë sonë kulturore.

Ndërhyrje restauruese në Kalanë e Shkodrës

Kalaja e Rozafës ndodhet në hyrje të qytetit të Shkodrës. Ajo dominon mbi një kodër shkëmbore në perëndim të qytetit, ndërmjet lumenjve Drin dhe Buna. Kalaja ka një pozitë gjeografike strategjike, pasi kontrollon jo vetëm fushën përreth dhe hyrjen në qytetin e Shkodrës por edhe kalimin në thellësi të Ballkanit. Kalaja e Rozafatit me muret e saj ngrihet mbi faqet e pjerrëta të kodrës shkëmbore 134 m të lartë, duke zënë një sipërfaqe prej 3.6 hektarësh. Ajo ka hyrjen nga veriu dhe disa hyrje e dalje të tjera sekrete për manovrime në kohën e funksionimit të saj. Mbrohet nga 9 kulla rrethore dhe katërkëndëshe. Kalaja ndahet në tre oborre, ku secili dallon për tipologjinë e ndërtimeve të ndryshme. Muret perimetralë të saj arrijnë një gjatësi prej 981 m dhe trashësia e tyre varion nga 70 cm deri në 1 m. Kalaja e Rozafës gjatë historisë së saj ka kaluar nëpër disa faza ndërtimi. Gjurmët antike të saj, (teknika e mureve me blloqe poligonalë), ruhen pranë hyrjes kryesore. Si qendër e fortifikuar ilire, kjo Kala përmendet për herë të parë në kohën e sundimtarit ilir Genti, në mesin e shek. II p.e.s. Poshtë kodrës, rrëzë urës së Bahçallëkut, në bregun e lumit Drin, janë zbuluar gjurmë muresh mbrojtëse dhe rrënojash të qytetit që shtrihej aty në antikitet. Në mesjetë, Kalaja njihej me emrin Rozafa, të cilin duhet ta ketë marrë aty rreth shek.VI-të. Gjatë periudhës se mesjetës, Kështjellën e Shkodrës e pushtuan herë bizantinët dhe herë sllavët, deri në 1355 që u mor nga feudalët shqiptarë Balshaj. Në 1396, në Shkodër hyjnë Venecianët. Pas vdekjes së Skënderbeut, në vitin 1474, Shkodra u rrethua për herë të parë nga osmanët, të cilët e pushtuan këtë qytet vetëm pas rrethimit të dytë që përfundoi në 1479 me pushtimin përfundimtar të Shkodrës. Deri në 1865 Kalaja ka qenë qendra administrative e qytetit. Brenda saj ka qenë dhe pallati i feudalëve Bushatllinj gjatë pashallëkut të tyre, që zgjati përgjatë viteve 1757-1831.

Nisur nga rritja e vizitueshmërisë si dhe kthimi në një nga qendrat kryesore të atraksionit turistik, lind nevoja që të ndërhyet sërish në konservim, pastrim nga vegjetacioni si dhe ndërhyrje me masa mbrojtëse për rritjen e sigurisë së vizitorëve. Me punimet konservuese dhe restauruese do të ndërhyhet kryesisht në muret rrethuese të kalasë, konkretisht në muret perëndimore dhe lindore.

Gjatë vitit 2015, ndërhyrjet u përqendruan në pjesën lindore të Kalasë, në oborrin e dytë të saj, pikërisht në kullën me tre kate të këtij oborri. Pjesa e sipërme e saj paraqiste humbje të materialit konstruktiv në muraturën e tre faqeve të saj dhe në qemeret e dritareve si dhe frëngjisë. Gjatë këtyre punimeve, në këtë kullë u kryen konsolidime të kreut të mureve, për të shmangur infiltrimin e mëtejshëm të lagështirës, gjë që sillte dëmtimin e gjithë strukturës së mureve. Këto punime konsistonin në ngritjen mureve me 1 - 2 rreshta gurë si dhe restaurimin e qemereve të dy dritareve që ndodhen në faqen lindore dhe atë jugore të kullës. Si materiali lidhës u përdor llaç gëlqereje i majmë, me konsistencë të ulët.

Në vitin 2016, punimet restauruese dhe konservuese u përqendruan në pjesën jugore të Kalasë, në oborrin e tretë, pranë portës hyrëse, si dhe në muret perimetralë perëndimor, në oborrin e dytë. Në

DO NOT COPY

skajin juglindor të Kalasë ngrihet një kullë vrojtimi e periudhës veneciane, e cila kishte humbje të materialit konstruktiv në pjesën e sipërme të saj. Edhe qoshja kishte pësuar mjaft dëmtime, ku vende-vende mungonin dhe rreshtat e gurëve. Punimet konsistuan në veshjen e plotë të qoshes, si dhe ringritjen e kullës deri në lartësinë e gjurmës që kishte në pjesën e kontrafortit. Në muret perimetralë perëndimor të oborrit të dytë ngrihej një beden, që për shkak të efektit kohë kishte pësuar inklinim nga ana e jashtme në shkallë të lartë dhe rrezikonte shembjen e tij. Mënyra e vetme për shpëtimin e tij ishte tërheqja me anë të tiraneve, deri sa blloku arriti në pozicionin vertikal, dhe pastaj iu nënshtrua konsolidimit në bazë, aty ku ishte bërë dhe lidhja me muraturën. Pranë portës, për në oborrin e tretë, shpatulla e djathtë e saj, për shkak të efektit kohë ishte dëmtuar rëndë, ndaj u ndërhy duke e riveshur të gjithën sipas teknikës ekzistuese, duke iu referuar edhe dokumentacionit të kohës por dhe duke ndjekur lartësinë dhe formën e shpatullës së ruajtur në anën e majtë.

Në vitin 2017, ndërhyrjet konservuese dhe restauruese u përqendruan në kullën jugperëndimore të oborrit të tretë, ku nëpërmjet injektimit u arrit të mbushej çarja që kishte pësuar kulla në gjithë lartësinë e saj si dhe u bë plotësimi i materialit konstruktiv në kreun e kullës, në tre faqet e saj. Gjithashtu, u kryhen fugatime në faqet e mureve me llaç gëlqereje pas pastrimit të vegjetacionit.

Ndërhyrja tjetër ishte tek muri perimetral në anën lindore të kalasë, në oborrin e dytë. U realizua bashkimi i strukturave të mbetura me 2-3 rreshta gurësh në mënyrë që të bëhej dhe konsolidimi i tyre. Ndërhyrja synonte konservimin e qemerit të frëngjisë së topit që ndodhet në këtë mur, nëpërmjet përforcimit të shpatullave të qemerit.

Muret antike të Lisit. Muret e fortifikimit antik në qytetin e Lezhës janë shpallur monument kulture në vitin 1971. Qyteti antik i Lezhës është i vendosur në një terren të dyfishtë, kodrinor dhe fushor dhe muret rrethuese përfshijnë një sipërfaqe prej 22 ha dhe gjatësia e mureve antike është 2600 m. Urbanistika e qytetit të fortifikuar ndahet në 4 zona kryesore:

1-Zona e pjesës së sipërme, e vendosur në majën e kodrës;

2-Zona e pjesës së mesme, e shtrirë në shpatet kodrinore;

3-Zona e pjesës së poshtme;

4-Zona breglumore në shtrat të lumit Drin dhe murit perëndimor të qytetit.

Secila nga këto zona ka pasur një funksion të veçantë dhe njëkohësisht të ndërlikuar. Ndërhyrjet ndër vite në të gjithë këtë sistem fortifikues kanë qenë operacionale dhe lokale dhe jo të dimensioneve të mëdha.

Muret antike janë ndërtuar me 2 teknika kryesore, të tipit poligonal dhe tipit trapezoidal, ndërsa në pjesën e mureve që janë ndërtuar gjatë periudhës së antikitetit të vonë janë përdorur teknikat Romake Opus Mixtum dhe Opus Incertum. Gjatë periudhës bizantine dhe deri në periudhën e fundit përpara pushtimit osman është përdorur shumë rrallë teknika e Kluasonazhit (2 rradhë tulla horizontale dhe 2 rradhe tulla vertikale). Rikthimi i gurëve në gjendjen e mëparshme është një nga proceset më të vështira. Ky proces kryhet me metodën e anastilozës e cila konsistoi në zhvendosjen e gurëve me vinç parango. Pasi u studiua me vëmendje, u përcaktua dhe pozicioni i gurit që është zhvendosur dhe u hartua mënyra që do ndiqej për t'u transportuar gjer në pozicionin final.

Ndërhyrjet e tjera konsistuan në mbushjen e hapësirave pas mureve. Mbushja e parë ka të bëjë me mbushjen me çakull që lejon filtrimin e rreshjeve. Pasi u krye mbushja e saj me çakull, u përgatitën edhe disa shtresa betoni, të cilat mbrojnë largimin e materialit mbushës nga hapësira e pasme.

Ndërkohë, një ndërhyrje tjetër ishte ajo për të përmirsuar lidhjen dhe muraturën. U realizua

DO NOT COPY

mbushja e hapësirave të mesme murale me gurë kave, të madhësive me diametër nga 10-30 cm. Kjo mbushje lejon dhe filtrimin e shirave e gjithashtu mbush hapësirën për të mos lejuar dëmtimin ose zhvendosjen e gurëve.

Ura e Mesit është monument kulture i kategorisë së parë. E gjithë sipërfaqja është e ndërtuar me gurë dhe e shtruar me kalldrëm. Ura e Mesit, ndërtuar nga Mehmet Pasha Bushati nga fundi i shek. XVIII, është një nga urat prej guri më të mëdha dhe më të ruajtura në vendin tonë. Ajo është urë tip me kurriz, e realizuar me 13 harqe, me përmasa hapësirash të ndryshme me një gjatësi prej 108 m. Ndërtimi i urës ka kaluar në dy faza. Fazës së parë i takon harku kryesor me hapësirë drite 21,5 m dhe 3 harqe të tjera, traseja e kësaj faze të urës është shtruar me gurë pllakë të vendosur këlliç, duke i dhënë harkut të urës pendencën në formë shkallareje. Më vonë, kur me sa duket prurjet e mëdha përmbytnin pjesët e pjerrëta në hyrje dhe dalje të urës, lindi nevoja e zgjatjes së saj, duke shtuar 4 harqe nga e majta dhe 5 harqe nga e djathta, muratura e të cilit është punuar me kujdes që në fazën e parë. Në këtë objekt si fillim u ndërhy duke kryer pastrimin e plotë të faqeve të mureve në të dy anë nga bimësia e ulët dhe fugatimi i zgavrave të vogla që dolën gjatë pastrimit. Restaurimit iu nënshtrua vende-vende kalldrëmi, i cili kishte krijuar gropa nga mungesa e materialit mbushës. Ndërkohë, edhe parapetat e Urës në të dy krahët e saj u restauruan në ato vende ku ishin dëmtuar. Për evitimin e depozitimit të ujërave të shiut nga pjesa e sipërme e kodrës, në shtratin e Urës u ndërtua një kunetë e re me përmasa më të mëdha në pikën ku bashkohet trupi i Urës me rrugën, pasi kuneta e vjetër e saj ishte dëmtuar dhe kishte humbur funksionin.

Objekte Kulti

Kisha e Shën Stefanit ndodhet në fushë në perëndim të fshatit Blinisht, duke shërbyer prej kohësh si varrezë. Ajo ruhet sot në gjendje jo të mirë. Kisha paraqet një ndërtesë me planimetri drejtkëndëshe, që përfundon në anën lindore me absidë gjysëm rrethore pa dritare. Në fazën e dytë të rindërtimit, kisha, nga një ndërtesë e thjeshtë me çati druri kthehet në një kishë të mbuluar me qemer me harqe përgjatë mureve të të gjithë ndërtesës. F. Bardhi në vitin 1642 shkruan se këtë kishë të vogël e ka ndërtuar Nikollë Dukagjini. Në një nga guret e shpatullave të kishës gjendet mbishkrimi "viti 1300", si duket vit i rindërtimit. Mendojmë se ndërtimi i parë i përket shek. XI-XII, ndërsa rindërtimi i takon shek. XIV. Në kishë hyet nga porta në anën perëndimore, dikur e mbuluar me hark, nga i cili ruhen pak gjurmë. Shpatullat e portës janë me pature e të ndërtuara me gurë të mëdhenj. Në brendësi të kishës, në anën veriore, kemi grumbuj rrënimesh të muraturave.

Ndërhyrjet restauruese u zbatuan duke filluar që nga muret, me pastrimin e zgavrave, larjen dhe mbushjen e tyre. Çarjet në muratura u mbushën me injektim. U krye konsolidimi i kreut të mureve si dhe u restaurua i gjithë qemeri i portës hyrëse me gurët e punuar të vet portës, që u gjetën po aty në terren, të rëna kohë më parë.

Kisha e Shën Premtes, Gallatë. Në fshatin Gallatë, Skuraj, në tarracën e malit të Skënderbeut, në një lartësi 700 m mbi nivelin e detit ngrihet një kompleks ndërtimesh ku dallohet Kisha e Shën Premtes (katedralja) dhe Selia e Ipeshkvnisë së Arbnisë në shek. XVII. Gallata si toponim del që në vitin 1467 në trajtën Galata, ndërsa emri Kurbin del në vitin 1457 nën emërtimin e kishës San Veneranda di Curbino. Këtu në Kurbin (Gallatë) në vitin 1632 ekzistonte një seminar, në të cilin përgatiteshin priftërinjtë e ardhshëm dhe meqë seminaret funksiononin pranë ipeshkvive dhe katedraleve, këtu në kishën e Shën Prendës ishte vendosur selia ipeshkvnore e Arbnisë. Nga një relacion dërguar Kongregatës së Propagandës Fide pas një vizite baritore, që mban datën 20 dhjetor 1641 dhe që është lëshuar nga Kurbini, pra në kishën e Shën Prendës, mes të tjerash shkruhet se në Kurbin (ka një shkollë me 12 gjakoj, që arqipeshkvi i ushqen

DO NOT COPY

me mjetet e veta për të rritë subjektë, që të shugurohen meshtarë pastaj, kur të jetë koha). Kisha katedrale e Shna Prendës ishte braktisur nga fundi i shek. XIX dhe afër saj është ngritur një kishë me përmasa më të vogla e ndërtuar në vitin 1911. Ndërsa kisha e vjetër (katedralja) në vitin 1932 ishte kthyer e gjitha në varrezë për fshatin Gallatë. Kisha (katedrale) ka patur tre navata (nefe) dhe se kompanieli (kambana) i kishës ishte i lartë 12 m. Sot, kisha e vjetër katedrale bashkë me Selinë ipeshkvnore është në gjendje të rrënuar, ndaj dhe u ndërhy me punime konservuese për të frenuar degradimin e mëtejshëm.

Ndërhyrjet restauruese në objekt konsistuan në pastrimin e zonës nga bimësia dhe ringritjen e mureve në lartësi, duke përdorur gurët që ndodhen përreth objektit, të rëna prej kohësh. Gjithashtu, në muaratura, zgavrat prezente dhe çarjet u rimbushën për t'u kthyer në gjendjen e mëparshme. Fugatimi ishte një proces tjetër nëpër të cilin kaluan muraturat e këtij objekti. Ky proces, përveç impaktit vizual që ka, luan një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e materialit lidhës ekzistues, i cili është momentalisht në funksion. Gjithashtu, u bë një pastrim nga dherat në pjesën e altarit, duke nxjerrë në dritë elemente dekori dhe fragmente suvaje të afreskuar.

DRKK VLORË

1. Kisha e Shën Spiridhonit, Vuno

Kisha e Shën Spiridhonit ndodhet në fshatin bregdetar Vuno, Bashkia Himarë. E pozicionuar në një shesh, ajo formon një ansambël ndërtimor së bashku me ndërtesat e tjera të karakterit shoqëror, shkollën, administratën kishtare si dhe Kishën e Shën Mëhillit në anën jugore të saj. Kisha daton në vitin 1778. Nga dokumentacionet e ruajtura del në pah se kisha ka pasur disa ndërhyrje mirëmbajtjeje të vogla përgjatë viteve, duke lënë të paprekur kështu arkitekturën dhe karakteristikat e saj.

Kisha është një bazilikë me përmasa të brendshme 19.80 x 11.40 m, me tre hyrje në anën perëndimore, jugore dhe veriore. Ajo ndahet me dy arkada mbi kolona guri në nefe gjatësore, ndërsa një arkadë tërthore në pjesën perëndimore veçon endonarteksin dykatësh, që nuk ekziston në ditët e sotme (struktura e drurit të gjinekonitit është djegur në zjarrin e vitit 1998). Në katin e sipërm të endonarteksit – gjinekonitit, shkohej me dy rampa shkalle, që fillojnë në të dy krahët e portës perëndimore, gjurmët e të cilave janë të dukshme në murin perëndimor. Gjinekoniti hapej ndaj naosit në formë tribune. Nefet anësore të naosit janë tepër të ngushta, duke i dhënë më shumë hapësirë nefit qendror. Nefet kanë qenë të mbuluara me tavane druri nga të cilët, tavani i nefit qendror është më i ngritur. Kjo duket qartë nga gjurmët në muraturë si dhe vendet ku kanë qenë të mbështetur trarët mbajtës të tavanit.

Në anën perëndimore kisha paraprihet nga një hajat në formë katrore në plan. Hajati është i hapur në tri anë me arkada mbi kolona guri. Muratura prej guri e kishës është e veshur me një shtresë suvaje, duke lënë në dukje qoshet e mureve dhe shpatullat e dyerve dhe të dritareve, të punuara me gurë të gdhendur.

Në Maj të vitit 2014, pas shirave të rrëmbyeshëm

DO NOT COPY

është rrëzuar çatia e nefit qendror, brenda ambientit të kishës, e cila shkaktoi dëme të mëdha edhe në strukturën e mureve.

IMK dhe DRKK Vlorë realizuan projektin e ndërhyrjeve të restaurimit, ku punimet kryesisht konsistonin në:

- Pajantim dhe puntelim i harkadave jugore dhe veriore, sjellja në vertikalitet duke shtyrë muraturën me puntela metalike me gradim, pa dëmtuar afreskun.
- Konsolidim dhe restaurim i harqeve të arkadës në nefin qendror, me teknikën e injektimit të llaçit, dhe të harqeve të hajatit me teknikën shqep-qep.
- Ndërtim i çatisë në nefin qendror dhe hajatin e kishës.
- Zëvendësim i gurëve dhe kapiteleve të dëmtuar me gurë të rinj.
- Vendosje e tirantave tërthore në nefet anësore.
- Suvatim nga jashtë i mureve, aty ku suvaja është e dëmtuar apo mungon.
- Restaurim i dyshemesë së gurit, sofatit në hajat dhe shkallëve.

2. Ura e Bratajt, Ura e Slapit, Ura e Frëngut

Këto janë tre urat të cilat ndodhen në Lumin e Vlorës dhe janë Monument Kulture i Kat. I-rë. Në mesjetën e vonë, këto ura ishin pjesë e udhës së karvanëve, që lidhin pjesët e brendshme të lumit të Vlorës me bregdetin e Himarës.

- **Ura e Slapit** ndodhet në fshatin Mavrovë të rrethit të Vlorës. Është urë me një hark, me dopjo qemer dhe trase horizontale e shtruar me kalldrëm. Në të dy anët e harkut ruhet nga një kamare. Mendohet se është e ndërtuar në shek. XVII. Ndërtimi është realizuar me gurë kave të latuar, të lidhur me llaç. Punimet konservuese dhe restauruese konsistojnë kryesisht në pastrimin e vegjetacionit dhe aluvioneve rreth urës, fugatimin e mureve anësore të urës, restaurimin e trasesë dhe parapetëve të gurit.

- **Ura e Bratajt** ndodhet në fshatin Brataj. Ura ngrihet mbi një hark të madh kryesor dhe në të dy anët ndodhen dy harqe më të vegjël të mbështetur në masiv shkëmbor monolit. Është urë me një qemer të dyfishtë, me lartësi maksimale 12 m, me trase horizontale dhe lidh dy brigjet e lumit Shushicë. Traseja është e gjatë 50 m dhe 3.3 m e gjerë. Ura është ndërtuar në shekullin XVI, me gurë kave të çrregullt, të lidhur me llaç gëlqereje. Në këtë urë u kryen punime të restaurimit të trasesë dhe parapetit në pjesët e dëmtuara, dhe plotësimi i parapetit të gurit në pjesët ku mungonte.

- **Ura e Frëngut**, e ndërtuar në shek. XVI, ndodhet mbi përroin Pishqe, gjatë rrugës për në fshatin Gjorm. Ura është e vogël, me një qemer tip lundër, me një dritare shkarkuese në bregun e majtë në formë harku me kurbëzim të lehtë. Në këtë urë u kryen punime pastrimi nga vegjetacioni dhe aluvione të ndryshme, restaurimi i trasesë horizontale të saj dhe fugatimi i mureve anësore të urës.

3. Xhamia në Kalanë e Borshit

Kalaja ndodhet në kurorën e kodrës së Sopotit, në verilindje të fshatit Borsh, rreth 1 km nga rruga automobilistike. Kalaja e Borshit përbëhet nga mure rrethuese në formën e një qarku të mbyllur. Brenda saj ndodhet akropoli në formën e një trekëndëshi.

Në anën juglindore të Kalasë ndodhet një xhami e ndërtuar nga osmanët për kryerjen e riteve fetare. Dëmtimet në muret perimetrale të kalasë, kubenë, muret e xhamisë, si dhe në çatinë në hyrje të xhamisë paraqiten serioze.

Punimet u kryen në vitin 2016 dhe konsistonin kryesisht në rindërtimin e çatisë. Kjo çati është e ndërtuar më herët rreth viteve 1980 dhe është me strukturë druri mbuluar me tjegulla vendi. Struktura është ndërtuar me binarë druri (12 x 15 cm) në drejtimin tërthor dhe veshur (mbuluar) me dërrasë (15 x 3 cm). Struktura është mbështetur në tre anë

DO NOT COPY

në muret perimetrale, ndërsa nga ana e katërt binarët futen në foletë e murit të xhamisë, të krijuara për këtë qëllim. Gjithashtu, punime të tjera u kryen për restaurimin e shkallëve në hyrje të xhamisë, u vendos porta hyrëse, u kryen punime pastrimi nga vegjetacioni etj.

4. Bazilika e Shën Janit, Delvinë

Bazilika e Shën Janit ndodhet e pozicionuar rreth 1 km në perëndim të fshatit të Shijanit në Delvinë, në rrjedhën e majtë të lumit të Kalasës. Këtu ndodhet një kodër e vogël me përbërje gjeologjike ranore. Në lindje të planit të kësaj kodre ndodhen rrënojat e një bazilike të antikitetit të vonë, e njohur nga banorët me emrin e Shën Janit. Gërmimet e para janë ndërmarrë në vitin 1981, duke rifilluar shumë kohë më pas në vitet 2001, 2002, 2003. Nga gërmimet e fundit është bërë i mundur evidentimi i disa fazave të ndërtimit të këtij monumenti.

Faza e parë: Kishëz e vogël me një navatë dhe apsidë me planimetri gjysmë rrethore, me pesë hyrje, ndër të cilat ajo e pjesës perëndimore monumentale, e pajisur me kolona graniti.

Faza e dytë: Bazilikë me tre nefe, secili i pajisur me apsidë me planimetri gjysmë rrethore në pjesën lindore, narteks dhe një hyrje në pjesën jugore.

Faza e tretë: Shtohet një ekzonarteks dhe ambienti qendror (naosi) ndahet në tre pjesë.

Faza e katërt: pas shkatërrimit të bazilikës, në pjesën veriore të narteksit ndërtohet një kapelë e vogël.

Ndërhyrjet që u kryen konsistonin në punime që kryesisht ndihmonin në parandalimin e degradimit të mëtejshëm të gjendjes fizike të fragmenteve, në pastrimin dhe fugatimin me llaç gëlqere të fragmenteve të muraturës si dhe konsolidimin me anë të mbulimit tip kapuç të kreut të muraturës.

5. Kalaja Trekëndore në fushën e Vrinës, Butrint

Kalaja trekëndore në fushën e Vrinës i përket periudhës së mesjetës. Në kala dallohen katër faza kryesore ndërtimi. Nga ana e jashtme e kështjellës, pranë murit perëndimor të saj ka qenë e ndërtuar, në një kohë të vonë, një rrethim katërkëndësh, muret e të cilit mbështeteshin në dy prej kullave. Kështjella ka formë planimetrike trekëndëshe, me gjatësi brinjësh nga 40 m deri në 50 m. Në të tria këndet ka kulla të rrumbullakta. Kështjella ka dy hyrje. Muret në pjesën më të madhe ruhen në lartësinë e plotë dhe kurorëzohen nga një parapet me lartësi 1.5 m i përshkuar nga frëngji të shumta. Në pjesën e brendshme ka një sërë kthinash njëkatëshe, të mbuluara me qemerë cilindrikë, që i janë mbështetur krejt murit perëndimor si dhe një pjese të murit jugor. Në mes të oborrit ndodhet një ndërtim me planimetri rrethore i mbuluar me kupolë sferike, që mendohet të ketë shërbyer si depo baruti. Faza fillestare e kalasë datohet rreth fillimit të shek. XIV. Punimet restauruese konsistojnë në pastrimin e vegjetacionit përreth kalasë, brenda saj dhe mbi strukturën e monumentit, konsolidimin e frakturave dhe gurëve të lëvizshëm, konsolidimin e kreut të murit me qëllim mbrojtjen nga infiltrimi i ujërave të shiut në brendësi të saj, plotësime në muraturë, restaurimi i portave dhe kangjellave metalike, restaurimi i dyshemesë me pllaka guri etj.

6. Kalaja Katërkëndore (Kalaja e Ali Pashës), Butrint

Rreth viteve 1807-1808, Ali Pasha ndërtoi një kështjellë katërkëndëshe në Butrint, pranë grykës së derdhjes në det të kanalit të Vivarit. Kështjella ka përmasa 20x30 m, me katër kulla të vendosura në qoshe. Dy kullat e drejtuara nga deti kanë planimetri rrethore, ndërsa dy të tjerat, janë katërkëndëshe. Përveç kullave, që e mbronin nga ana e jashtme, ajo ka dhe një sistem të brendshëm fortifikimi. Kështjella në derdhje të Vivarit i takon një periudhe të vetme ndërtimi. Ajo është e ngritur brenda një

DO NOT COPY

kohe të shkurtër, duke kursyer materialin dhe çdo element tjetër që nuk i shërbente drejtpërsëdrejti mbrojtjes. Kështu shpjegohet ndërtimi i kullave më të fuqishme vetëm në drejtimet e mundshme të sulmit, kujdesi i treguar për mbrojtjen e portës që komunikon me kanalin, si dhe teknika e ndërtimit më pak e kujdesshme në anët që nuk i ekspozohen drejtpërdrejt sulmit.

Punimet restauruese konsistojnë në pastrimin e vegjetacionit përreth kalasë, brenda saj dhe mbi strukturën e monumentit, konsolidimin e frakturave dhe gurëve të lëvizshëm, konsolidimin e kreut të murit me qëllim mbrojtjen nga infiltrimi i ujërave të shiut në brendësi të saj, plotësime në muraturë, vendosje e arkitrarëve të drurit në dyer dhe dritare, sistemim i terrenit etj.

DO NOT COPY

KRONIKË INFORMATIVE

DO NOT COPY

KONFERENCA E 4-RT NDËRKOMBËTARE: "MONUMENTET BIZANTINE DHE TRASHËGIMIA BOTËRORE" KARTA PËR "MBROJTJEN E MONUMENTEVE TË TRASHËGIMISË BIZANTINE"
SELANIK, 30.11.2018 - 02.12.2018

Konferenca e 4-rt Ndërkombëtare: "Monumentet Bizantine dhe Pasuria Botërore" u mbajt nga datat 30 Nëntor deri në datën 2 Dhjetor në Selanik, Greqi. Kjo konferencë, e organizuar nga Qendra Për Monumentet Bizantine dhe Post-Bizantine nën përkujdesjen e Komitetit Kombëtar Grek të UNESCO-s, ishte eventi përmbyllës i Vitit Europian Për Trashëgiminë Kulturore 2018. Konferenca kulminoi me prezantimin e Kartës së Selanikut për Mbrojtjen e Monumenteve Bizantine, dhe u mbështet nga përfaqësuesit e 21 shteteve Europiane dhe të Mesdheut. Përfaqësues zyrtarë nga qeveritë e Armenisë, Gjeorgjisë, Rumanisë, Bullgarisë, Kroacisë, Serbisë, Bosnie Herzegovinës, Shqipërisë, Qipros, Greqisë, Italisë, Spanjës, Marokut, Algjerisë, Egjyptit, Bahreinit, Izraelit, Palestinës, Jordanisë, Libanit dhe Sirisë diskutuan dhe dakortësuan draftin final të Kartës së Selanikut Për Mbrojtjen, konservimin dhe restaurimin e Monumenteve Bizantine. Shqipëria ishte pjesëmarrëse në këtë konferencë nga Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri".

Qëllimi i Konferencës ishte arritja e konsensusit për dakortësimin nga përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse të një dokumenti të hartuar nga një Komitet Shkencor, i përbërë nga ekspertë me njohuri të spikatura akademike dhe me eksperiencë praktike në restaurimin e monumenteve Bizantine, dhe i rishikuar nga një Komitet Ndërkombëtar Ekspertësh.

Gjatë diskutimeve të konferencës të mbajtura në harkun kohor të tre ditëve, përfaqësuesit e 21 shteteve të ndryshme diskutuan gjerësisht mbi Monumentet Bizantine në territoret e tyre, për ato që iu kanë rezistuar shekujve, për ato që iu kanë rezistuar luftrave dhe konflikteve, për ato që iu kanë rezistuar përdorimeve të shumëllojshme në kohë, për ato që e kanë të vështirë sot të reflektojnë identitetin e tyre origjinal, si pasojë e ndërhyrjeve të shumta përgjatë viteve si dhe për vlerat e kësaj trashëgimisë kulturore, të cilat duhet t'u përcillen brezave të ardhshëm.

"Karta" që rezultoi nga diskutimet e kësaj Konference Ndërkombëtare u përcoll për miratim pranë UNESCO-s dhe EUROPA NOSTRA-s.

Fillimet e punimeve të Konferencës u çelën me fjalët përshëndetëse të Shefit të Europës dhe Amerikës së Veriut për Qendrën e Trashëgimisë

Botërore të UNESCO-s znj. Isabelle Anatole-Gabriel, zëvendësministri i Punëve të Jashtme z. Markos Bolaris, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë Greke për Kulturën dhe Sportet znj. Maria Andreadaki-Vlazaki, zëvendës Rektori i Punëve Akademike dhe Studentëve z. Ariadni Stogiannidou, Profesori i Universitetit Demokrician i Thrakës nënkryetari i parë i Bordit Grek të ICOMOS z. Nicolaos Lianos dhe Profesori i Universitetit Roma Tre, anëtar i Bordit të Europa Nostra z. Paolo Vitti. Situata aktuale e monumenteve Bizantine në Siri u prezantua nga nëndrejtori i Gërmimeve Arkeologjike i Ministrisë së Kulturës i Sirisë Z. Hammam Saad.

Ministri i Kulturës dhe Sporteve të Greqisë z. Myrsini Zorba, Kryetari i Bashkisë së Selanikut z. Yannis Boutaris dhe Presidenti i Komitetit Kombëtar Grek për UNESCO-n z. Aikaterini Tzitzikosta përshëndetën dakortësimin dhe finalizimin e draftit përfundimtar të Kartës së Selanikut në takimin përmbyllës të punimeve të Konferencës.

DO NOT COPY